REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA

AGJENCIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE UJORE

RAPORT

MBI

RISHIKIMIN E VLERËSIMIT PARAPRAK TË RREZIQEVE NGA PËRMBYTJET

Hartuar nga: Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore

Adresa: Bulevardi "Zhan D'Ark", Prona nr 33, Shtëpia e Ushtarakëve, Tiranë.

web: http://www.ambu.gov.al

e-mail: info@ambu.gov.al

PARATHËNIE

Të nderuar kolegë, ekspertë të ujit, mjedisit dhe mbrojtjes nga pasojat e ujit apo mungesa e tij, si dhe palë interesi,

Ne jemi Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore. Ne sigurohemi që nëpërmjet politikbërjes, planifikimit, fushatave të ndërgjegjësimit në komunitet, krijimit të projekteve inovative dhe partneriteve strategjike, të adresojmë sfidat komplekse të menaxhimit të burimeve ujore.

AMBU është e palëkundur në misionin e saj për të zbutur ndikimin e ndryshimeve klimatike si në komunitetet ashtu edhe në natyrë, përfshirë këtu edhe minimizimin e rreziqeve nga përmbytjet dhe erozionit bregdetar si për individët ashtu edhe për bizneset.

Të gjitha proceset në funksion të këtij misioni janë të mbështetura në legjislacionin e BE-së për menaxhimin e ujërave dhe menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet, dispozitat e të cilit, po nën kujdesin e AMBU-së, janë transpozuar në legjislacionin shqiptar.

Mbështetur në Vendimin nr.1015, datë 16.12.2020, të Këshillit të Ministrave "Për përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Burimeve Ujore, të planeve të menaxhimit të baseneve ujore dhe planeve të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet", proceset dhe hapat e ndërmarrë për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet, janë në linjë me Direktivën e Bashkimit Evropian mbi Përmbytjet (Directive 2007/60/EC).

Falë mbështetjes dhe asistencës së partnerëve të BE-së, Shqipëria është në fazë të avancuar në krijimin e dokumenteve mbështetëse teknike në funksion të planifikimit për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet, dhe angazhohet që në vitin 2025 të 7 basenet ujore të kenë plane për menaxhimin e këtij rreziku të koordinuar me planet e menaxhimit të baseneve ujore.

Vlerësimi paraprak i rrezikut nga përmbytjet, i nisur për herë të parë në vendin tonë në vitin 2018, sipas koncepteve të legjislacionit të BE-së, është miratuar me vendim të Këshillit Kombëtar të Ujit në vitin 2021, dhe në vijim, referuar detyrimeve dhe përcaktimeve të VKM-së 1015/2020, ky vlerësim është rishikuar në dokumentin në vijim.

Qëllimi i rishikimit është identifikimi i nevojës për përditësimin e zonave të shpallura me rrezikshmëri potenciale nga përmbytjet ose atyre për të cilat ka gjasa të ndodhin, dhe në vijim, i nevojës për të krijuar hartat e rrezikut dhe riskut për zonat e përditësuara si dhe përfshirjen e këtij përditësimi edhe në planet e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet.

Drejtori i Përgjithshëm, AMBU

PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 1
II. LEGJISLACIONI 2
III. STADI AKTUAL I PROCESIT TË MENAXHIMIT TË RREZIKUT NGA PËRMBYTJET 4
IV. VLERËSIMI PARAPRAK I RREZIKUT NGA PËRMBYTJET (MIRATUAR NË 2021) 7
1. BASENI UJOR DRIN BUNË 10
2. BASENI UJOR MAT 19
3. BASENI UJOR ISHËM 21
4. BASENI UJOR ERZEN 23
5. BASENI UJOR SHKUMBIN 26
6. BASENI UJOR SEMAN 30
7. BASENI UJOR VJOSE 36
V. QASJA PËR RISHIKIMIN 42
VI. AUTORITETET DHE ROLET 43
VII. METODOLOGJIA 44
VIII. RISHIKIMI I DETAJUAR 48
1. BASENI UJOR DRIN BUNË 48
2. BASENI UJOR MAT 62
3. BASENI UJOR ISHËM 67
4. BASENI UJOR ERZEN 78
5. BASENI UJOR SHKUMBIN 91
6. BASENI UJOR SEMAN 117
7. BASENI UJOR VJOSË 139
IX. REZULTATET E RISHIKIMIT DHE KONKLUZIONET 155
X. ZONAT ME RREZIK POTENCIAL NGA PËRMBYTJET OSE KU KA GJASA TË NDODHIN ATO (2024-2026) 157

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Përmbytjet janë fenomene natyrore që nuk mund të parandalohen, të cilat kanë potencial për të shkaktuar fatkeqësi, zhvendosjen e njerëzve dhe dëmtimin e mjedisit dhe që rrezikojnë dhe dëmtojnë zhvillimet ekonomike.

Referuar dokumentit të Vlerësimit të Rrezikut të Fatkeqësive Natyrore në Nivel Kombëtar, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave në Mars 2023, rreziku i përmbytjeve, konsiderohet si një nga tre rreziqet kryesore nga fatkeqësitë natyrore me të cilat përballet Shqipëria, së bashku me rrezikun teknologjik dhe shkatërrimin e digave.

Me synimin për të shmangur dhe reduktuar ndikimet negative të përmbytjeve është e nevojshme të hartohen dokumente planifikuese menaxhimi, në nivel baseni apo territoresh të një baseni ujor, dokumente këto që parashikojnë masat e nevojshme brenda sipërfaqeve që preken nga përmbytjet, për të garantuar sigurinë e njerëzve, gjësë së gjallë dhe të pronave duke trajtuar të gjitha fazat e ciklit të menaxhimit, përfshirë parandalimin, mbrojtjen dhe gatishmërinë.

Direktiva 2007/60/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 23 Tetor 2007, "Mbi vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve nga përmbytjet", e cila parashikon ngritjen e një kuadri për vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet, nuk është detyruese për shtetet që nuk janë anëtare të BE-së, por është një standard gjerësisht i pranuar dhe kontribut për procesin e aderimit në BE.

Për rrjedhim, qeveria shqiptare ka përafruar Direktivën 2007/60/KE nëpërmjet miratimit të VKM-së nr. 1015, datë 16.12.2020, "Për Përmbajtjen, Zhvillimin dhe Zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Burimeve Ujore, të Planeve të Menaxhimit të Baseneve Ujore dhe Planeve të Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet".

Legjislacioni në fuqi, ngarkon Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU), që në bashkëpunim me zyrat e administrimit të baseneve ujore, të hartojë planet e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet (PMRP), të cilat fokusohen në parandalimin, mbrojtjen, gatishmërinë, përfshirë parashikimin e përmbytjeve dhe sistemet e paralajmërimit të hershëm.

Hartimi i PMRP-ve, dhe rishikimet përkatëse sipas cikleve 6-vjeçare, paraprihet nga procese të cilat kryejnë vlerësime dhe analiza në funksion të hartimit të planeve.

Vlerësimi paraprak i rrezikut nga përmbytjet, është procesi i parë që zhvillohet, i cili nëpërmjet një analize paraprake të rrezikut, identifikon zonat me rrezik potencial nga përmbytjet, për çdo basen ujor, dhe më pas, për ato zona, krijohen hartat e rrezikut dhe të riskut.

Mbështetur në hartat në fjalë, Planet e Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet kryejnë vlerësimet e plota për rreziqet dhe risqet si dhe përcaktojnë masat e nevojshme për zbatim të cilat eleminojnë apo minimizojnë këto rreziqe.

Referuar dispozitave ligjore, Vlerësimi paraprak i rrezikut nga përmbytjet rishikohet duke konsideruar informacionet e përditësuara për ngjarjet e përmbytjeve, zhvillimin e njohurive, ndryshimet klimatike, etj., dhe në rast nevoje përditësohet duke rivlerësuar zonat me rrezikshmëri potenciale dhe në vijim duke evidentuar nevojën për përditësimin e hartave të rrezikut e riskut e për rrjedhim përditësimin e PMRP. Raporti në vijim, paraqet procesin e rishikimit të VPRP dhe konkluzionet në lidhje me nevojën për përditësim.

II. LEGJISLACIONI

Procesi i rishikimit të Vlerësimit Paraprak të Rrezikut nga Përmbytjet është realizuar i udhëhequr nga detyrimet e Direktivës 2007/60/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 23 Tetor 2007 "Mbi vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve nga përmbytjet", si edhe përcaktimet Vendimit nr. 1015, datë 16.12.2020, të Këshillit të Ministrave "Për përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Burimeve Ujore, të Planeve të Menaxhimit të Baseneve Ujore dhe Planeve të Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet".

Legjislacioni shqiptar, në lidhje me menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet (ligji nr.11/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", i ndryshuar, dhe Vendimi 1015/2020 i Këshillit të Ministrave), ka transpozuar plotësisht Direktivën 2007/60/KE "Mbi vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve nga përmbytjet".

Të papërfshira në legjislacion janë vetëm dispozitat e Direktivës, të lidhura me të drejtat dhe detyrimet që kanë shtetet anëtare për raportimin në Komisionin Evropian, të cilat do të transpozohen pasi Shqipëria të bëhet shtet anëtar i BE-së.

Referuar përcaktimeve të VKM-së 1015/2020 (Shtojca III, Kreu 1 – "Përmbajtja dhe procedurat për zhvillimin dhe zbatimin e planeve të mbrojtjes nga përmbytjet"):

- *(1) AMBU-ja, për çdo basen ujor të identifikuar, bën vlerësimin paraprak të rrezikut nga përmbytjet bazuar në informacionin e disponueshëm, siç janë të dhënat dhe studimet mbi zhvillimet afatgjata, dhe në veçanti ndikimet e ndryshimeve klimatike në rastin e ndodhjes së përmbytjeve.*
- *(5) Vlerësimi paraprak i rreziqeve nga përmbytjet duhet të rishikohet dhe në qoftë se është e nevojshme të përditësohet, brenda datës 31 dhjetor 2023 dhe më pas çdo tre vjet. Çdo rishikim tjetër duhet të marrë në konsideratë ndikimin e mundshëm të ndryshimeve klimatike në ndodhjen e përmbytjeve.*
- *(6) Vlerësimi paraprak i rreziqeve nga përmbytjet dhe çdo rishikim referuar në pikën 5 i këtij kreu, pas miratimit nga Këshilli Kombëtar i Ujit, duhet të vendoset në faqen e internetit të AMBU-së dhe duhet të jetë i disponueshëm për publikun.*
- *(7) Këshilli Kombëtar i Ujit, me propozim të AMBU-së dhe në bazë të vlerësimit paraprak të rreziqeve nga përmbytjet ose të ndonjë rishikimi të referuar në pikën 5 i këtij kreu, duhet të shpallë zonat ku ekziston rreziku potencial nga përmbytjet ose ka gjasa të ndodhin përmbytje.*
- *(8) Kur një basen ujor është pjesë e një rrethi ndërkombëtar të basenit ujor, AMBU-ja duhet të koordinojë me autoritetet përkatëse në shtetet e tjera për shpalljen e zonave në rrezik nga përmbytjet të referuara në pikën 7, i këtij kreu.*

AMBU-ja, në përmbushje të detyrimeve të legjislacionit, realizoi procesin e rishikimit të Vlerësimit Paraprak të Rreziqeve nga Përmbytjet, të miratuar me vendimin nr. 1, datë 15.6.2021, të Këshillit Kombëtar të Ujit "Për miratimin e Raporteve të Vlerësimit Paraprak të Rreziqeve nga Përmbytjet për basenet ujore Drin-Bunë, Mat, Ishëm, Erzen, Shkumbin, Seman, Vjosë dhe shpalljen e Zonave ku ekziston rreziku potencial nga përmbytjet ose ka gjasa të ndodhin përmbytje".

Konkretisht:

- Raportin e Vlerësimit Paraprak të Rreziqeve nga Përmbytjet për Basenin Ujor Drin-Bunë;
- Raportin e Vlerësimit Paraprak të Rreziqeve nga Përmbytjet për basenet ujore Mat, Ishëm, Erzen, Shkumbin, Seman, Vjosë;
- Zonat ku ekziston rreziku potencial nga përmbytjet ose ka gjasa të ndodhin përmbytjet për basenet ujore Drin-Bunë, Mat, Ishëm, Erzen, Shkumbin, Seman, Vjosë, të shpallura.

Tabela 1. Hapat/proceset e VPRP për ciklin e parë dhe rishikimet.

Proceset / hapat	Sipas përcaktimit të VKM 1015/2020	Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore	Këshilli Kombëtar i Ujit
Procesi i Vlerësimit Paraprak të Rrezikut nga Përmbytjet dhe identifikimi i ZRPP-ve		2019	
Hartimi i Raportit dhe Identifikimi zonave me rrezikshmëri poteciale nga përmbytjet dhe shpallja e ZRPP-ve	Dhjetor 2022	2021	Qershor 2021
Procesi i rishikimit të parë të Vlerësimit paraprak të rrezikut nga përmbytjet dhe ZRPP-ve		korrik – dhjetor 2023	
Hartimi i Raportit për rishikimin e parë të Vlerësimit paraprak të rrezikut nga përmbytjet dhe ZRPP-ve (propozimi për përditësim nëse është e nevojshme)	Dhjetor 2023	Dhjetor 2023	Mbledhjen e radhës së KKU-së
Procesi i rishikimit të dytë të VPRP dhe ZRPP-ve (propozimi për përditësim nëse është e nevojshme)		korrik – dhjetor 2026	
Hartimi i Raportit për rishikimin e dytë të VPRP dhe ZRPP-ve (propozimi për përditësim nëse është e nevojshme)	Dhjetor 2026	Dhjetor 2026	Mbledhjen e radhës së KKU-së

Në proceset e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet, në kuptim të menaxhimit të rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore në rang kombëtar, kontribuojnë edhe dokumentet:

- Strategjia Kombëtare për Reduktimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë dhe Plani i Veprimit përkatës për Zbutjen dhe Përshtatjen, 2023-2030, miratuar me Vendimin nr.94, datë 22.2.2023, të Këshillit të Ministrave;
- Vlerësimi i Rrezikut nga Fatkeqësitë Natyrore në Nivel Kombëtar, miratuar me Vendimin Nr. 168, datë 24.3.2023, të Këshillit të Ministrave.

III. STADI AKTUAL I PROCESIT TË MENAXHIMIT TË RREZIKUT NGA PËRMBYTJET

Hapat e përcaktuar për t'u ndjekur dhe zbatuar për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet janë specifikuar në dispozitat respektive (Vendimi 1015/2020 i Këshillit të Ministrave) dhe Direktiva 2007/60/KE), dhe përmbajnë 4 faza kryesore:




Figura 1. Hapat për zhvillimin e dokumenteve menaxhues të rrezikut nga përmbytjet.

Në vlerësimin progresiv të proceseve themelore në funksion të zhvillimit të Planeve të Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet, janë konsideruar:


- vlerësimi paraprak i rrezikut nga përmbytjet për basenet ujore dhe shpallja e zonave me rrrezik potencial nga përmbytjet (miratuar në KKU në vitin 2021 dhe publikuar);
- krijimi i Hartave të Rrezikut (hazard) për të gjitha zonat me rrezikshmëri të basenit për ngjarjet me probabilitet të ulët, të mesëm dhe të lartë në formatet e kërkuara (krijuar për 44/46 zonat, miratuar në KKU dhe publikuar vetëm për 16 zona);
- krijimi i Hartave të Riskut për të gjitha zonat me rrezikshmëri të basenit për ngjarjet me probabilitet të ulët, të mesëm dhe të lartë në formatet e kërkuara (krijuar për 39/46 zonat, miratuar në KKU dhe publikuar vetëm për 3 zona);
- hartimi i projekt-PMRP-ve dhe miratimi paraprak i tyre në Këshillin Kombëtar të Ujit (përfshirë edhe procesin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor) (vetëm për 3/8 zonat e Basenit Ujor Drin-Bunë);
- përfundimi i procesit/periudhës së konsultimit dhe reflektimi i sugjerimeve;
- miratimi i PMRP-ve finale në KKU;
- miratimi i PMRP-ve përfundimtare në Këshillin e Ministrave për zbatim;

Aktualisht proceset, në rang vendi, për planifikimin e rrezikut nga përmbytjet (sipas Direktivës së BE-së) janë të përmbushura **në masën 42%.**



Grafiku 1. Paraqitje e nivelit të procesit të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet.

Procesi ka një progres të konsiderueshëm krahasuar me vitin 2022 (për referencë grafikut në vijim).



Grafiku 2. Paraqitje e progresit 2023 kundrejt periudhës respektive 2022.

Projektplani i parë i Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet është ai për disa zona ku ekziston rreziku potencial nga përmbytjet ose ka gjasa të ndodhin përmbytje Drin-Bunë 4, 5 dhe 6, i cili pas miratimit paraprak në KKU, është publikuar në faqen zyrtare të AMBU-së, si dhe është dërguar veçanërisht për rakordim dhe konsultim në bashkinë Shkodër, bashkinë Vau i Dejës dhe pranë Prefektit të Qarkut Shkodër (territoret në administrim të të cilave ndikohen nga përmbytjet në këto zona të shpallura dhe janë pjesë e planifikimit).

Njëkohësisht, nëpërmjet Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, është dërguar pranë Ministrisë për Bujqësinë, Pyjet dhe Menaxhimin e Ujërave të Malit të Zi, për konsultimin e çështjeve në lidhje me ndikimin ndërkufitar.

Pas periudhës 6-mujore të konsultimeve (janar 2024), do të analizohen sugjerimet dhe komentet respektive dhe do të hartohet PMRP final për miratim në KKU dhe më pas në Këshillin e Ministrave, për të filluar fazën 6-vjeçare të zbatimit.

Në lidhje me ecurinë e përmbushjes së hapave, për basenet e tjerë:

- Me mbështetjen e projektit "Menaxhimi i integruar i rrezikut nga përmbytjet ndërkufitare në basenin e lumit Drin" me financimin e Adaptation Fund, zbatuar nga UNDP, janë krijuar hartat e rrezikut nga përmbytjet për 5 zonat e tjera të shpallura me rrezikshmëri nga përmbytjet në basenin Drin-Bunë. Për këto zona është në vijim procesi për hartimin e hartave të riskut dhe më pas hartimi i projekt PMRP;

- Nëpërmjet Western Balkans Investment Frameëork, është përmbushur procesi i krijimit të hartave të rezikut dhe riskut nga përmbytjet për të gjitha zonat e indentifikuara me rrezik nga përmbytjet për basenet Ishëm, Erzen, Shkumbin, Seman dhe Vjosë, dhe është në vijim procesi për hartimin e projekt-PMRP-ve;

Progresi aktual në përmbushjen e proceseve për secilin basen, pasqyrohet në figurën në vijim.




Figura 2. Paraqitje grafike e nivelit të përmbushjes së procesit të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet, në nivel baseni.

Proceset që do të përmbushen në vijim (2023-2024), referuar legjislacionit dhe pritshmërive janë:

- Miratimi i Planit të Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet në basenin ujor Drin-Bunë (zona e nën-Shkodrës) dhe vënia e tij në zbatim. Monitorimi i zbatueshmërisë dhe efektivitetit të masave të parashikuara në Planin e Menaxhimit të Rrrezikut nga Përmbytjet në basenin ujor Drin-Bunë (zona e nën-Shkodrës);

- Miratimi dhe publikimi i Raportit të rishikimit të vlerësimit paraprak të rrezikut nga përmbytjet;

- Miratimi i projekt-Planit të Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet në basenin ujor Drin-Bunë (zona e tjera të basenit DB) (Asistenca UNDP);

- Proceset në funksion të hartimit dhe miratimit të projekt-Planit të Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet në basenet Ishëm, Erzen, Shkumbin, Seman dhe Vjosë (Asistenca WBIF);

IV. VLERËSIMI PARAPRAK I RREZIKUT NGA PËRMBYTJET (MIRATUAR NË 2021)

Vlerësimi Paraprak i Rrezikut nga Përmbytjet, përbëhet nga 2 raporte:

- Raporti i Vlerësimit Paraprak të Rreziqeve nga Përmbytjet për Basenin Ujor Drin-Bunë, i realizuar nga AMBU me asistencën e projektit "Përshtatja ndaj Ndryshimeve Klimatike në Menaxhimin Ndërkufitar të Rrezikut nga Përmbytjet në Ballkanin Perëndimor", me mbështetjen e Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ), të zbatuar nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH;
- Raportin e Vlerësimit Paraprak të Rreziqeve nga Përmbytjet për basenet ujore Mat, Ishëm, Erzen, Shkumbin, Seman, Vjosë, realizuar nga AMBU me asistencën e projektit "Programi për Përmirësimin e Sistemit Kombëtar të Paralajmërimit të Hershëm dhe Parandalimit të Përmbytjeve në Shqipëri"- PRONEWS, përkatësisht komponenti C i projektit, i mbështetur nga Bashkimi Evropian;

Pjesë përbërëse e raporteve është edhe identifikimi i zonave ku ekziston rreziku nga përmbytjet ose ka gjasa të ndodhin ato për të 7 basenet ujore (identifikuar dhe shpallur 46 zona).

Dokumentet e mësipërme, në përmbushje të përcaktimeve të legjislacionit të zbatueshëm, janë miratuar me vendimin nr. 1, datë 15.6.2021, të Këshillit Kombëtar të Ujit dhe janë publikuar në faqen zyrtare të AMBU-së si edhe janë bërë prezent zyrtarisht të gjithë isntitucioneve relevante që kontribuojnë në menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet.

Fokusi kryesor në hartimin e Vlerësimit Paraprak të Rrezikut nga Përmbytjet (VPRP) ka qenë të ofrojë, duke përdorur të gjithë informacionet në dispozicion, një vlerësim të rreziqeve të mundshme, dhe qëllimi i tij final ishte identifikimi i zonave ku ekziston rreziku potencial i konsiderueshëm nga përmbytjet ose ka gjasa të ndodhin ato (ZRPP).

Metodologjia dhe hapat e punës, janë ndjekur në përputhje me kapitullin III, neni 4 i Direktivës së BE-së sipas së cilës, analiza e vlerësimit paraprak të rrezikut nga përmbytjet përfshin hartat e rretheve të basenit lumor, përshkrimin e historikut të përmbytjeve dhe ngjarjeve të kaluara, si dhe ndikimet negative në jetën e njerëzve, në ekonomi, mjedis dhe trashëgimi kulturore, duke përfshirë gjithashtu një përshkrim të ngjarjeve të mundshme që priten në të ardhmen dhe ndikimet potenciale të tyre.

Studimi dhe analizimi për vlerësimin e rrezikut nga përmbytjet, referuar Direktivës së BE-së, si pasojë e ngjarjeve të shkuara dhe analizave të risqeve të konsiderueshme, ka vlerësuar llojet e përmbytjeve (burimi i përmbytjes) që mund të konsiderohen gjatë identifikimit të zonave me rrezik potencial nga përmbytjet në kuadër të vlerësimit paraprak të rrezikut nga përmbytjet.

Konkretisht në VPRP për basenet ujore Mat, Ishëm, Erzen, Shkumbin, Seman, Vjosë dhe një territor të Basenit Ujor Drin-Bunë (përkon me Zonën Drin-Bunë 8), projekti ka marrë në konsideratë fillimisht përmbytjet nga lumenjtë dhe së dyti përmbytjet nga reshjet me intensitet të lartë (përmbytjet e shpejta).

Edhe në rastin e VPRP për Basenin Ujor Drin-Bunë, projekti ka vlerësuar me fokus kryesor:

- Përmbytjet nga lumenjtë (kur niveli i ujit në një lum ose përrua rritet dhe del në zonat përreth. Rritja e nivelit të ujit është zakonisht shumë më e ngadaltë (merr orë ose ditë) në krahasim me përmbytjet e shpejta të cilat shpesh ndodhin brenda pak minutave apo orëve. Megjithatë, dëmi nga përmbytjet e lumenjve mund të përhapet dhe masat ujore mund të shkaktojnë prishjen e digave dhe pritave).
- Përmbytjet bregdetare (përmbytjet në zonën përgjatë bregut nga uji i detit. Shkaqet e zakonshme janë kombinimi i stuhive të forta dhe baticave të larta (stuhi detare) apo tsunamit).

Fokusi kryesor në procesin e krijimit të hartave të rrezikut dhe të riskut është në përmbytjet nga lumenjtë. Efektet e baticave nga zonat bregdetare përfshihen në model si kufi i ulët në rajonet përkatëse të grykëderdhjes, si për shembull në rajonin e lumit Bunë në Shqipëri.

- Përmbytjet nga reshjet me intensitet të lartë (përmbytjet e shpejta dhe ujërat sipërfaqësore që ndodhin brenda një kohe shumë të shkurtër (rreth apo për më pak se 6 orë) në zona malore);
- Përmbytjet nga ujërat nëntokësorë (përmbytja e tokës nga ujërat nëntokësorë që dalin mbi sipërfaqen e tokës. Ky burim mund të përfshijë daljen e ujërave nëntokësorë dhe rrjedhat nëntokësore nga ujërat e ngritur sipërfaqësorë);
- Përmbytjet nga infrastruktura artificiale me ujë (përmbytja e tokës nga uji që del nga infrastruktura artificiale me ujë ose nga mosfunksionimi i kësaj infrastrukture. Ky burim mund të përfshijë përmbytjet që shkaktohen nga sistemet e kanalizimeve duke përfshirë ujërat nga shirat e stuhishëm, kanalizimet e kombinuara dhe të dëmtuara, sistemet e furnizimit me ujë dhe trajtimit të ujërave të ndotur urbane, kanalet artificiale të lundrimit dhe strukturat e mbyllura, p.sh. digat dhe rezervuarët).

Në lidhje me përmbytjet nga infrastruktura artificiale me ujë është konsideruar se:

- Rreziku i çarjes së digave konsiderohet si rrezik i ulët, sepse probabiliteti i çarjes së digave është më i ulët se 1/10.000, sipas projektit të digave dhe studimeve mbi çarjet e digave. Krahasuar me probabilitetin e përmbytjeve lumore (1/100, 1/500) ky nuk mund të konsiderohet probabilitet i lartë në metodologjinë e VPRP për përcaktimin e Zonave.
- Efektet prapavepruese të menaxhimit të liqeneve në rrjedhën përpara liqeneve (rritja e niveleve të ujit në bjefin e sipërm si pasojë e konsumit të vogël të ujit në HEC-e në stinët e lagështa) konsiderohen si përmbytje lumore për shkak të rritjes së nivelit të liqenit/rezervuarit.
- Efektet e menaxhimit të liqeneve në rrjedhën e poshtme (shkarkimi i ujit nga liqenet në situatat e përmbytjeve) konsiderohen gjithashtu në përmbytjet lumore, sepse kanalet në bjefin e poshtëm të liqeneve janë gjithashtu në fokus të rrezikut nga përmbytjet lumore poshtë digave.
- Kanalet e kullimit konsiderohen si përmbytje lumore, pasi ato janë të lidhura ngushtë me nivelet e ujit dhe përmbytjet në kanalet kryesore të Drinit/Bunës dhe nuk krijojnë zona të tjera risku.

Në proceset dhe dokumentet e VPRP të miratuar në vitin 2021, rezulton se ndryshimet klimatike janë shqyrtuar dhe marrë në konsideratë vetëm në VPRP për Basenin Ujor Drin-Bunë, ndërkohë në dokumentin e VPRP për basenet Mat, Ishëm, Erzen, Shkumbin, Seman, Vjosë, nuk evidentohen referenca apo analiza në lidhje me këtë element.

Konkretisht, në VPRP për Basenin Ujor Drin-Bunë, gjatë vlerësimit të rrezikut nga përmbytjet, ndikimet e pritura të ndryshimeve klimatike janë shqyrtuar duke përdorur skenarin ekstrem të përmbytjeve (rastet ekstreme të përmbytjeve, periudhat e kthimit ≥ 500 vjet) dhe këtu është vlerësuar se përfshihen të gjitha ndikimet e provuara, të njohura apo që parashikohen për të ardhmen, duke përfshirë ndryshimet klimatike.


VPRP bazohet, në të dhënat ekzistuese dhe bëhet pa modelim të sofistikuar meteo-hidrologjik (nëse ky informacion nuk ekziston). Por, VPRP-ja bazohet në zona, pak a shumë të përafërta, me zonat me rrezik nga përmbytjet, të gjeneruara nga përllogaritjet e niveleve maksimale të ujit, kryesisht pa modelim. Ndikimet e ndryshimeve klimatike në identifikimin e ZPRrP mbulohen kryesisht nga puna me skenarët ekstremë të rasteve të përmbytjeve. Skenari ekstrem përfshin një shtesë prej 25% në nivelin e ujit, i cili çon në përmbytje të zonave që nuk janë vëzhguar ende, por të cilat duhet të jenë të pranishme në zonat maksimale të rrezikut.
Dokumenti parashikon që nëse në VPRP, një zonë ose një tjetër përcaktohet si më e madhe sesa nevojitet, kjo do të vlerësohet në hapin e dytë të krijimit të hartave më të detajuara të rrezikut dhe riskut nga përmbytjet.

Rezultati final i VPRP të miratuar në vitin 2021, është identifikimi i 46 zonave me rrezik potencial nga përmbytjet apo ka gjasa të ndodhin përmbytje, në rang vendi.

Konkretisht, sipas baseneve ujore, në vijim paraqiten zonat dhe kartelat përkatëse:

1. BASENI UJOR DRIN-BUNË

Harta 1. Baseni Ujor Drin-Bunë dhe zonat me rrezik potencial nga përmbytjet.



Zonat me rrezik potencial nga përmbytjet, ose ku kanë gjasa të ndodhin përmbytjet (ZRrPP), në Basenin Ujor Drin-Bunë, referuar VPRP, të miratuar në vitin 2021.

Zona DRIN-BUNË 1


Zona e rrezikut	Shteti: Shqipëri Vendndodhja: Dibër	AL - 1
Përmbytje nga lumi:	Drini i Zi	
Seksioni i lumit:		
Km i lumit:	**në km:**	
Qytete/fshatra në rrezik:		
Fshati Potgorcë, Brezhdan, Zalldardhë, Gjoricë		
Vitet/ndodhitë në të shkuarën, dëmi:		
Muaji/viti	**Përshkrimi i dëmit**	
Nëntor 2016	Lumë i rrëmbyer. Aktiv në shira rrëke. 15 shtëpi në Barshaj të dëmtuara rëndë.	
Komente mbi ndodhitë e shkuara:		

Vendndodhja e basenit të lumenjve Drin – Bunë



Rreziqet e mundshme/pasuritë në zonën e rrezikut	
Zona e rrezikut (në hektarë)	90
Shtëpi	50-60
Persona	
Familje	
Kompani në rrezik	
Industri (objekte)	
Infrastrukturë (objekte)	1
Bujqësi [hektarë]/objekte	
Zona të mbrojtura	
Objekte të tjera në rrezik	Ura është e rrethuar me ujë


Gjendja në zonën e mundshme të rrezikut:




Vlerësimi i rrezikut/rëndësia e rreziqeve të mundshme			
Kriteri i rëndësisë	*vlera*	*kufiri*	
A) Shëndeti i njeriut, vlerat ekonomike			
nr. i shtëpive		≥ 10	
Sipërfaqe vendbanimi(në hektarë)		≥ 0,5	
Objekte industriale		≥ 1	
Zonë industriale (në hektarë)		≥ 0,5	
Aspekte të rëndësishme të bujqësisë			
B) Rreziqet mjedisore			
B1) Substancat/zonat ndotëse të ujit			
Vendet e ndotura		≥ 1	
Vendndodhje me substanca të rrezikshme		≥ 1	
B2) Zona të mbrojtura (sipas WRRL)			
Zona të mbrojtura(p.sh. Natura 2000 etj.)		≥ 1	
Zonat e fumizimit me ujë të pijshëm		≥ 1	
Ujëra për banja		≥ 1	
C) Rreziku për zonat e trashëgimisë kulturore			
Vendet e trashëgimisë së UNESCO		≥ 1	
Zona të tjera të trashëgimisë kulturore		≥ 1	

Shpjegime/koment për vlerësimin e rrezikut	**Komente të përgjithshme për këtë zonë të mundshme rreziku**
Në fshatin Potgorcë, njësia administrative Maqellarë, për shkak të rritjes së nivelit të ujit të lumit Drin dhe shirave kërcënohen rreth 3-5 shtëpi, si dhe toka bujqësore. Në fshatin Brezhdan, njësia administrative Tomin, për shkak të rritjes së nivelit të ujit të lumit Drin dhe reshjeve, rrezikohen rreth 50 hektarë tokë bujqësore. Në fshatin Zalldardhë, njësia administrative Zalldardhë, për shkak të rritjes së nivelit të ujit të lumit Drin dhe shirave, kërcënohen rreth 40 hektarë tokë bujqësore. Në fshatin Gjoricë, njësia administrative Gjoricë, për shkak të rritjes së nivelit të ujit të lumit Drin dhe shirave, rrezikohen rreth 40-50 apartamente, si dhe toka bujqësore.	

ZONA 1a ZONA 1b ZONA 1c







Zona DRIN-BUNË 2

Zona e rrezikut	Shteti: Shqipëri	AL - 2
	Vendndodhja: Kukës	

Menaxhimi i rezervuarit - hidrocentralit:	Drini i Zi
Seksioni i lumit:	Qyteti i Kukësit
Km i lumit: 75	**në km:** 80
Qytete/fshatra në rrezik:	
Fshati Perbreg	

Vendndodhja e basenit të lumenjve Drin – Bunë



Vitet/ndodhitë në të shkuarën, dëmi:


Muaji/viti	Përshkrimi i dëmit
Maj 2012	Përmbytje nga lumi: Fshati Përbreg/Breg Lum (Njësia administrative Terthore)

Komente mbi ndodhitë e shkuara:

Rreziqet e mundshme/pasuritë në zonën e rrezikut	
Zona e rrezikut (në hektarë)	50 hektarë
Shtëpi	~30
Persona	~200
Familje	~30
Kompani në rrezik	
Industri (objekte)	
Infrastrukturë (objekte)	
Bujqësi [hektarë]/objekte	
Zona të mbrojtura	
Objekte të tjera në rrezik	Shtëpi dhe tokë e punueshme

Gjendja në zonën e mundshme të rrezikut:






Vlerësimi i rrezikut/rëndësia e rreziqeve të mundshme			
Kriteri i rëndësisë	*vlera*	*kufiri*	
A) Shëndeti i njeriut, vlerat ekonomike			
nr. i shtëpive	30	≥ 10	
Sipërfaqe vendbanimi(në hektarë)	>1	≥ 0,5	
Objekte industriale	0	≥ 1	
Zonë industriale (në hektarë)	0	≥ 0,5	
Aspekte të rëndësishme të bujqësisë	0		
B) Rreziqet mjedisore			
B1) Substancat/zonat ndotëse të ujit			
Vendet e ndotura	0	≥ 1	
Vendndodhje me substanca të rrezikshme	0	≥ 1	
B2) Zona të mbrojtura (sipas WRRL)			
Zona të mbrojtura(p.sh. Natura 2000 etj.)	0	≥ 1	
Zonat e furnizimit me ujë të pijshëm	0	≥ 1	
Ujëra për banja	0	≥ 1	
C) Rreziku për zonat e trashëgimisë kulturore			
Vendet e trashëgimisë së UNESCO	0	≥ 1	
Zona të tjera të trashëgimisë kulturore	0	≥ 1	

Harta nga planifikimi vendor i territorit, Kukës 2017 (burimi AKPT)

Shpjegime/koment për vlerësimin e rrezikut	**Komente të përgjithshme për këtë zonë të mundshme rreziku**
Përllogaritja bazohet në të dhënat e mbledhura nga DPEC Shqipëri dhe raportet e lajmeve.	Zona e rrezikut shkaktohet nga administrimi i hidrocentralit të Fierzës (kur uji i rezervuarit arrin deri në 297 mbi nivelin e detit)



Zona DRIN-BUNË 3


Zona e rrezikut	**Shteti:**	**Shqipëri**	**AL - 3**
	Vendndodhja: Tropojë		

Përmbytje e menjëhershme:	Lumi i Valbonës (degë e Drinit)
Seksioni i lumit:	
Km i lumit: 115	**në km:**
Qytete/fshatra në rrezik:	
Njësia administrative e Tropojës. Fshatrat Selimaj, Muldakaj, Vidricë, Rosujë etj. Përmbytje e rrëmbyeshme nga lumenjtë Murataj, Dedaj, Mejdan, Lug i Zi	
Vitet/ndodhitë në të shkuarën, dëmi:	
Muaji/viti	**Përshkrimi i dëmit**
Nëntor 2016	Përmbytje të menjëhershme nga shirat e dendur. Disa fshatra janë prekur. 15 shtëpi të prekura nga përmbytjet në lagjen Partizani të Bajram Currit. 2 shtëpi të dëmtuara në Bujan, kryesisht për shkak të rrëshqitjes së tokës. Ura të dëmtuara në fshatrat Viçidol, Tropojë e Vjetër, Lekbibaj, Geghysen, T'pla të rrethit të Tropojës, Bashkia Tropojë. Tokë e përmbytur në fshatrat T'plan, Viçdol, Tropojë.
Komente mbi ndodhitë e shkuara:	
Rreziqet e mundshme/pasuritë në zonën e rrezikut	
Zona e rrezikut (në hektarë)	>100
Shtëpi	>20
Persona	>100
Familje	>20
Kompani në rrezik	
Industri (objekte)	
Infrastrukturë (objekte)	1
Bujqësi [hektarë]/objekte	
Zona të mbrojtura	
Objekte të tjera në rrezik	Kryesisht urat, rrugët dhe disa shtëpi. (20 të raportuara)

Vendndodhja e basenit të lumenjve Drin – Bunë



Gjendja në zonën e mundshme të rrezikut:




Google Map tregon zonën ku ndodh përmbytja menjëhershme.

Vlerësimi i rrezikut/rëndësia e rreziqeve të mundshme			
Kriteri i rëndësisë	*vlera*	*kufiri*	
A) Shëndeti i njeriut, vlerat ekonomike			
nr. i shtëpive	>20	≥ 10	
Sipërfaqe vendbanimi(në hektarë)	>1	≥ 0,5	
Objekte industriale	0	≥ 1	
Zonë industriale (në hektarë)	0	≥ 0,5	
Aspekte të rëndësishme të bujqësisë			
B) Rreziqet mjedisore			
B1) Substancat/zonat ndotëse të ujit			
Vendet e ndotura	0	≥ 1	
Vendndodhje me substanca të rrezikshme	0	≥ 1	
B2) Zona të mbrojtura (sipas WRRL)			
Zona të mbrojtura(p.sh. Natura 2000 etj.)	1	≥ 1	
Zonat e furnizimit me ujë të pijshëm	0	≥ 1	
Ujëra për banja	0	≥ 1	
C) Rreziku për zonat e trashëgimisë kulturore			
Vendet e trashëgimisë së UNESCO	0	≥ 1	
Zona të tjera të trashëgimisë kulturore	0	≥ 1	



Harta, Planifikimi Vendor i Territorit të Bashkisë Tropojë (Burimi, AKPT)

Shpjegime/koment për vlerësimin e rrezikut	**Komente të përgjithshme për këtë zonë të mundshme rreziku**
Përshkrimet janë mbledhur nga mediat. Drejtoria e Emergjencave Civile i ka konsideruar si përmbytje të menjëhershme dhe të dhënat duhen dokumentuar.	Kjo zonë është përmbytur nga përmbytjet e menjëhershme të shkaktuara nga shirat e dendura.



Zona DRIN-BUNË 4

Zona e rrezikut	Shteti: Shqipëri	AL - 4
	Vendndodhja: Qyteti i Shkodrës	

Përmbytje nga lumi:	Lumi i Kirit
Seksioni i lumit:	
Km i lumit: 185 (i Drinit)	**në km:**
Qytete/fshatra në rrezik:	
Fshati Bleran	

Vitet/ndodhitë në të shkuarën, dëmi:

Muaji/viti	Përshkrimi i dëmit
Dhjetor 2012	Lumë i rrëmbyer. Aktiv në shirat e dendura. 15 shtëpi në Bardhaj të dëmtuara rëndë.
Mars 2018	Fshati Bardhaj i rrethuar nga uji

Komente mbi ndodhitë e shkuara: Fshati Bardhaj përmbytet sa herë që ka përmbytje të mëdha të shkaktuara nga shirat e dendura.

Rreziqet e mundshme/pasuritë në zonën e rrezikut

Zona e rrezikut (në hektarë)	250
Shtëpi	30
Persona	150
Familje	30
Kompani në rrezik	
Industri (objekte)	
Infrastrukturë (objekte)	1
Bujqësi [hektarë]/objekte	
Zona të mbrojtura	
Objekte të tjera në rrezik	Ura është e rrethuar me ujë

Vlerësimi i rrezikut/rëndësia e rreziqeve të mundshme

Kriteri i rëndësisë	*vlera*	*kufiri*	
A) Shëndeti i njeriut, vlerat ekonomike			
nr. i shtëpive	30	≥ 10	
Sipërfaqe vendbanimi(në hektarë)	>1	≥ 0,5	
Objekte industriale	0	≥ 1	
Zonë industriale (në hektarë)	0	≥ 0,5	
Aspekte të rëndësishme të bujqësisë			
B) Rreziqet mjedisore			
B1) Substancat/zonat ndotëse të ujit			
Vendet e ndotura	0	≥ 1	
Vendndodhje me substanca të rrezikshme	0	≥ 1	
B2) Zona të mbrojtura (sipas WRRL)			
Zona të mbrojtura(p.sh. Natura 2000 etj.)	0	≥ 1	
Zonat e furnizimit me ujë të pijshëm	0	≥ 1	
Ujëra për banja	0	≥ 1	
C) Rreziku për zonat e trashëgimisë kulturore			
Vendet e trashëgimisë së UNESCO	0	≥ 1	
Zona të tjera të trashëgimisë kulturore	0	≥ 1	

Vendndodhja e basenit të lumenjve Drin – Bunë



Gjendja në zonën e mundshme të rrezikut:



Harta e objekteve në rrezik, Plani i menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet në Shkodër (GIZ, 2015)



Harta e zonës me rrezik të lartë përmbytjeje nga lumi i Kirit. Burimi - Planifikimi Vendor i Territorit të Shkodrës (AKPT)

Shpjegime/koment për vlerësimin e rrezikut	Komente të përgjithshme për këtë zonë të mundshme rreziku
Lumi Kir është me rrezik të lartë përmbytjeje.	



Zona DRIN-BUNË 5

Zona e rrezikut	**Shteti:**	**Shqipëri**	**AL - 5**
	Vendndodhja: Liqeni i Shkodrës/Qyteti i Shkodrës dhe Rrethina		

Përmbytje nga liqeni:	Liqeni i Shkodrës
Seksioni i lumit:	
Km i lumit: 185 (i Drinit)	**në km:**
Qytete/fshatra në rrezik:	
Qyteti i Shkodrës (Xhabija)	
Njësia administrative Rrethina	
Vitet/ndodhitë në të shkuarën, dëmi:	
Muaji/viti	**Përshkrimi i dëmit**
2009	Zona e quajtur " Livadhe" e përmbytur.
Janar 2010	Qyteti i Shkodrës Zona e quajtur "Livadhe" e përmbytur. U përmbytën 400 objekte, nga të cilat 200 biznese
Dhjetor 2010	Lagjja Xhabija në hyrje të qytetit të Shkodrës u përmbyt. Qyteti i Shkodrës Zona e quajtur "Livadhe" e përmbytur. U përmbytën 400 objekte, nga të cilat 200 biznese.
Nëntor 2016	Zona administrative e Dajçit u përmbyt
Mars 2018	Rrethinat u përmbyt. Asnjë objekt i përmbytur, vetëm tokë
Komente mbi ndodhitë e shkuara: Në deltën e poshtme të Drinit u përmbyt vetëm tokë.	

Vendndodhja e basenit të lumenjve Drin – Bunë



Gjendja në zonën e mundshme të rrezikut:



Harta e objekteve në rrezik, Plani i menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet në Shkodër (GIS, 2015)



Me blu të errët paraqitet harta e zonës me rrezik të lartë nga përmbytjet e Liqenit të Shkodrës. Burimi - Planifikimi Vendor i Territorit të Shkodrës (AKPT)

Rreziqet e mundshme/pasuritë në zonën e rrezikut	
Zona e rrezikut (në hektarë)	11,000
Shtëpi	200
Persona	>1.000
Familje	>150
Kompani në rrezik	200
Industri (objekte)	>5
Infrastrukturë (objekte)	>5
Bujqësi [hektarë]/objekte	
Zona të mbrojtura	2
Objekte të tjera në rrezik	Infrastruktura e furnizimit me ujë; biznese, rrugë

Vlerësimi i rrezikut/rëndësia e rreziqeve të mundshme			
Kriteri i rëndësisë	*vlera*	*kufiri*	
A) Shëndeti i njeriut, vlerat ekonomike			
nr. i shtëpive	200	≥ 10	
Sipërfaqe vendbanimi(në hektarë)	>1	≥ 0,5	
Objekte industriale	>5	≥ 1	
Zonë industriale (në hektarë)	>5	≥ 0,5	
Aspekte të rëndësishme të bujqësisë			
B) Rreziqet mjedisore			
B1) Substancat/zonat ndotëse të ujit			
Vendet e ndotura	>2	≥ 1	
Vendndodhje me substanca të rrezikshme	>2	≥ 1	
B2) Zona të mbrojtura (sipas WRRL)			
Zona të mbrojtura(p.sh. Natura 2000 etj.)	2	≥ 1	
Zonat e furnizimit me ujë të pijshëm	>2	≥ 1	
Ujëra për banja	>2	≥ 1	
C) Rreziku për zonat e trashëgimisë kulturore			
Vendet e trashëgimisë së UNESCO	0	≥ 1	
Zona të tjera të trashëgimisë kulturore	>2	≥ 1	

Shpjegime/koment për vlerësimin e rrezikut	**Komente të përgjithshme për këtë zonë të mundshme rreziku**
Zona është studiuar mirë dhe matjet janë pjesë e planit të menaxhimit të përmbytjeve në Shkodër në vitin 2015. Kjo zonë mban liqenin. Zona e rrezikut pranë vendbanimeve ka avancuar përtej vijës së rrezikut. Por, qyteti i Shkodrës është zona me ndikimin më të madh të rrezik, ku u dëmtua shumë infrastruktura dhe një sërë objektesh	Zonë me rrezik shumë të lartë dhe shpeshtë nën rrezikun e mundshëm të përmbytjes.

Zona DRIN-BUNË 6

Zona e rrezikut	**Shteti: Shqipëri**	**AL - 6**
	Vendndodhja: Rajoni i Shkodrës	

Përmbytje nga lumi:	Drin, Buna
Seksioni i lumit:	Nën qytetin e Shkodrës deri në Adria (gryka)/dhe Vau i Dejës
Km i lumit: 170	**në km:** 220
Qytete/fshatra në rrezik:	
Qyteti i Shkodrës dhe njësia administrative e Vaut të Dejës, Guri i Zi, Bërdicë, Dajç, Ana e Malit, Velipojë, Rrethina dhe Bushat. ** informacion shtesë, shihni komentet*	

Vitet/ndodhitë në të shkuarën, dëmi:	
Muaji/viti	**Përshkrimi i dëmit**
Nëntor 1962 – Shkurt 1963	Zadrima e Shkodrës dhe Lezha, Bregu i Bunës, 18,575 hektarë; Fushat mes Drinit të Lezhës dhe Matit, 3,122 hektarë
Nëntor 1992	pjesa më e madhe e dëmit i është shkaktuar banesave, bagëtive dhe të korrave. Gjithashtu: rrugë, ura, brigjet e lumenjve dhe rrjetet e ujitjes. 17 000 hektarë tokë bujqësore e përmbytur. Kishte ndërprerje të mëdha të energjisë elektrike.
Dhjetor 2009 & Janar 2010	Në qarqet e Shkodrës dhe të Lezhës, u përmbytën: pothuajse 10 000 hektarë; > 5000 njerëz u evakuuan (mund të ishin më shumë); 22 000 shtëpi u dëmtuan. (Raporti i komisionit të emergjencave: afërsisht 14 500 persona)
Dhjetor 2010	12 145 banorë të evakuuar; 7120 shtëpi të prekura (4540 të përmbytura, 2580 në zonën e përmbytjes); objekte të përmbytura > 400 të llojeve të ndryshme.
Mars 2013	Dajç, Bërdicë dhe Ana e Malit: 4900 hektarë tokë e punueshme e përmbytur, 315 shtëpi në zonën e përmbytur, 140 familje të evakuuara.
Mars 2018	Dajç, Bërdicë dhe Ana e Malit: 6800 hektarë tokë e punueshme e përmbytur, 59 shtëpi të rrethuara nga uji.
Komente mbi ndodhitë e shkuara:	

Rreziqet e mundshme/pasuritë në zonën e rrezikut	
Zona e rrezikut (në hektarë)	> 12 000
Shtëpi	> 7000
Persona	> 15 000
Familje	> 3000
Kompani në rrezik	ndërtesa biznesi
Industri (objekte)	
Infrastrukturë (objekte)	> 400 (shihni më poshtë)
Bujqësi [hektarë]/objekte	Sipërfaqe e madhe bujqësore, të mbjella delikate dhe nr. i madh kafshësh
Zona të mbrojtura	Sipërfaqja e mbrojtur e lumit të Bunës
Objekte të tjera në rrezik	Shërbime publike (furnizimi me ujë, spitale, shkolla, ndërtesa fetare, furnizimi me energji)

Vlerësimi i rrezikut/rëndësia e rreziqeve të mundshme			
Kriteri i rëndësisë	*vlera*	*kufiri*	
A) Shëndeti i njeriut, vlerat ekonomike			
nr. i shtëpive	7000	≥ 10	
Sipërfaqe vendbanimi(në hektarë)	>5000	≥ 0,5	
Objekte industriale	>5	≥ 1	
Zonë industriale (në hektarë)	>2	≥ 0,5	
Aspekte të rëndësishme të bujqësisë	X		
B) Rreziqet mjedisore			
B1) Substancat/zonat ndotëse të ujit			
Vendet e ndotura	0	≥ 1	
Vendndodhje me substanca të rrezikshme	0	≥ 1	
B2) Zona të mbrojtura (sipas WRRL)			
Zona të mbrojtura(p.sh. Natura 2000 etj.)	1	≥ 1	
Zonat e furnizimit me ujë të pijshëm	3	≥ 1	
Ujëra për banja	0	≥ 1	
C) Rreziku për zonat e trashëgimisë kulturore			
Vendet e trashëgimisë së UNESCO	0	≥ 1	
Zona të tjera të trashëgimisë kulturore	3	≥ 1	


Vendndodhja e basenit të lumenjve Drin – Bunë



Gjendja në zonën e mundshme të rrezikut:



Harta e objekteve në rrezik, (Plani i menaxhimit të rrezikut nga përmbytje në Shkodër GIZ, 2015)



Harta e zonës me rrezik të lartë nga përmbytjet në lumin e Bunës. Ngjyra blu e errët tregon shtrirjen e përmbytjes. Burimi: Plani Vendor i Territorit të Shkodrës – AKPT) - shihni më poshtë në shkallë më të gjerë

Shpjegime/koment për vlerësimin e rrezikut	**Komente të përgjithshme për këtë zonë të mundshme rreziku**
	Zona/fshatra të veçanta brenda kësaj sipërfaqeje (Livadhe, Bahçallëk, Persash, Bahçja e Cakajve, Ajasëm, Kuç, Rrenc, Guri i Zi, Trush, Bërdicë e Sipërme, Bërdicë e Mesme, Bërdicë e Madhe, Beltoje, Belaj, Rrushkull, Shirq, Mushan, Samrish, Suka, Pentar, Obot, Oblikë, Muriqan, Baks-Rrjoll, Cas, Luarz, Pulaj, Fshat i Ri (Trush i Poshtëm), Mali i Jushit, Rranxa, Konaj, Hoten

Zona DRIN-BUNË 7

Zona e rrezikut	Shteti: Shqipëri Vendndodhja: Lezha	AL - 7


Përmbytje nga lumi	Lumi (ish) Drin i vjetër
Seksioni i lumit:	
Km i lumit:	**në km:**
Qytete/fshatra në rrezik:	
Sipërfaqja e prekur shtrihet në deri në qytetin e Lezhës; fshatrat Blinisht; Mabë; Zojz; Gocaj; Trorovicë dhe Ishull Shëngjin. Barbullonje, Tresh, Zejmen, Kolsh.	
Vitet/ndodhitë në të shkuarën, dëmi:	
Muaji/viti	**Përshkrimi i dëmit**
Nëntor 1962	zona e poshtme e Lezhës e përmbytur nga shtrati i vjetër i lumit
Shkurt 1963	zona e poshtme e Lezhës e përmbytur nga shtrati i vjetër i lumit. Erozion i rëndë i tokës. Nuk ka të dhëna për vendbanimet.
2002	një kuotë kritike e lumit Drin në Lezhë është + 2,2 m, të përmbytura; komuna Blinisht, fshati Bacel dhe 200 hektarë tokë bujqësore. kuota rritet (shtator 2002) në + 3,04 m, mbi 5000 hektarë tokë e përmbytur. Zona e Torovicës, sipërfaqe prej 2200 hektarë, kuotë kritike është + 1,7 – 1,8 m dhe 600 hektarë
2010	sipërfaqe toke në zonën administrative Blinisht dhe rrethinat u përmbytën nga shirat e dendura dhe kapaciteti i ulët i tërheqjes së ujit. Gjithashtu i përmbyt një sipërfaqe prej 2000 hektarësh tokë e punueshme në Torovicë dhe 100 shtëpi në fshatin Barbulloja. Në Lezhë u përmbyt një sipërfaqe ndërtimesh prej 20 hektarësh.

Komente mbi ndodhitë e shkuara: Lumi Drin ka kaluar në këtë zonë, por pas përmbytjes së vitit 1963 dhe ndërtimit të digave, lumi është i fjetur dhe përdoret kryesisht si kanal kullimi. Sipërfaqja e prekur në këtë zonë është më shumë në nivelin e ulët të tokës dhe kapacitetin e ulët të tokës për të tërhequr ujërat.

Vendndodhja e basenit të lumenjve Drin – Bunë



Gjendja në zonën e mundshme të rrezikut:



Tregohet shtrirja e përmbytjes (Google maps). Planifikimi Vendor i Territorit të Lezhës (Burimi AKPT)


Rreziqet e mundshme/pasuritë në zonën e rrezikut	
Zona e rrezikut (në hektarë)	*9500* hektarë
Shtëpi	>100
Persona	>2000
Familje	>400
Kompani në rrezik	
Industri (objekte)	
Infrastrukturë (objekte)	>1
Bujqësi [hektarë]/objekte	~ *8500* hektarë
Zona të mbrojtura	1
Objekte të tjera në rrezik	Zona strehimi, shërbimet publike që përfshijnë furnizimin me ujë, spitalet, shkollat, ndërtesat fetare, sistemet e furnizimit me energji, ndërtesat e biznesit,

Vlerësimi i rrezikut/rëndësia e rreziqeve të mundshme			
Kriteri i rëndësisë	*vlera*	*kufiri*	
A) Shëndeti i njeriut, vlerat ekonomike			
nr. i shtëpive	>100	≥ 10	
Sipërfaqe vendbanimi(në hektarë)	*860*	≥ 0,5	
Objekte industriale	0	≥ 1	
Zonë industriale (në hektarë)	*80*	≥ 0,5	
Aspekte të rëndësishme të bujqësisë	x		
B) Rreziqet mjedisore			
B1) Substancat/zonat ndotëse të ujit			
Vendet e ndotura	0	≥ 1	
Vendndodhje me substanca të rrezikshme	0	≥ 1	
B2) Zona të mbrojtura (sipas WRRL)			
Zona të mbrojtura(p.sh. Natura 2000 etj.)	>2	≥ 1	
Zonat e furnizimit me ujë të pijshëm	0	≥ 1	
Ujëra për banja	>1	≥ 1	
C) Rreziku për zonat e trashëgimisë kulturore			
Vendet e trashëgimisë së UNESCO	0	≥ 1	
Zona të tjera të trashëgimisë kulturore	>1	≥ 1	

Shpjegime/koment për vlerësimin e rrezikut	**Komente të përgjithshme për këtë zonë të mundshme rreziku**
Zona e Lezhës është në rrezik të lartë nga shumë burime: deti, lumi, rrëketë, përmbytjet, erozioni, sistemi i shkarkimit.	Rreziku në Lezhë vjen nga të dyja anët. Lumi dhe sistemi i shkarkimit, si dhe rritja e nivelit të detit kanë përparuar shumë në vitet e fundit duke rritur kështu nivelin e ashpërsinë së ndodhive. Në 2010 rritja e nivelit të detit bllokoi shkarkimin e ujërave. Qyteti i Lezhës është pikë e nxehtë, si një nga zonat që është prekur më shpesh. Fshati Barbullojë është zonë me rrezik të lartë, që tregohet me drejtkëndësh me germën B në hartë.

Kufiri është tejkaluar | Ska informacion/ i papërcaktuar | Kufiri nuk është tejkaluar


Zona DRIN-BUNË 8



ID_APSFR sipas projektit Pronews: Drini_3
Lokalizimi: Barbullush - Gjader
Baseni kryesor: Drini (Lezhe)
Numri i gjatësive unitare të lumit: 4
Gjatësia totale: 16 km
Gjatësia me risk të lartë: 16 km
Gjatësia me risk shumë të lartë: -
Numri i pikave të interesit: 11
Niveli i Indeksit të Riskut për Popullsinë: I ulët
Niveli i Indeksit të Riskut për Bujqësinë: I larte
Niveli i Indeksit të Riskut për Rrjetin e Rrugëve: I lartë
Argjinaturat: Statusi: -
Zonë e mundshme e përmbytjeve [km^2]: 126
Personat potencialisht të prekur: 4183
Ngjarjet e kaluara: 32

2. BASENI UJOR MAT

Harta 2. Baseni Ujor Mat dhe zonat me rrezik potencial nga përmbytjet.




Zonat me rrezik potencial nga përmbytjet, ose ku kanë gjasa të ndodhin përmbytjet (ZRrPP), në Basenin Ujor Mat, referuar Vlerësimit paraprak të rrezikut nga përmbytjet, të miratuar në vitin 2021.

Zona MAT 1



ID_APSFR sipas projektit Pronews: Mat_1
Lokalizimi: Fushë Arrëz
Baseni kryesor: Mat (Fan)
Numri i gjatësive unitare të lumit: 1
Gjatësia totale: 5 km
Gjatësia me risk të lartë: 5 km
Gjatësia me risk shumë të lartë: -
Numri i pikave të interesit: 1
Niveli i Indeksit të Riskut për Popullsinë: I ulët
Niveli i Indeksit të Riskut për Bujqësinë: I lartë
Niveli i Indeksit të Riskut për Rrjetin e Rrugëve: I lartë
Argjinaturat: -
Zonë e mundshme e përmbytjeve [km²]: 2
Personat potencialisht të prekur: 212
Ngjarjet e kaluara: 2


Zona MAT 2



ID_APSFR sipas projektit Pronews: Mat_2
Lokalizimi Shtrirja përfundimtare (nga Zog deri në grykëderdhjen) Prefektura Lezha
Baseni kryesor: Mat
Numri i gjatësive unitare të lumit: 4
Gjatësia totale: 20 km
Gjatësia me risk të lartë: 15 km
Gjatësia me risk shumë të lartë: 5
Numri i pikave të interesit: 0
Niveli i Indeksit të Riskut për Popullsinë: I ulët
Niveli i Indeksit të Riskut për Bujqësinë: Mesatarë
Niveli i Indeksit të Riskut për Rrjetin e Rrugëve: Mesatarë
Argjinaturat: Statusi**:** ndërhyrja e nevojshme (banka e drejtë), pjesërisht ndërhyrja (banka e majtas) Lartësia: 3 m (banka e majtas), 4 m (banka e drejtë)
Zonë e mundshme e përmbytjeve [km^2]: 10
Personat potencialisht të prekur: 1455
Ngjarjet e kaluara: 21


3. BASENI UJOR ISHËM

Harta 3. Baseni Ujor Ishëm dhe zonat me rrezik potencial nga përmbytjet.



Zonat me rrezik potencial nga përmbytjet, ose ku kanë gjasa të ndodhin përmbytjet (ZRrPP), në Basenin Ujor Ishëm, referuar Vlerësimit paraprak të rrezikut nga përmbytjet, të miratuar në vitin 2021.

Zona ISHËM 1



ID_APSFR sipas projektit Pronews: Ishëm _1
Lokalizimi: Tiranë, qyteti
Baseni kryesor: Ishëm
Numri i gjatësive unitare të lumit: 6
Gjatësia totale: 29 km
Gjatësia me risk të lartë: 16 km
Gjatësia me risk shumë të lartë: 13
Numri i pikave të interesit: 20
Niveli i Indeksit të Riskut për Popullsinë: I lartë
Niveli i Indeksit të Riskut për Bujqësinë: shumë të ulëta
Niveli i Indeksit të Riskut për Rrjetin e Rrugëve: I lartë
Argjinaturat: Statusi: -
Zonë e mundshme e përmbytjeve [km²]: 11
Personat potencialisht të prekur: 88521
Ngjarjet e kaluara: 24

Zona ISHËM 2



ID_APSFR sipas projektit Pronews: Ishem _2
Lokalizimi: Fushë-Krujë
Baseni kryesor: Ishem
Numri i gjatësive unitare të lumit: 5
Gjatësia totale: 19 km
Gjatësia me risk të lartë: 19 km
Gjatësia me risk shumë të lartë: -
Numri i pikave të interesit: 2
Niveli i Indeksit të Riskut për Popullsinë: I ulët
Niveli i Indeksit të Riskut për Bujqësinë: Mesatarë
Niveli i Indeksit të Riskut për Rrjetin e Rrugëve: I lartë
Argjinaturat: Statusi: e keqe, intervenimi i nevojshëm Lartësia: 2.5 m
Zonë e mundshme e përmbytjeve [km^2]: 25
Personat potencialisht të prekur: 3368
Ngjarjet e kaluara: 21


Zona ISHËM 3



ID_APSFR sipas projektit Pronews: Ishem _4
Lokalizimi: Rinas
Baseni kryesor: Ishem
Numri i gjatësive unitare të lumit: 1
Gjatësia totale: 6 km
Gjatësia me risk të lartë: 6 km
Gjatësia me risk shumë të lartë: -
Numri i pikave të interesit: 3
Niveli i Indeksit të Riskut për Popullsinë: Mesatarë
Niveli i Indeksit të Riskut për Bujqësinë: Mesatarë
Niveli i Indeksit të Riskut për Rrjetin e B
Argjinaturat: -
Zonë e mundshme e përmbytjeve [km^2]: 8
Personat potencialisht të prekur: 3093
Ngjarjet e kaluara: -


4. BASENI UJOR ERZEN

Harta 4. Baseni Ujor Erzen dhe zonat me rrezik potencial nga përmbytjet.




Zonat me rrezik potencial nga përmbytjet, ose ku kanë gjasa të ndodhin përmbytjet (ZRrPP), në Basenin Ujor Erzen, referuar Vlerësimit paraprak të rrezikut nga përmbytjet, të miratuar në vitin 2021.

Zona ERZEN 1



ID_APSFR sipas projektit Pronews: Erzen_3
Lokalizimi: shtrirje përfundimtare, Prefektura Durrës
Baseni kryesor: Erzen
Numri i gjatësive unitare të lumit: 3
Gjatësia totale: 27 km
Gjatësia me risk të lartë: 27 km
Gjatësia me risk shumë të lartë: -
Numri i pikave të interesit: 0
Niveli i Indeksit të Riskut për Popullsinë: Mesatarë
Niveli i Indeksit të Riskut për Bujqësinë: Mesatarë
Niveli i Indeksit të Riskut për Rrjetin e Rrugëve: I lartë
Argjinaturat: Statusi: e keqe, intervenimi i nevojshëm Lartësia: 3 m
Zonë e mundshme e përmbytjeve [km²]: 4
Personat potencialisht të prekur: 1166
Ngjarjet e kaluara: 15

Zona ERZEN 2



ID_APSFR sipas projektit Pronews: Erzen_5
Lokalizimi: Kthesa Ariut, Prefektura Durrës
Baseni kryesor: Erzen
Numri i gjatësive unitare të lumit: 1
Gjatësia totale: 4 km
Gjatësia me risk të lartë: 4 km
Gjatësia me risk shumë të lartë: -
Numri i pikave të interesit: 4
Niveli i Indeksit të Riskut për Popullsinë: Mesatarë
Niveli i Indeksit të Riskut për Bujqësinë: Mesatarë
Niveli i Indeksit të Riskut për Rrjetin e Rrugëve: Mesatarë
Argjinaturat: Statusi: e keqe, intervenimi i nevojshëm Lartësia: 3 m
Zonë e mundshme e përmbytjeve [km^2]: 9
Personat potencialisht të prekur: 4543
Ngjarjet e kaluara: -

Zona ERZEN 3



ID_APSFR sipas projektit Pronews: Erzen_6
Lokalizimi: Durrës, qyteti
Baseni kryesor: Kanal Kullues
Numri i gjatësive unitare të lumit: 1
Gjatësia totale: 5 km
Gjatësia me risk të lartë: -
Gjatësia me risk shumë të lartë: 5 km
Numri i pikave të interesit: 20
Niveli i Indeksit të Riskut për Popullsinë: I lartë
Niveli i Indeksit të Riskut për Bujqësinë: shumë e ulët
Niveli i Indeksit të Riskut për Rrjetin e Rrugëve: Mesatarë
Argjinaturat: Statusi: -
Zonë e mundshme e përmbytjeve [km^2]: 10
Personat potencialisht të prekur: 47913
Ngjarjet e kaluara: 6

Zona ERZEN 4



ID_APSFR sipas projektit Pronews: Erzen_7
Lokalizimi: Ndroq, Prefektura Tiranë
Baseni kryesor: Erzen
Numri i gjatësive unitare të lumit: 1
Gjatësia totale: 5 km
Gjatësia me risk të lartë: 5 km
Gjatësia me risk shumë të lartë: -
Numri i pikave të interesit: 1
Niveli i Indeksit të Riskut për Popullsinë: I ulët
Niveli i Indeksit të Riskut për Bujqësinë: I lartë
Niveli i Indeksit të Riskut për Rrjetin e Rrugëve: I lartë
Argjinaturat: Statusi: -
Zonë e mundshme e përmbytjeve [km^2]: 4
Personat potencialisht të prekur: 434
Ngjarjet e kaluara: 2

Zona ERZEN 5



ID_APSFR sipas projektit Pronews: Shkumbini_6 (sipas ndarjes së vjetër hidrografike)
Lokalizimi: Kavaje
Baseni kryesor: Erzen
Numri i gjatësive unitare të lumit: 1
Gjatësia totale: 3 km
Gjatësia me risk të lartë: 3 km
Gjatësia me risk shumë të lartë: -
Numri i pikave të interesit: 2
Niveli i Indeksit të Riskut për Popullsinë: Mesatarë
Niveli i Indeksit të Riskut për Bujqësinë: Mesatarë
Niveli i Indeksit të Riskut për Rrjetin e Rrugëve: I lartë
Argjinaturat: -
Zonë e mundshme e përmbytjeve [km²]: 7
Personat potencialisht të prekur: 980
Ngjarjet e kaluara: -


Zona ERZEN 6



ID_APSFR sipas projektit Pronews: Shkumbini_5 (sipas ndarjes së vjetër hidrografike)
Lokalizimi: Kavaja rajon
Baseni kryesor: Erzen
Numri i gjatësive unitare të lumit: 1
Gjatësia totale: 3 km
Gjatësia me risk të lartë: 3 km
Gjatësia me risk shumë të lartë: -
Numri i pikave të interesit: 1
Niveli i Indeksit të Riskut për Popullsinë: I ulët
Niveli i Indeksit të Riskut për Bujqësinë: I lartë
Niveli i Indeksit të Riskut për Rrjetin e Rrugëve: shumë të larta
Argjinaturat: -
Zonë e mundshme e përmbytjeve [km²]: 5
Personat potencialisht të prekur: 105
Ngjarjet e kaluara: 1

5. BASENI UJOR SHKUMBIN

Harta 5. Baseni Ujor Shkumbin dhe zonat me rrezik potencial nga përmbytjet.




Zonat me rrezik potencial nga përmbytjet, ose ku kanë gjasa të ndodhin përmbytjet (ZRrPP), në Basenin Ujor Shkumbin, referuar Vlerësimit paraprak të rrezikut nga përmbytjet, të miratuar në vitin 2021.

Zona SHKUMBIN 1



ID_APSFR sipas projektit Pronews: Shkumbini_1
Lokalizimi: Biçukas, Prefektura Fier
Baseni kryesor: Shkumbini
Numri i gjatësive unitare të lumit: 1
Gjatësia totale: 5 km
Gjatësia me risk të lartë: 5 km
Gjatësia me risk shumë të lartë: -
Numri i pikave të interesit: 3
Niveli i Indeksit të Riskut për Popullsinë: I ulët
Niveli i Indeksit të Riskut për Bujqësinë: Mesatarë
Niveli i Indeksit të Riskut për Rrjetin e Rrugëve: I lartë
Argjinaturat: -
Zonë e mundshme e përmbytjeve [km²]: 35
Personat potencialisht të prekur: 6013
Ngjarjet e kaluara: 4
Shënime: Kanali i kullimit

Zona SHKUMBIN 2



ID_APSFR sipas projektit Pronews: Shkumbini_2
Lokalizimi: Ballaj-Vendas
Baseni kryesor: Shkumbini
Numri i gjatësive unitare të lumit: 5
Gjatësia totale: 23 km
Gjatësia me risk të lartë: 23 km
Gjatësia me risk shumë të lartë: -
Numri i pikave të interesit: 3
Niveli i Indeksit të Riskut për Popullsinë: I ulët
Niveli i Indeksit të Riskut për Bujqësinë: Mesatarë
Niveli i Indeksit të Riskut për Rrjetin e Rrugëve: I lartë
Argjinaturat: Statusi: dëmtuar, ndërhyrja e nevojshme Lartësia: 3 m (banka e majtë), 2.5 m (banka e
Zonë e mundshme e përmbytjeve [km²]:19
Personat potencialisht të prekur:
Ngjarjet e kaluara: 13

Zona SHKUMBIN 3




ID_APSFR sipas projektit Pronews: Shkumbini_3
Lokalizimi: shtrirje përfundimtare, Divjake
Baseni kryesor: Shkumbini
Numri i gjatësive unitare të lumit: 1
Gjatësia totale: 6 km
Gjatësia me risk të lartë: 6 km
Gjatësia me risk shumë të lartë: -
Numri i pikave të interesit: 7
Niveli i Indeksit të Riskut për Popullsinë: I ulët
Niveli i Indeksit të Riskut për Bujqësinë: Mesatarë
Niveli i Indeksit të Riskut për Rrjetin e Rrugëve: I lartë
Argjinaturat: Lartësia: 3 m
Zonë e mundshme e përmbytjeve [km²]: 25
Personat potencialisht të prekur: 2820
Ngjarjet e kaluara: 3
Shënime: Kanali i kullimit

Zona SHKUMBIN 4




ID_APSFR sipas projektit Pronews: Shkumbini_4
Lokalizimi: Rrikaj, Kavajë
Baseni kryesor: Shkumbini
Numri i gjatësive unitare të lumit: 1
Gjatësia totale: 6 km
Gjatësia me risk të lartë: 6 km
Gjatësia me risk shumë të lartë: -
Numri i pikave të interesit: 1
Niveli i Indeksit të Riskut për Popullsinë: I ulët
Niveli i Indeksit të Riskut për Bujqësinë: I lartë
Niveli i Indeksit të Riskut për Rrjetin e Rrugëve: I lartë
Argjinaturat: -
Zonë e mundshme e përmbytjeve [km²]: 4
Personat potencialisht të prekur: 485
Ngjarjet e kaluara: -

Zona SHKUMBIN 5



ID_APSFR sipas projektit Pronews: Shkumbini_7
Lokalizimi: Labinot Fushe, Elbasan
Baseni kryesor: Shkumbini
Numri i gjatësive unitare të lumit: 1
Gjatësia totale: 5 km
Gjatësia me risk të lartë: 5 km
Gjatësia me risk shumë të lartë: -
Numri i pikave të interesit: 1
Niveli i Indeksit të Riskut për Popullsinë: I ulët
Niveli i Indeksit të Riskut për Bujqësinë: I lartë
Niveli i Indeksit të Riskut për Rrjetin e Rrugëve: I lartë
Argjinaturat: -
Zonë e mundshme e përmbytjeve [km²]: 3
Personat potencialisht të prekur: 629
Ngjarjet e kaluara: 2

Zona SHKUMBIN 6




ID_APSFR sipas projektit Pronews: Shkumbini_8
Lokalizimi: Rishqem
Baseni kryesor: Shkumbini
Numri i gjatësive unitare të lumit: 2
Gjatësia totale: 10 km
Gjatësia me risk të lartë: 10 km
Gjatësia me risk shumë të lartë: -
Numri i pikave të interesit: 4
Niveli i Indeksit të Riskut për Popullsinë: Mesatarë
Niveli i Indeksit të Riskut për Bujqësinë: Mesatarë
Niveli i Indeksit të Riskut për Rrjetin e Rrugëve: I lartë
Argjinaturat: -
Zonë e mundshme e përmbytjeve [km²]: 6
Personat potencialisht të prekur: 2083
Ngjarjet e kaluara: 2

Zona SHKUMBIN 7



ID_APSFR sipas projektit Pronews: Shkumbini_9
Lokalizimi: Elbasan
Baseni kryesor: Shkumbini
Numri i gjatësive unitare të lumit: 1
Gjatësia totale: 5 km
Gjatësia me risk të lartë: 5 km
Gjatësia me risk shumë të lartë: -
Numri i pikave të interesit: 6
Niveli i Indeksit të Riskut për Popullsinë: Mesatarë
Niveli i Indeksit të Riskut për Bujqësinë: shumë të ulëta
Niveli i Indeksit të Riskut për Rrjetin e Rrugëve: I lartë
Argjinaturat: Statusi: e keqe, intervenimi i nevojshëm Lartësia: 2 m
Zonë e mundshme e përmbytjeve [km²]: 5
Personat potencialisht të prekur: 8058
Ngjarjet e kaluara: 6


Zona SHKUMBIN 8



ID_APSFR sipas projektit Pronews: Shkumbini_10
Lokalizimi: Muriqan, Cerrik
Baseni kryesor: Shkumbini
Numri i gjatësive unitare të lumit: 4
Gjatësia totale: 8 km
Gjatësia me risk të lartë: 8 km
Gjatësia me risk shumë të lartë: -
Numri i pikave të interesit: 2
Niveli i Indeksit të Riskut për Popullsinë: I ulët
Niveli i Indeksit të Riskut për Bujqësinë: Mesatarë
Niveli i Indeksit të Riskut për Rrjetin e Rrugëve: I lartë
Argjinaturat: Lartësia: 2.5 m
Zonë e mundshme e përmbytjeve [km²]: 18
Personat potencialisht të prekur: 5711
Ngjarjet e kaluara: 6

6. BASENI UJOR SEMAN

Harta 6. Baseni Ujor Seman dhe zonat me rrezik potencial nga përmbytjet.




Zonat me rrezik potencial nga përmbytjet, ose ku kanë gjasa të ndodhin përmbytjet (ZRrPP), në Basenin Ujor Seman, referuar Vlerësimit paraprak të rrezikut nga përmbytjet, të miratuar në vitin 2021.

Zona SEMAN 1



ID_APSFR sipas projektit Pronews: Semani_1
Lokalizimi: Savër, Lushnje
Baseni kryesor: Semani
Numri i gjatësive unitare të lumit: 2
Gjatësia totale: 8 km
Gjatësia me risk të lartë: 8 km
Gjatësia me risk shumë të lartë: -
Numri i pikave të interesit: 3
Niveli i Indeksit të Riskut për Popullsinë: I ulët
Niveli i Indeksit të Riskut për Bujqësinë: Mesatarë
Niveli i Indeksit të Riskut për Rrjetin e Rrugëve: Mesatarë
Argjinaturat: Statusi: -
Zonë e mundshme e përmbytjeve [km²]: 25
Personat potencialisht të prekur: 6280
Ngjarjet e kaluara: 4
Shënime: Kanali i kullimit

Zona SEMAN 2




ID_APSFR sipas projektit Pronews: Semani_2
Lokalizimi: Perrio, Prefektura Fier
Baseni kryesor: Semani
Numri i gjatësive unitare të lumit: 1
Gjatësia totale: 4 km
Gjatësia me risk të lartë: 4 km
Gjatësia me risk shumë të lartë: -
Numri i pikave të interesit: 0
Niveli i Indeksit të Riskut për Popullsinë: I ulët
Niveli i Indeksit të Riskut për Bujqësinë: I lartë
Niveli i Indeksit të Riskut për Rrjetin e Rrugëve: I lartë
Argjinaturat: Statusi: -
Zonë e mundshme e përmbytjeve [km²]: 4
Personat potencialisht të prekur: 569
Ngjarjet e kaluara: -
Shënime: Kanali i kullimit

Zona SEMAN 3




ID_APSFR sipas projektit Pronews: Semani_3
Lokalizimi: Karavasta
Baseni kryesor: Semani
Numri i gjatësive unitare të lumit: 1
Gjatësia totale: 5 km
Gjatësia me risk të lartë: 5 km
Gjatësia me risk shumë të lartë: -
Numri i pikave të interesit: 1
Niveli i Indeksit të Riskut për Popullsinë: I ulët
Niveli i Indeksit të Riskut për Bujqësinë: Mesatarë
Niveli i Indeksit të Riskut për Rrjetin e Rrugëve: I lartë
Argjinaturat: Statusi: -
Zonë e mundshme e përmbytjeve [km²]: 14
Personat potencialisht të prekur: 1446
Ngjarjet e kaluara: 4
Shënime: Kanali i kullimit

Zona SEMAN 4




ID_APSFR sipas projektit Pronews: Semani_4
Lokalizimi: Ardenicë - Vajkan
Baseni kryesor: Semani
Numri i gjatësive unitare të lumit: 2
Gjatësia totale: 10 km
Gjatësia me risk të lartë: 10 km
Gjatësia me risk shumë të lartë: -
Numri i pikave të interesit: 5
Niveli i Indeksit të Riskut për Popullsinë: I ulët
Niveli i Indeksit të Riskut për Bujqësinë: Mesatarë
Niveli i Indeksit të Riskut për Rrjetin e Rrugëve: I lartë
Argjinaturat: Statusi: -
Zonë e mundshme e përmbytjeve [km²]: 31
Personat potencialisht të prekur: 3785
Ngjarjet e kaluara: 4
Shënime: Kanali i kullimit

Zona SEMAN 5




ID_APSFR sipas projektit Pronews: Semani_5
Lokalizimi: Fieri
Baseni kryesor: Semani
Numri i gjatësive unitare të lumit: 4
Gjatësia totale: 16 km
Gjatësia me risk të lartë: 16 km
Gjatësia me risk shumë të lartë: -
Numri i pikave të interesit: 13
Niveli i Indeksit të Riskut për Popullsinë: Mesatarë
Niveli i Indeksit të Riskut për Bujqësinë: I ulët
Niveli i Indeksit të Riskut për Rrjetin e Rrugëve: I lartë
Argjinaturat: Statusi: dëmtuar, ndërhyrja e nevojshme Lartësia: 2.5 m (banka e majtë), 4 m (banka e drejtë)
Zonë e mundshme e përmbytjeve [km²]: 24
Personat potencialisht të prekur: 8088
Ngjarjet e kaluara: 14

Zona SEMAN 6



ID_APSFR sipas projektit Pronews: Semani_6
Lokalizimi: Imesht, Prefektura Fier
Baseni kryesor: Semani
Numri i gjatësive unitare të lumit: 2
Gjatësia totale: 10 km
Gjatësia me risk të lartë: 10 km
Gjatësia me risk shumë të lartë: -
Numri i pikave të interesit: 8
Niveli i Indeksit të Riskut për Popullsinë: Mesatarë
Niveli i Indeksit të Riskut për Bujqësinë: Mesatarë
Niveli i Indeksit të Riskut për Rrjetin e Rrugëve: I lartë
Argjinaturat: Statusi: dëmtuar, ndërhyrja e nevojshme Lartësia: 2.5 m (banka e majtë), 4 m (banka e drejtë)
Zonë e mundshme e përmbytjeve [km²]: 19
Personat potencialisht të prekur: 3722
Ngjarjet e kaluara: 6

Zona SEMAN 7



ID_APSFR sipas projektit Pronews: Semani_7
Lokalizimi: Kozare fshat – Gajde, kufirit midis Prefekturave Berat dhe Fier
Baseni kryesor: Semani
Numri i gjatësive unitare të lumit: 4
Gjatësia totale: 20 km
Gjatësia me risk të lartë: 20 km
Gjatësia me risk shumë të lartë: -
Numri i pikave të interesit: 14
Niveli i Indeksit të Riskut për Popullsinë: Mesatarë
Niveli i Indeksit të Riskut për Bujqësinë: I lartë
Niveli i Indeksit të Riskut për Rrjetin e Rrugëve: I lartë
Argjinaturat: Statusi: dëmtuar, ndërhyrja e nevojshme (banka e drejtë); jashtë funksionit, shndërrohet në një rrugë (banka e majtë) Lartësia: 4 m (banka e drejtë)
Zonë e mundshme e përmbytjeve [km²]: 34
Personat potencialisht të prekur: 7103
Ngjarjet e kaluara: 6

Zona SEMAN 8



ID_APSFR sipas projektit Pronews: Semani_8
Lokalizimi: Berat, qyteti
Baseni kryesor: Semani (Osumi)
Numri i gjatësive unitare të lumit: 2
Gjatësia totale: 8 km
Gjatësia me risk të lartë: 8 km
Gjatësia me risk shumë të lartë: -
Numri i pikave të interesit: 15
Niveli i Indeksit të Riskut për Popullsinë: Mesatarë
Niveli i Indeksit të Riskut për Bujqësinë: Mesatarë
Niveli i Indeksit të Riskut për Rrjetin e Rrugëve: I lartë
Argjinaturat: Statusi: jo të kënaqshme, ka pasur ndërhyrje pjesërisht rehabilituese Lartësia: 3/4 m
Zonë e mundshme e përmbytjeve [km^2]: 6
Personat potencialisht të prekur: 19013
Ngjarjet e kaluara: 10

Zona SEMAN 9




ID_APSFR sipas projektit Pronews: Semani_9
Lokalizimi: Çorovodë
Baseni kryesor: Semani (Osumi)
Numri i gjatësive unitare të lumit: 1
Gjatësia totale: 5 km
Gjatësia me risk të lartë: 5 km
Gjatësia me risk shumë të lartë: -
Numri i pikave të interesit: 7
Niveli i Indeksit të Riskut për Popullsinë: I ulët
Niveli i Indeksit të Riskut për Bujqësinë: Mesatarë
Niveli i Indeksit të Riskut për Rrjetin e Rrugëve: I lartë
Argjinaturat: -
Zonë e mundshme e përmbytjeve [km^2]: 2
Personat potencialisht të prekur: 436
Ngjarjet e kaluara: 3

Zona SEMAN 10



ID_APSFR sipas projektit Pronews: Semani_10
Lokalizimi: Orman, Prefektura Korça
Baseni kryesor: Semani
Numri i gjatësive unitare të lumit: 3
Gjatësia totale: 14 km
Gjatësia me risk të lartë: 14 km
Gjatësia me risk shumë të lartë: -
Numri i pikave të interesit: 4
Niveli i Indeksit të Riskut për Popullsinë: I ulët
Niveli i Indeksit të Riskut për Bujqësinë: Mesatarë
Niveli i Indeksit të Riskut për Rrjetin e Rrugëve: I lartë
Argjinaturat: Statusi: mirë dhe mirëmbajturLartësia: 1.5 m
Zonë e mundshme e përmbytjeve [km^2]: 17
Personat potencialisht të prekur: 3200
Ngjarjet e kaluara: 3
Shënime: Kanali i kullimit


Zona SEMAN 11



ID_APSFR sipas projektit Pronews: Semani_11
Lokalizimi: Çetë, Miras, Prefektura Korçe
Baseni kryesor: Semani
Numri i gjatësive unitare të lumit: 1
Gjatësia totale: 5 km
Gjatësia me risk të lartë: 5 km
Gjatësia me risk shumë të lartë: -
Numri i pikave të interesit: 2
Niveli i Indeksit të Riskut për Popullsinë: I ulët
Niveli i Indeksit të Riskut për Bujqësinë: shumë të ulëta
Niveli i Indeksit të Riskut për Rrjetin e Rrugëve: I lartë
Argjinaturat: -
Zonë e mundshme e përmbytjeve [km^2]: 2
Personat potencialisht të prekur: 972
Ngjarjet e kaluara: -

7. BASENI UJOR VJOSE

Harta 7. Baseni Ujor Vjosë dhe zonat me rrezik potencial nga përmbytjet.



Zonat me rrezik potencial nga përmbytjet, ose ku kanë gjasa të ndodhin përmbytjet (ZRrPP), në Basenin Ujor Vjosë, referuar Vlerësimit paraprak të rrezikut nga përmbytjet, të miratuar në vitin 2021.

Zona VJOSA 1




ID_APSFR sipas projektit Pronews: Vjosa_1
Lokalizimi: Sarande
Baseni kryesor: Bistrica, Kalasa
Numri i gjatësive unitare të lumit: 2
Gjatësia totale: 12 km
Gjatësia me risk të lartë: 12 km
Gjatësia me risk shumë të lartë: -
Numri i pikave të interesit: 1
Niveli i Indeksit të Riskut për Popullsinë: Mesatarë
Niveli i Indeksit të Riskut për Bujqësinë: Mesatarë
Niveli i Indeksit të Riskut për Rrjetin e Rrugëve: I lartë
Argjinaturat: Statusi: dëmtuar, ndërhyrja e nevojshme Lartësia: 1.5/2 m
Zonë e mundshme e përmbytjeve [km²]: 4
Personat potencialisht të prekur: 797
Ngjarjet e kaluara: 4

Zona VJOSA 2




ID_APSFR sipas projektit Pronews: Vjosa_2
Lokalizimi: Lazarat, Prefektura Gjirokaster
Baseni kryesor: Drinos, Vjosa
Numri i gjatësive unitare të lumit: 3
Gjatësia totale: 15 km
Gjatësia me risk të lartë: 15 km
Gjatësia me risk shumë të lartë: -
Numri i pikave të interesit: 3
Niveli i Indeksit të Riskut për Popullsinë: I ulët
Niveli i Indeksit të Riskut për Bujqësinë: Mesatarë
Niveli i Indeksit të Riskut për Rrjetin e Rrugëve: I lartë
Argjinaturat: Statusi: dëmtuar, ndërhyrja e nevojshme Lartësia: 1.5/2 m
Zonë e mundshme e përmbytjeve [km²]: 12
Personat potencialisht të prekur: 1022
Ngjarjet e kaluara: 2

Zona VJOSA 3




ID_APSFR sipas projektit Pronews: Vjosa_3
Lokalizimi: Shtrirja përfundimtare, kufirit midis Prefekturave Vlore e Fier
Baseni kryesor: Vjosa
Numri i gjatësive unitare të lumit: 6
Gjatësia totale: 30 km
Gjatësia me risk të lartë: 5 km
Gjatësia me risk shumë të lartë: 25 km
Numri i pikave të interesit: 6
Niveli i Indeksit të Riskut për Popullsinë: I ulët
Niveli i Indeksit të Riskut për Bujqësinë: Mesatarë
Niveli i Indeksit të Riskut për Rrjetin e Rrugëve: I lartë
Argjinaturat: Statusi: të dëmtuara; pjesërisht (banka e drejtë), jo Funksionale (banka e majtë) Lartësia: 1.2 m (banka e majtë), 3 m (banka e drejtë)
Zonë e mundshme e përmbytjeve [km²]: 19
Personat potencialisht të prekur: 1991
Ngjarjet e kaluara: 19


Zona VJOSA 4

	**ID_APSFR** sipas projektit Pronews: Vjosa_4
	Lokalizimi: Terihat, Prefektura Gjirokastra
	Baseni kryesor: Drinos
	Numri i gjatësive unitare të lumit: 1
	Gjatësia totale: 5 km
	Gjatësia me risk të lartë: 5 km
	Gjatësia me risk shumë të lartë: -
	Numri i pikave të interesit: 2
	Niveli i Indeksit të Riskut për Popullsinë: I ulët
	Niveli i Indeksit të Riskut për Bujqësinë: Mesatarë
	Niveli i Indeksit të Riskut për Rrjetin e Rrugëve: I lartë
	Argjinaturat: Statusi: dëmtuar, ndërhyrja e nevojshme Lartësia: 2.5 m
	Zonë e mundshme e përmbytjeve [km²]: 13
	Personat potencialisht të prekur: 288
	Ngjarjet e kaluara: 5

Zona VJOSA 5


	**ID_APSFR** sipas projektit Pronews: Vjosa_5
	Lokalizimi: Selenice
	Baseni kryesor: Vjosa
	Numri i gjatësive unitare të lumit: 1
	Gjatësia totale: 7 km
	Gjatësia me risk të lartë: 7 km
	Gjatësia me risk shumë të lartë: -
	Numri i pikave të interesit: 2
	Niveli i Indeksit të Riskut për Popullsinë: I ulët
	Niveli i Indeksit të Riskut për Bujqësinë: Mesatarë
	Niveli i Indeksit të Riskut për Rrjetin e Rrugëve: Mesatarë
	Argjinaturat: Statusi: dëmtuar, ndërhyrja e nevojshme Lartësia: 0 m
	Zonë e mundshme e përmbytjeve [km²]: 18
	Personat potencialisht të prekur: 815
	Ngjarjet e kaluara: 8

Zona VJOSA 6




ID_APSFR sipas projektit Pronews: Vjosa_6
Lokalizimi: Palokaster
Baseni kryesor: Vjosa
Numri i gjatësive unitare të lumit: 1
Gjatësia totale: 5 km
Gjatësia me risk të lartë: 5 km
Gjatësia me risk shumë të lartë: -
Numri i pikave të interesit: 0
Niveli i Indeksit të Riskut për Popullsinë: I ulët
Niveli i Indeksit të Riskut për Bujqësinë: Mesatarë
Niveli i Indeksit të Riskut për Rrjetin e Rrugëve: I lartë
Argjinaturat: Statusi: dëmtuar, dërhyrja e nevojshme (banka e majtë); pothuajse e mirë, dëmtimet në Mashkullore dhe Palokaster, pjesërisht ndërhyrje (banka e drejtë) Lartësia: 2.5 m (banka e majtë), 2 m
Zonë e mundshme e përmbytjeve [km²]: 9
Personat potencialisht të prekur: 72
Ngjarjet e kaluara: 4

Zona VJOSA 7



ID_APSFR sipas projektit Pronews: Vjosa_7
Lokalizimi: Poçem
Baseni kryesor: Vjosa
Numri i gjatësive unitare të lumit: 4
Gjatësia totale: 20 km
Gjatësia me risk të lartë: 20 km
Gjatësia me risk shumë të lartë: -
Numri i pikave të interesit: 0
Niveli i Indeksit të Riskut për Popullsinë: I ulët
Niveli i Indeksit të Riskut për Bujqësinë: Mesatarë
Niveli i Indeksit të Riskut për Rrjetin e Rrugëve: I lartë
Argjinaturat: Statusi: ndërhyrja e nevojshme Lartësia: 2.5 m
Zonë e mundshme e përmbytjeve [km²]: 19
Personat potencialisht të prekur: 103
Ngjarjet e kaluara: 7

Zona VJOSA 8



ID_APSFR sipas projektit Pronews: Vjosa_8
Lokalizimi: Vagalat
Baseni kryesor: Pavlla
Numri i gjatësive unitare të lumit: 1
Gjatësia totale: 5 km
Gjatësia me risk të lartë: 5 km
Gjatësia me risk shumë të lartë: -
Numri i pikave të interesit: 0
Niveli i Indeksit të Riskut për Popullsinë: I ulët
Niveli i Indeksit të Riskut për Bujqësinë: Mesatarë
Niveli i Indeksit të Riskut për Rrjetin e Rrugëve: I lartë
Argjinaturat: -
Zonë e mundshme e përmbytjeve [km²]: 8
Personat potencialisht të prekur: 45
Ngjarjet e kaluara: -

V. QASJA PËR RISHIKIMIN

Për procesin e rishikimit të Verësimit Paraprak të Rrezikut nga Përmbytjet, nuk ekziston një akt rregullator apo udhëzues vendas.
Ky është procesi i parë që po realizohet nga organet e menaxhimit të burimeve ujore (rishkimi).

Procesi rishikimit të Verësimit Paraprak të Rrezikut nga Përmbytjet, me qëllim arritjen e konkluzioneve sa më të sakta e të plota, është mbështetur në:

- Përdorimin e të gjitha burimeve përkatëse dhe të mundshme të të dhënave dhe informacionit të rrezikut nga përmbytjet;
- Dokumentet e mëparshme në lidhje me procesin e VPRrP;
- Hartat e rrezikut dhe riskut të krijuara deri më tani;
- Të dhënat dhe vlerësimet e kryera në PMRP e hartuara deri më tani;
- Njohuritë dhe eksperiencën e organeve të menaxhimit të burimeve ujore dhe e strukturave për mbrojtjen civile në nivel qarqesh.

VI. AUTORITETET DHE ROLET

Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (dhe Zyrat e Administrimit të Baseneve Ujore), referuar përcaktimeve të VKM 1015/2020 ka përgjegjësinë dhe detyrimin:

- *për çdo basen ujor të identifikuar, të kryejë vlerësimin paraprak të rrezikut nga përmbytjet bazuar në informacionin e disponueshëm, siç janë të dhënat dhe studimet mbi zhvillimet afatgjata, dhe në veçanti ndikimet e ndryshimeve klimatike në rastin e ndodhjes së përmbytjeve.*
- *të rishikojë dhe në qoftë se është e nevojshme të përditësojë VPRP, brenda datës 31 dhjetor 2023 dhe më pas çdo tre vjet. Çdo rishikim tjetër duhet të marrë në konsideratë ndikimin e mundshëm të ndryshimeve klimatike në ndodhjen e përmbytjeve.*
- *VPRP dhe çdo rishikim, pas miratimit nga Këshilli Kombëtar i Ujit, duhet të vendoset në faqen e internetit të AMBU-së dhe duhet të jetë i disponueshëm për publikun.*
- *në bazë të vlerësimit paraprak të rreziqeve nga përmbytjet ose të ndonjë rishikimi, duhet të propozojë në Këshillin Kombëtar të Ujit, shpalljen e zonave ku ekziston rreziku potencial nga përmbytjet ose ka gjasa të ndodhin përmbytje.*
- *të koordinojë me autoritetet përkatëse në shtetet e tjera për shpalljen e zonave në rrezik nga përmbytjet, kur një basen ujor është pjesë e një rrethi ndërkombëtar të basenit ujor,*

Institucionet e prefektëve të qarqeve, duke marrë në konsideratë faktin që rishikimi i VPRP mbështetet kryesisht në të dhënat mbi ngjarjet e përmbytjeve që mund të kenë ndodhur në territor, si dhe referuar përcaktimeve të ligjit nr. 45/2019 "Për mbrotjen Civile", i ndryshuar, për bazën e të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë në nivel qarku, janë angazhuar në procesin për rishikimin e VPRP dhe evidentimin e nevojës për përditësim ose jo të tij.

Konkretisht, Prefekti i qarkut grumbullon dhe përpunon të dhënat e nevojshme nga bashkitë dhe strukturat e tjera që veprojnë në nivel qarku, për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, si dhe krijon bazën e të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë në nivel qarku, të cilën e mirëmban dhe e përditëson (Neni 28 i ligjit 45/2019, te ndryshuar).

Prefektura e Qarkut Shkodër, Prefektura e Qarkut Kukës, Prefektura e Qarkut Dibër, Prefektura e Qarkut Lezhë, Prefektura e Qarkut Tiranë, Prefektura e Qarkut Durrës, Prefektura e Qarkut Elbasan, Prefektura e Qarkut Berat, Prefektura e Qarkut Korcë, Prefektura e Qarkut Fier, Prefektura e Qarkut Vlorë dhe Prefektura e Qarkut Gjirokastër u angazhuan zyrtarisht në shkëmbimin e informacioneve të disponueshme e të vlefshme, në nivel qarku, si dhe në vlerësimin nëse zonat me rezik potencial të shpallura në vitin 2021 do të vijojnë të jenë si të tilla edhe për periudhën në vijim, si edhe nëse ka zona të tjera me rrezikshmëri të cilat do të duhet të përfshihen rishtas në listën e zonave me rrezik.

Informacionet e vëna në dispozicion si dhe vlerësimet, përgjithësisht janë mbeshtetur në të dhënat e shkëmbyera me njësitë e qeverisjes vendore respektive.

VII. METODOLOGJIA

Konsiderata themelore për këtë rishikim:

a) Institucionet e prefektëve të qarqeve, disponojnë bazën e të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë në nivel qarku, të cilën e mirëmbajnë dhe përditësojnë referuar përcaktimeve të ligjit nr. 45/2019 "Për mbrotjen Civile", i ndryshuar. Kjo bazë të dhënash (specifikisht për pjesën e të dhënave për humbjet nga përmbytjet), kontribuon në procesin e rishikimit të VPRP. AMBU, në këtë proces vlerësoi të domosdoshëm bashkëpunimin me institucionet e Prefektëve të Qarqeve, si organe të cilat udhëheqin proceset për mbrotjen civile, menaxhimin e rasteve të fakeqësive natyrore si dhe administruese të informacionit të nevojshëm në nivel qarku.

Në ndihmë të procesit dhe standardizimit të tij, AMBU krijoi "Formularin model" për vetëvlerësimin e situatës së njohurive dhe informacionit që Prefektët e Qarqeve kanë, dhe nëpërmjet tyre shkëmbeu informacionin dhe të dhënat e nevojshme për rishikimin e vlerësimit paraprak.

Vetëvlerësimi u konsiderua i vlefshëm edhe për faktin se nëpërmjet tij, këto institucione mund të identifikonin edhe nevojat për përmirësim në punën e tyre në vlerësimin e rrezikut nga përmbytjet.

Formulari kryesisht përqëndronte vlerësimin për:

- ekzistencën e sistemeve të përshtatshme për mbledhjen dhe menaxhimin e të dhënave të rrezikut nga përmbytjet;
- ndryshimet në kuptimin e rrezikut në krahasim me periudhat/vlerësimet e mëparshme, dhe arsyet kryesore për këto ndryshime;
- informacione të reja mbi përmbytjet e ndodhura nga ato të konsideruar në VPRP aktual dhe përmbytjet e mundshme të ardhshme;
- informacion në lidhje me ndërhyrje infrastrukturore të realizuara apo në plan, të cilat do të ndikonin në uljen e rrezikut nga përmbytjet në zona të caktuara;
- konfirmimin e ZRPP për ciklin e ardhshëm të planifikimit;

b) Pas vitit 2021 (në periudhën 2022-2023) janë krijuar hartat e rrezikut nga përmbytjet për zonat e shpallura me rrezikshmëri në ciklin e parë të VPRP në 2021, të cilat referuar informacioneve të përditësuara, kanë përcaktuar shtrirjen e gjurmës së përmbytjeve. Njëkohësisht, janë krijuar edhe hartat e riskut të cilat, po mbështetur në informacionet e përditësuara, të cilat identifikojnë grafikisht nivelin e riskut për territoret e prekura nga përmbytjet.
Ky informacion i përditësuar ka shërbyer si bazë për të indetifikuar, në këtë rishikim, zonat me rrezikshmëri;

c) Grafika e zonave të shpallura me rrezik nga përmbytjet është grafikë indikative dhe pasqyron përgjithësisht segmentin e lumit i cili është konsideruar me rrezik potencial nga përmbytjet, në VPRP aktual. Për rrjedhim, ajo nuk pasqyron një zonë të mirëfilltë me shtrirje sipërfaqësore në terren, të cilën më saktë e pasqyrojnë hartat e rrezikut dhe të riskut sipas probabiliteteve përkatëse;

d) Përmbytje, do të konsiderohen ngjarjet e përmbytjeve nga lumenjtë, përrenjtë malorë, nga shkarkimet e digave, rrjedhat ujore kalimtare mesdhetare dhe përmbytjet nga deti në zonat bregdetare, me përjashtim të përmbytjeve nga sistemet e kanalizimit të ujërave të ndotur urbane (referuar Direktivës së BE-së);

e) Rreziku nga përmbytjet nënkupton kombinimin e probabilitetit të përmbytjeve dhe të pasojave të mundshme negative në shëndetin e njerëzve, në mjedis, në trashëgiminë kulturore dhe aktivitetet ekonomike (Direktiva e BE-së për Përmbytjet), dhe në vlerësim është konsideruar edhe krahasimi i rreziqeve/dëmeve të identifikuara në këtë rishikim, në zona/territore të caktuara, kundrejt rreziqeve/dëmeve të konsideruara në rastin e shpalljes së zonave në VPRP aktual (niveli i tyre);


f) Për basenet ujore Drin-Bunë (5 zonat), Ishëm, Erzen, Shkumbin, Seman dhe Vjosë, është në proces hartimi i projekt-Planeve të Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet (brenda 2024), dhe territoret e zonave me rrezik potencial dhe nivelet e riskut për këto zona, do të kenë një rivlerësim më të plotë referuar analizimeve të thelluara që këto plane do të përmbajnë, duke përfshirë këtu edhe konsiderimin e ndryshimeve klimatike dhe koordinimin me autoritetet përkatëse në shtetet e tjera;

g) Nryshimet klimatike (përpos trajtimit në PMRP-të që do të hartohen), sipas rastit janë marrë në konsideratë në disa nga hartat e rrezikut të krijuara (Hartat për zonat Erzen 1, Erzen 5 dhe Erzen 6, Ishëm 2 dhe Ishëm 3, Shkumbin 2 dhe Shkumbin 4, Vjosa 1 dhe Vjosa 3) të krijuara nga projekti i asituar nga WBIF, si edhe hartat për probabilitetin 1 herë në 500 vjet për zonat Drin-Bunë 5 dhe Drin-Bunë 6 të krijuara nga projekti i asistuar nga GIZ), dhe do të konsiderohen edhe në hartat që do të krijohen në vijimësi;

h) Për, bashkërendimin ndërkufitar me autoritetet përkatëse në shtetet e tjera, në rastin e baseneve ndërkufitare, për shpalljen e zonave në rrezik nga përmbytjet, është konsideruar fakti se zonat me rrezik potencial nga përmbytjet në Basenin Ujor Drin-Bunë, si dhe hartat, janë identifikuar dhe krijuar nga një proces i realizuar në bashkëpunim ndërmjet shteteve ndërkufitare ku ky basen shtrihet: Maqedonia e Veriut, Kosova, Mali i Zi (procese të realizuara me asistencën e projekteve të GIZ dhe UNDP). Ndërkohë për basenin ndërkufitar Vjosë, koordinimi dhe bashkërendimi do të realizohet në fazën e hartimit të Planit të Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet për këtë basen;

i) Referohemi edhe dokumentit të vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë në nivel qendror të miratuar me VKM Nr. 168, datë 24.3.2023, referencave për përmbytjet.

"Risqet më kritike nga fatkeqësitë, të cilat kanë një potencial të lartë për ndikim negativ në zhvillimin e vendit, janë ***përmbytjet, rreziqet teknologjike dhe biologjike, të pasuara nga rrëshqitjet e tokës dhe tërmetet".***



Grafiku 3. Risqet më kritike nga fatkeqësitë në rang vendi.

Përmbytjet janë një ndër fatkeqësitë natyrore që ndodhin më shpesh në Shqipëri. Duke marrë parasysh një periudhë kthimi prej 100 vitesh, risku i përmbytjeve në pjesë të tjera të vendit është mjaft i lartë por përmbytjet në Ultësirën Perëndimore do të shkaktonin padyshim dëmet më të mëdha fizike ndaj objekteve të ndërtuara nga njeriu dhe bujqësisë, si dhe do të sforconin maksimalisht të gjitha shërbimet e emergjencave civile dhe të gjitha burimet e tjera fizike dhe njerëzore në nivel kombëtare.



Grafiku 4. Risqet nga përmbytjet në rang qarku.

Katër qarqe të Shqipërisë, përkatësisht Berati, Fieri, Shkodra dhe Vlora, konsiderohen se kanë një risk ekstrem nga përmbytjet. Ky grup pasohet nga Durrësi, i cili vlerësohet se ka një nivel risku shumë të lartë. Elbasani, Gjirokastra, Lezha dhe Tirana kanë nivel mesatar të riskut nga përmbytjet. Grafiku më sipër evidenton faktin se i gjithë vendi është shumë i ekspozuar ndaj riskut të përmbytjeve. Për rrjedhojë, strategjia e ardhshme për menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë duhet të ketë një fokus të veçantë në forcimin e aftësive ripërtëritëse ndaj këtyre risqeve, në të gjithë territorin e vendit.

j) Duke marrë në konsideratë arsyet për të cilat kryhet rishikimi i VPRP, i cili, mbështetur në informacionin e përditësuar për rreziqet nga përmbytjet, identifikon nevojat për përditësim të zonave me rrezik potencial nga përmbytjet dhe për të cilat do të duhet të krijohen/përditësohen hartat e rrezikut dhe riskut nga përmbytjet dhë në vijim të rishikohen Planet e Menaxhimit të Rrezikut të Përmbytjeve, është vlerësuar se, hartat e rrezikut dhe të riskut të krijuara së fundi janë baza kryesore e informacionit ku

mbështetemi për të identifikuar rrezikshmërinë e zonave aktuale të shpallura dhe nevojën për zona të reja për tu shpallur.

Kjo për më tepër edhe për faktin se proceset e VPRP dhe identifikimit të zonave (përfshirë edhe rishikimet) përgjithësisht nuk shoqërohen me modelime të mirëfillta, të nivelit të modelimeve që janë kryer tashmë për krijimin e hartave të rrezikut dhe riskut.

Njëkohësisht, referuar përcaktimeve të Direktivës së BE-së, ciklet e rishkimit të VPRP për shtetet anëtare, janë çdo gjashtë vjet dhe gjithashtu edhe hartat e rrezikut dhe riskut kanë të njëjtin cikël rishikimi. Ndërkohë referuar VKM 1015/2020 pas rishikimit aktual të cilit i përket ky Raport (dhjetor 2023) rishikimet e VPRP kryhen çdo 3 vjet (2026, 2029, ….) ndërsa hartat rishikohen në vitin 2027, e më pas çdo 6 vjet (2033, 2039, …). Duke konsideruar këtë periodicitet, por edhe faktet e sipërcituara në lidhje me aktualitetin e hartave të krijuara së fundi apo në proces krijimi, është vlerësuar se rishikimi i VPRP në vitin 2026, do të shoqërohet me konkluzione më të plota për nevojën e rishikimit/përditësimit të zonave dhe hartave në vitin 2027.

Informacioni që japin hartat aktuale të rrezikut për 42 nga 46 zonat e shpallura dhe hartat e riskut për 36 nga 46 zonat është bashkërenduar me informacionin e venë në dispozicion nga prefekturat e qarqeve, dhe mbështetur në to, si edhe konsideratat e mësipërme, është arritur në përfundimin se është i nevojshëm përditësimi i zonave me rrezik potencial nga përmbytjet.

VIII. RISHIKIMI I DETAJUAR

1. BASENI UJOR DRIN-BUNË

Në bashkëpunim me Prefekturën e Qarkut Shkodër, Prefekturën e Qarkut Lezhë, Prefekturën e Qarkut Kukës dhe Prefekturën e Qarkut Dibër është koordinuar informacioni për:

- përmbytjet e ndodhura kohët e fundit (përmbytje të ndodhura pas atyre të referuara në Vlerësimin paraprak të rrezikut nga përmbytjet të miratuar në 2021);
- vlerësimi nëse zonat aktuale do të mbeten si zona me rrezik potencial edhe për periudhën 3-vjeçare dhe nëse ka zona të reja që duhen të shpallen rishtaz.

Mbështetur në këto informacione, si edhe veçanërisht në hartat e rrezikut nga përmbytjet të krijuara nga projektet "Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike nëpërmjet menaxhimit ndërkufitar të rrezikut nga përmbytjet në Ballkanin Perëndimor" **GIZ** dhe "Menaxhimi i integruar i rrezikut nga përmbytjet ndërkufitare në basenin e lumit Drin" **UNDP,** është kryer vlerësimi nëse 8 zonat aktuale të shpallura në Basenin Ujor Drin-Bunë, do të mbeten si të tilla edhe për periudhën 3-vjeçare në vijim (periudhë kur duhet të kryhet edhe rishikimi pasardhës), si dhe nëse është e nevojshme të shpallen zona të tjera me rrezik potencial që duhet të përfshihen rishtaz.


Për territoret e nën-Shkodrës, pjesë e basenit ujor Drin-Bunë, proceset e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet, si zbatim i legjislacionit vendas por edhe Direktivës së BE-së për përmbytjet, janë në fazën përfundimtare të miratimit të Planit të Menaxhimit dhe vënies së tij në zbatim, dhe këto procese, janë mbështetur në informacionet e përditësuara në lidhje me ngjarjet e përmbytjeve që do të ndikonin në përshtatjen e dokumenteve të krijuara (në këto procese konsiderojmë edhe bashkërendimin dhe konsultimin me entet publike që disponojnë informacionin e nevojshëm).


Ndërkohë, për 5 zonat e tjera të basenit, proceset e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet, mbështetur në të dhënat historike, terrenin dhe topografinë aktuale, kanë krijuar hartat e rrezikut nga përmbytjet (për probabilitetet përkatëse), në vitin 2022, ndërsa hartat e riskut dhe Plani i Menaxhimit të Rrezikut janë faze përgatitjeje.

Referuar sa më lart, është vlerësuar se hartat që aktualisht disponojmë për rrezikun dhe riskun nga përmbytjet (si dhe ato të riskut për zonën e nën-Shkodrës) pasqyrojnë përgjithësisht realitetin e situatës së rrezikut dhe riskut, e për rrjedhim mbështetur në ato harta mund të kryhet një vlerësim korrekt në lidhje me faktin nëse zonat aktualisht të shpallura do të mbeten përsëri si zona me rrezik potencial apo nëse ka zona të reja të rrezikuara qe duhen identifikuar dhe shpallur.


Hartat në vijim pasqyrojnë situatën e rrezikut dhe riskut nga përmbytjet.


Harta 8. Hartat e rrezikut nga përmbytjet për zonat Drin-Bunë 4, Drin-Bunë 5, Drin-Bunë 7, e shtrirjes dhe thellësisë së ujit për probabilitetin 1 në 100 vjet (GIZ).








Harta 9. Hartat e riksut nga përmbytjet për zonat Drin-Bunë 4, Drin-Bunë 5, Drin-Bunë 7, e shtrirjes dhe thellësisë së ujit për probabilitetin 1 në 100 vjet (GIZ).






Flood Risk Map - Impact HQ10 - Albania/Montenegro, Drin/Drim & Buna/Bojana & Lake Shkodra/Skadar
page 8 of 10
Flood Risk Map
HQ10
Map editor:
geomer
Heidelberg, Germany
Darmstadt, Germany
Simulation performed by:
Leichtweiß-Institute for Hydraulic Engineering and Water Resources, Braunschweig, Germany
Funding organisation:
Funded by German Federal Ministry for Economic Cooperation and Development (BMZ) implemented by GIZ



Flood Risk Map - Impact HQ10 - Montenegro, Drin/Drim & Buna/Bojana & Lake Shkodra/Skadar
page 7 of 10
Flood Risk Map
HQ10
Map editor:
geomer
Heidelberg, Germany
Darmstadt, Germany
Simulation performed by:
Leichtweiß-Institute for Hydraulic Engineering and Water Resources, Braunschweig, Germany
Funding organisation:
Funded by German Federal Ministry for Economic Cooperation and Development (BMZ) implemented by GIZ



Flood Risk Map - Impact HQ10 - Albania/Montenegro, Drin/Drim & Buna/Bojana & Lake Shkodra/Skadar
page 6 of 10
Flood Risk Map
HQ10
geomer
Heidelberg, Germany
INFRASTRUKTUR & UMWELT
Darmstadt, Germany
giz


Flood Risk Map - Impact HQ10 - Albania/Montenegro, Drin/Drim & Buna/Bojana & Lake Shkodra/Skadar
page 5 of 10
Flood Risk Map
HQ10
geomer
Heidelberg, Germany
INFRASTRUKTUR & UMWELT
Darmstadt, Germany
giz



Flood Risk Map - Impact HQ10 - Albania/Montenegro, Drin/Drim & Buna/Bojana & Lake Shkodra/Skadar
page 4 of 10
Flood Risk Map
HQ10
Map editor:
geomer
Heidelberg, Germany
INFRASTRUKTUR & UMWELT
Darmstadt, Germany
Simulation performed by:
Leichtweiß-Institute for Hydraulic Engineering and Water Resources, Braunschweig, Germany
Funding organisation:
giz
Funded by German Federal Ministry for Economic Cooperation and Development (BMZ) implemented by GIZ


Flood Risk Map - Impact HQ10 - Albania/Montenegro, Drin/Drim & Buna/Bojana & Lake Shkodra/Skadar
page 3 of 10
Flood Risk Map
HQ10
Map editor:
geomer
Heidelberg, Germany
INFRASTRUKTUR & UMWELT
Darmstadt, Germany
Simulation performed by:
Leichtweiß-Institute for Hydraulic Engineering and Water Resources, Braunschweig, Germany
Funding organisation:
giz
Funded by German Federal Ministry for Economic Cooperation and Development (BMZ) implemented by GIZ



Flood Risk Map - Impact HQ10 - Albania/Montenegro, Drin/Drim & Buna/Bojana & Lake Shkodra/Skadar
page 2 of 10
Flood Risk Map
HQ10
geomer
giz


Flood Risk Map - Impact HQ10 - Albania/Montenegro, Drin/Drim & Buna/Bojana & Lake Shkodra/Skadar
page 1 of 10
Flood Risk Map
HQ10
geomer
giz


Harta 10. Harta e rrezikut nga përmbytjet për zonën Drin-Bunë 1 (1a dhe 1b), e shtrirjes dhe thellësisë së ujit për probabilitetin 1 në 100 vjet (UNDP).




Harta 11. Harta e rrezikut nga përmbytjet për zonën Drin Bunë 1 (1c), e shtrirjes dhe thellësisë së ujit për probabilitetin 1 në 100 vjet (UNDP).




Harta 12. Harta e rrezikut nga përmbytjet për zonën Drin-Bunë 2, e shtrirjes dhe thellësisë së ujit për probabilitetin 1 në 100 vjet (UNDP).



Harta 13. Harta e rrezikut nga përmbytjet për zonat Drin-Bunë 3, e shtrirjes dhe thellësisë së ujit për probabilitetin 1 në 100 vjet (UNDP).




Harta 14. Harta e rrezikut nga përmbytjet për zonën Drin-Bunë 4, e shtrirjes dhe thellësisë së ujit për probabilitetin 1 në 100 vjet (UNDP).



Ky është një modelim më koherent në lidhje me zonën me rrezikshmëri Drin-Bunë 4, kundrejt modelimit nga projekti i mbështetur nga GIZ.

Harta 13. Harta e rrezikut nga përmbytjet për zonën Drin-Bunë 7 dhe Drin-Bunë 8, e shtrirjes dhe thellësisë së ujit për probabilitetin 1 në 100 vjet (UNDP).



Në rishkimin e zonave me rrezikshmëri, është trajtuar edhe informacioni në lidhje me përmbytjet në zonat e Qarkut Dibër dhe Qarkut Kukës.

a) Konkretisht, rezulton se territoret e prekura nga përmbytjet vlerësohen se tashmë janë pjesë e 3 zonave me rrezikshmëri të basenit Drin-Bunë në Qarkun e Dibrës. Në mënyrë më të detajuar përfshihen fshatrat: Gjoricë e Sipërme; Gjoricë e Poshtme; Podgorc; Katund i Ri; Brezhdan; Kastriot; Sinë, si edhe fshatrat e tjerë në afërsi të tyre, të cilat gjithashtu preken nga gjurma e përmbytjes.

Për rrjedhim të sa më sipër, vlerësohet se informacionet e reja për përmbytjet në këto zona nuk e ndryshojnë vlerësimin paraprak të mëparshëm dhe faktin se këto 3 zona (Drin-Bunë 1a, Drin-Bunë 1b dhe Drin-Bunë 1c) janë me rrezik dhe duhet të mbeten të shpallura si të tilla edhe në vitet në vijim, dhe për këto zona organet e menaxhimit të burimeve ujore (AMBU dhe ZABU) në koordinim dhe bashkëpunim me institucionet qëndrore dhe lokale duhet të hartojnë planin e menaxhimit të rrezikut nga përmbytja dhe të përcaktojnë masat konkrete që do të duhet të ndërmerren për eleminimin apo uljen e rrezikut.

b) Njëkohësisht, është vlerësuar territori i fshatit Zall Dardhë si një territor i ri me rrezikshmëri, referuar përmbytjeve të shkurtit 2018 të regjistruara.

Duke konsideruar se:

- informacioni për përmbytjen në datën 5.2.2018 evidenton se kjo ngjarje (e vetme) ka mbuluar me ujë një sipërfaqe totale prej 40 Ha, nga të cilat vetëm 5 Ha tokë bujqësore,
- nuk janë regjistruar dëme të qenësishme në jetën apo shëndetin e njerëzve, banesa, ekonomi apo trashëgimi kulturore, të krahasueshme këto më dëmet e konsideruara në zona të tjera të identifikuara dhe shpallura (Shqipëria ka 46 zona në total të identifikuara me rrezikshmëri),
- modelimet aktuale hidraulike të kryera nga projekti i sipërpërmendur nuk e shtrijnë gjurmën e përmbytjeve deri në territorin e Zall Dardhës.

Është vlerësuar se vetëm sipërfaqja e tokës bujqësore (5 Ha) e përmbytur dhe ndodhja e vetëm një ngjarjeje përmbytjeje në periudhën kohore prej 6 vitesh, nuk është kusht i mjaftueshëm që kjo zonë të konsiderohen si zonë e re me rrezikshmëri të lartë nga përmbytjet në Basenin Ujor Drin-Bunë dhe në rang vendi.

c) Gjithashtu, është trajtuar edhe ndikimi (pozitiv) i mundshëm i argjinaturës së ndërtuar në fshatin Brezhdan në vitet 2018-2019.

Modelimet hidraulike të kryera nga ekspertët e projektit të sipërcituar janë realizuar mbështetur në kushtet aktuale të terrenit (duke mbikëqyrur gjendjen dhe disponuar të dhënat e nevojshme pasi argjinatura është ndërtuar).

Për sa më lart, si edhe faktin që zona 1b Drin-Bunë me rrezikshmëri shtrihet edhe në fshatra të tjerë të rrezikuar, vlerësojmë se zona 1b me rrezikshmëri të mbetet si e tillë edhe për përiudhën në vijim.

Ndër të tjera, edhe informacionet për përmbytjet e evidentuara dhe analizuara në dokumentin "Vlerësimi i riskut nga fatkeqësitë në Shqipëri" (Raport i konsoliduar i gushtit 2022), i

Agjencisë Kombëtare të Emergjencave Civile, konfirmojnë rrezikun nga përmbytjet me të cilat përballen zonat Drin-Bunë 5 dhe Drin-Bunë 6. Konkretisht:

d) Përmbytja e Marsit 2018

Qarku i Shkodrës që prej datës 2 mars 2018 është prekur nga përmbytje të shumta të shkaktuara fillimisht nga shkrirja e borës si pasojë e erërave të ngrohta dhe rritjes graduale të temperaturave. Reshjet intensive gjatë ditëve në vijim të kombinuara me shtimin e shkarkimeve nga hidrocentralet (HEC) në kaskadën e Drinit kanë përkeqësuar situatën e përmbytjeve. Përmbytjet janë përhapur duke përfshirë 4800 ha tokë bujqësore, duke prekur 160 shtëpi dhe duke përmbytur plotësisht 40 banesa. Fshatrat Obot dhe Shirq, përkatësisht në njësitë administrative të Anës së Malit dhe Dajç, ishin më të prekurit.

Situata u përkeqësua më 19 mars, duke prekur edhe zonat periferike të qytetit të Shkodrës, ku 25 persona u evakuuan nga ushtria dhe policia. Përkeqësimi i situatës është shkaktuar nga shkarkimet e HEC-eve të Fierzës, Komanit dhe Vaut të Dejës, si dhe nga sasia e lartë e reshjeve në zonën e Shkodrës, veçanërisht në verilindje të saj. Autoritetet shtuan numrin e shkarkimeve të detyrueshme për të ulur presionin mbi diga, pasi nivelet e ujit ishin në një nivel pothuajse kritik. Fshatrat Velipojë dhe Trushë dhe shumica e fshatrave Dajç po përballeshin me mungesë të ujit të pijshëm për shkak të mungesës së sistemit të pompimit të ujit.

Harta 14. Harta e shtrirjes së përmbytjeve të Shkodrës në Mars 2018.



e) Përmbytja e janarit/shkurtit 2021

Për shkak të reshjeve të dendura të shiut, përmbytjet kanë përfshirë zonën e Shkodrës, Shqipëri, nga data 6 janar 2021 deri më 15 shkurt. Rreth 4000 ha janë prekur nga përmbytjet, me rreth 200 persona të prekur.

Harta 15. Harta e përmbytjeve të Shkodrës në janar/shkurt 2021.




Referuar edhe ngjarjeve të mësipërme, për Basenin Ujor Drin-Bunë, si konkluzion, është vlerësuar se **zonat Drin-Bunë 1 (1a, 1b dhe 1c), Drin-Bunë 2, Drin-Bunë 3, Drin-Bunë 4, Drin-Bunë 5, Drin-Bunë 6, Drin-Bunë 7 dhe Drin-Bunë 8 do të vijojnë të konsiderohet si zona rreziku edhe për 3 vitet në vijim** dhe për ato zona, organet e menaxhimit të burimeve ujore (AMBU dhe ZABU) në koordinim dhe bashkëpunim me institucionet qendrore dhe lokale, referuar hartave të rrezikut dhe të riskut, duhet të hartojnë planin e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet dhe të përcaktojnë masat konkrete të mëtejshme që do të duhet të ndërmerren për eleminimin apo uljen e rrezikut në të gjithë territorin e zonës. Njëkohësisht, **nuk ka zona/zonë për tu shpallur rishtaz** që duhet të përfshihet në zonat e rrezikut për 3 vitet e ardhshme.

Projektet "Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike nëpërmjet menaxhimit ndërkufitar të rrezikut nga përmbytjet në Ballkanin Perëndimor" **GIZ** dhe "Menaxhimi i integruar i rrezikut ndërkufitar të përmbytjeve, në konsiderim të klimës, në pellgun e lumit Drin në Ballkanin Perëndimor (Shqipëri, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut)" **UNDP,** janë projekte të cilat në thelb kanë patur në konsideratë ndryshimet klimatike. Për rrjedhim, në këtë rishikim të Vlerësimit paraprak (të miratuar në vitin 2021), vlerësohet së është përmbushur kushti që rishikimi duhet të marrë në konsideratë ndikimin e mundshëm të ndryshimeve klimatike.

Njëkohësisht, këto projekte kanë shtrirë ekspertizën e tyre në të gjithë territorin e basenit ndërkufitar Drin duke bashkërenduar informacionin dhe procesin me të gjithë shtetet

ndërkufitare, e për rrjedhim informacioni mbi të cilin është mbështetur rishikimi konsiderohet se përmbush kushtin për koordinim me autoritetet përkatëse në shtetet e tjera.

Harta 16. Shtrirja e vendodhjes së zonave Drin-Bunë 1 (1a, 1b dhe 1c), Drin-Bunë 2, Drin-Bunë 3, Drin-Bunë 4, Drin-Bunë 5, Drin-Bunë 6, Drin-Bunë 7 dhe Drin-Bunë 8, në territorin e Basenit Ujor Drin-Bunë.



2. BASENI UJOR MAT


A. ZONA ME RREZIK POTENCIAL MAT 2


Në bashkëpunim me Prefekturën e Qarkut Lezhë dhe Prefekturën e Qarkut Shkodër është shkëmbyer informacioni për përmbytjet e ndodhura kohët e fundit (përmbytje të ndodhura pas atyre të referuara në Vlerësimin paraprak të rrezikut nga përmbytjet të miratuar në 2021), dhe mbështetur në ato informacione, si edhe hartat e rezikut nga përmbytjet të krijuara nga projekti **Infrastructure Project Facility, Technical Assistance Window (IPF - TA), Western Balkan**, është vlerësuar nëse 2 zonat aktuale të shpallura në Basenin Ujor Mat do të mbeten si të tilla edhe për periudhën 3-vjeçare në vijim, si edhe nëse është e nevojshme të ketë zona të tjera me rrezik potencial që duhet të përfshihen/shpallen rishtaz.

Në lidhje me territorin e zonës me rrezik Mati 2, informacioni i disponuar nuk pasqyron përmbytjet masive në kohët e fundit, por vetëm evidenton dëmtimet në veprat e infrastrukturës (ura) të cilat vlerësohet se janë rezultat i shfrytëzimit të materialit inert lumor.

Gjithsesi, në vlerësim të shtrirjes së përmbytjes që rezulton nga modelimet hidraulike të prokjektit, si edhe ndikimit të saj në banesa, tokë bujqësore, infrastrukturë dhe aktivetet ekonomike, por edhe vlerësimit të institucionit të Prefektit Lezhë, arrihet në konkluzionin se zona aktuale Mati 2 të vijojë të konsiderohet si zonë me rrezik potencial për periudhën në vijim, si dhe nuk është e nevojshme të përcaktohen zona të reja me rrezik potencial nga përmbytjet për këtë territor të Basenit Ujor Mat, që përkon me Qarkun Lezhë.

Harta 17. Hartat e rrezikut nga përmbytjet për zonën Mat 2, e shtrirjes dhe thellësisë së ujit për të gjithë probabilitetet (projekti Infrastructure Project Facility).





Harta 18. Shtrirja e vendodhjes së zonës Mati 2, në territorin e Basenit Ujor Mat.



B. ZONA ME RREZIK POTENCIAL MAT 1

Kjo zonë shtrihet në një segment të lumit Fan nga Ura e Kryeziut (Fushë-Arrëz) deri në vijën kufitare të bashkisë dhe kalon nëpër fshatrat Kryezi, Bardhet, Qafë Mali, Fushagji, Shpoz, Kaulinaj dhe qytetin Fushë-Arrëz.

Për këtë territor, mungojnë informacionet e detajuara nga Prefektura e Qarkut Shkodër në lidhje me përmbytje të ndodhura pas vitit 2003 (mbi të cilat është mbështetur vlerësimi paraprak në vitin 2021 dhe që ka shpallur zonën me rrezik Mati 1) si edhe nuk janë krijuar hartat e rrezikut dhe riskut ndonjëherë për këtë zonë.

Gjithsesi, në vlerësim jemi mbështetur në informacinin e disponuar nga bashkia Fushë-Arrëz e cila konsideron se ky segment është një masë ujore që ka prurje të shumta pas reshjeve të shiut dhe dëbores pasi furnizohet nga burime të ndryshme përgjatë rrjedhës së tij dhe këto rrjedhje shkaktojnë dëme të mëdha në fushat bujqësore që kryesisht gjenden në afërsi të lumit, shkaktojnë erozion dhe përmbytin rrugët rurale dhe nacionale kur lumi del nga shtrati.

Dëmi më i madh që shkakton dalja e lumit nga shtrati është dëmtimi i themeleve të godinave duke rrezikuar strukturën e tyre. Në shumë raste janë dëmtuar muret mbajtëse të rrugëve dhe banesave duke i detyruar banorët ti braktisin ato banesa në pamundësi për të riparuar dëmet.

Gjatë stinës së dimrit 2023-2024 janë dëmtuar tre ura dhe rrëzuar murëmbajtëset e rrugëve të asfaltuara në katër vende, duke krijuar rrezik të lartë për banorët dhe udhëtarët të cilët duhet të kalojnë nëpër ato akse rrugore.

Janë vlerësuar paraprakisht disa punime që mund të ndikojnë në eleminimin apo uljen e rrezikut nga përmbytjet, si zgjerimi i shtratit të lumit ose ndërtimi i një kanali për lumin që kalon pranë banesave dhe tokave bujqësore i cili mund të krijonte një mundësi më të mirë për tu mbrojtur nga përmbytjet. Masa të veçanta duhen marrë edhe për dëmin masiv dhe rrezikun ekstremisht të lartë që i shkakton jetës së banorëve, gjallesave ujore dhe florës ndotja e kësaj mase ujore nga fabrika e përpunimit të bakrit në qytet që krijon derdhje të lëndëve toksike në lumë.

Gjithashtu shtrati i lumit është vlerësuar jo i sigurtë për shkak se në shumë vende ka formacione të hershme të mbetjeve drusore nga ish-fabrikat e përpunimit të drurit. Për më tepër, ndërtimi i HEC -eve përgjatë kaskadës së lumit Fan ka krijuar rrezikshmëri kur ka reshje sepse ka një rritje të menjëhershme të sasisë dhe rrjedhshmërisë ujore.

Mbështetur në sa më lart, si edhe në nevojën për planifikim dhe bashkërendim të masave që do të eleminonin apo ulnin rrezikut nga përmbytjet, është vlerësuar që kjo zonë (Mati 1) të vijojë të konsiderohet si zonë me rrezik potencial nga përmbytjet edhe për periudhën 3-vjecare, dhe ndërkohë të krijohen hartat e rrezikut dhe riskut nga përmbytjet për të mundësuar vlerësimin e saktë të rrezikut dhe riskut për probabilitetet e njohura.

Harta 19. Shtrirja e vendodhjes së zonës Mati 1, në territorin e Basenit Ujor Mat.



3. BASENI UJOR ISHËM

Në bashkëpunim me Prefekturën e Qarkut Tiranë dhe Prefekturën e Qarkut Durrës është disponuar informacioni për përmbytjet e ndodhura kohët e fundit (përmbytje të ndodhura pas atyre të referuara në Vlerësimin paraprak të rrezikut nga përmbytjet të miratuar në 2021), dhe mbështetur në ato informacione, si edhe hartat e rrezikut nga përmbytjet të krijuara nga projekti Pronews dhe hartat e krijuara nga projekti WBIF, është vlerësuar nëse zonat aktuale të shpallura në Basenin Ujor Ishëm do të mbeten si të tilla edhe për periudhën 3-vjeçare në vijim, si edhe nëse është e nevojshme të ketë zona të tjera me rrezik potencial që duhet të përfshihen rishtaz.

Konkretisht janë trajtuar informacionet për përmbytjet:


a) Në territorin e fshatrave Mucaj (2016), Gjokaj (2017) dhe Fushë-Prezë (2019).

Referuar hartave të rrezikut dhe riskut nga përmbytjet, të krijuara nga projekti WBIF, të cilat i kanë mbështetur modelimet e përmbytjeve në të dhënat historike, rezulton se territoret e fshatrave në fjalë nuk preken nga gjurma e përmbytjeve (përfshirë këtu përmbytjet me probabilitet të ulët, mesëm apo lartë por edhe nga ato të cilat marrin në konsideratë ndryshimet klimatike) (për referencë harta në vijim).

Harta 20. Harta e rrezikut nga përmbytjet për zonën Ishëm 3, e shtrirjes dhe thellësisë së ujit - Q max, P 0.5% / 1 herë në 200 vjet (projekti WBIF).



Harta 21. Harta e riskut nga përmbytjet për zonën Ishëm 3, e ndikimit me probabilitet 1 herë në 100 vjet (projekti WBIF).



Njëkohësisht në vlerësim janë marrë në konsideratë edhe faktet:

- këto përmbytje (në fshatin Mucaj, Gjokaj dhe Fushë-Prezë) janë ngjarje lokale dhe ndodhur vetëm në një rast, dhe të paregjistruara më parë në ngjarjet historike të konsideruara në Vlerësimin Paraprak të Rrezikut nga Përmbytjet të miratuar në vitin 2021, dhe të papërsëritur më pas vitit 2016 (2017);
- niveli i dëmëve të regjistruara në këtë ngjarje nuk janë të tilla për tu konsideruar të ngjashme me ngjarjet dhe dëmet mbi të cilat janë shpallur zonat e tjera në rang vendi;
- pjesa e territorit të Fushë-Prezë që është përgjatë lumit vlerësohet se është pjesë e territorit të zonës Ishëm 3.

Referuar nga sa më lart, territori në fjalë nuk mund të vlerësohet si zonë e re me rrezik potencial nga përmbytjet.

b) Seksioni prej 7 km, në urën e Gjolës në fshatin Breg Shkozë, të Njësisë Administrative Prezë.


Ky territor është i përfshirë në zonën Ishëm 2 të shpallur tashmë dhe nga modelimi hidraulik i përmbytjeve në këto zona (zonat Ishëm 2 dhe Ishëm 3 të njëpasnjëshme) ka rezultuar Harta e rrezikut nga përmbytjet e cila e krijon shtrirjen e përmbytjes, ku përfshihet edhe territori i fshatit Breg Shkozë dhe Ura e Gjolës (për referencë hartat në vijim);

Harta 22. Hartat e rrezikut nga përmbytjet për zonën Ishëm 2 dhe Ishëm 3, e shtrirjes dhe thellësisë së ujit - Q max, P 1% / 1 herë në 100 vjet (projekti WBIF).





Harta 23. Harta e riskut nga përmbytjet për zonën Ishëm 2, e ndikimit me probabilitet 1 herë në 100 vjet (projekti WBIF).



Nga sa më lart, zona në urën e Gjolës në fshatin Breg Shkozë, të Njësisë Administrative Prezë, nuk është një zonë e re për tu konsideruar si shtesë në zonat e shpallura tashmë.

Ajo është pjesë e zonës Ishëm 2 dhe Ishëm 3 dhe është pjesë e territorit të përmbytur që rezulton nga modelimet hidraulike dhe për rrjedhim do të vijojë të konsiderohen si zona për të cilat organet e menaxhimit të burimeve ujore (AMBU dhe ZABU) në koordinim dhe bashkëpunim me institucionet qëndrore dhe lokale, të mbështetur nga projekti i sipërcituar, do të hartojnë planet e menaxhimit të rrezikut nga përmbytja dhe do të përcaktojnë masat konkrete që do të duhet të ndërmerren për eleminimin apo uljen e rrezikut në këto zona.

Njëkohësisht, është trajtuar informacioni në lidhje me përmbytjet e kohëve të fundit (2016 e në vijim) në këto territore, nëse është e nevojshme të kryhen vlerësime për zona të reja për tu shpallur si zona me rrezik potencial për 6 vitet e ardhshme.

c) Përmbytjet në territorin e fshatit Zall Bastar (2023).

Referuar hartave të rrezikut nga përmbytjet, të krijuara ngë projekti WBIF, të cilat i kanë mbështetur modelimet e përmbytjeve në të dhënat historike, rezulton se territori i kësaj zone nuk preket nga gjurma e përmbytjeve (përfshirë këtu përmbytjet me probabilitet të ulët, mesëm apo lartë por edhe nga ato të cilat marrin në konsideratë ndryshimet klimatike) (për referencë harta në vijim).

Njëkohësisht në vlerësim janë marrë në konsideratë edhe faktet:

- kjo përmbytje është ngjarje lokale dhe ndodhur vetëm në një rast, dhe të paregjistruara më parë në ngjarjet historike të konsideruara në Vlerësimin Paraprak të Rrezikut nga Përmbytjet të miratuar në vitin 2021;
- niveli i dëmëve të regjistruara në këtë ngjarje (përmbytur vetëm reth 2 ha tokë bujqësore) nuk janë të tilla për tu konsideruar të ngjashme me ngjarjet dhe dëmet mbi të cilat janë shpallur zonat e tjera në rang vendi.

Referuar argumenteve të mësipërme, territori në fjalë nuk mund të vlerësohet si zonë e re me rrezik potencial nga përmbytjet.

d) Territoret e Paskuqanit, Bathores, Laknasit, Frutikulurës dhe Valiasit, janë territore pjesë e zonave të shpallura (Ishëm 1) apo në territore afër apo ndërmjet zonave Ishëm 1 dhe Ishëm 3, e për rrjedhim nuk vlerësohet se duhet të konsiderohen si zonë/zona të reja për tu shpallur me rrezikshmëri (për referencë hartat në vijim).


Harta 24. Hartat e rrezikut nga përmbytjet për zonën Ishëm 1 dhe Ishëm 3, e shtrirjes dhe thellësisë së ujit - Q max, P 1% / 1 herë në 100 vjet (projekti WBIF).





Project and Assignment / Projekti dhe detyrat
Existing situation on flood hazard and risk
FLOOD HAZARD MAPS
Ishëm, APSFR 1
Adriatic Sea
MAP BACKGROUND
CONSULTANT
BENEFICIARY
AMBU


Project and Assignment / Projekti dhe detyrat
Existing situation on flood hazard and risk
FLOOD HAZARD MAPS
Ishëm, APSFR 1
Adriatic Sea
MAP BACKGROUND
CONSULTANT
BENEFICIARY
AMBU

Harta 25. Hartat e riskut nga përmbytjet për zonën Ishëm 1, e ndikimit me probabilitet 1 herë në 100 vjet (projekti WBIF).







e) Është vlerësuar gjithashtu edhe informacioni për territoret e prekur nga përmbytjet e viteve të fundit në bashkinë Krujë (Bubq, Murqinë, Bilaj, Ura e Gjolës, Thumanë, Derven, Fushë Derven, Dukagjin i Ri, Miliskaj, Bushnesh, Luz, Hasan dhe Arramenas).

Duke qenë se këto territore ndodhen përgjatë apo në afërsi të zonave Ishëm 2 dhe Ishëm 3, ato trajtohen kundrejt këtyre zonave.


Harta 26. Pasqyrimi grafik i zonës së përmbytjeve Ishëm 2 dhe Ishëm 3 dhe fshatrave që janë përgjatë apo në afërsi të tyre.



Territoret e fshatrave Murqine, Bilaj, Derven, Fushë Derven, Ura e Gjolës, Hasan, Luz dhe Arramenas janë tashmë pjesë e zonës Ishëm 2.


Ndërkohë, territoret e fshatrave Bubq, Dukagjin i Ri dhe Miliskaj, pavarësisht se nuk janë në afërsi të grafikës së zonës së shpallur me rrezik, referuar hartave të përmbytjes së krijuara, ato janë pjesë e zonës së modeluar Ishëm 2 (për referencë hartaës në vijim), e për rrjedhim janë marrë në konsideratë në procesin e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet.

Harta 27. Shtrirja dhe niveli i përmbytjes për probabilitetin 1 herë në 100 vjet (zonat Ishëm 3 dhe Ishëm 2).



Territoret Thumanë dhe Bushnesh (qendrat e fshatrave) edhe nga modelimi i përmbytjeve me probabilitet 1 herë në 200 vjet, duke përfshirë edhe parashikimin e ndryshimeve klimatike, nuk rezultojnë të përfshihen plotësisht, në mënyrë të qenësishme, në zonën e përmbytjes, e për rrjedhim, vlerësohet se këto territore nuk janë prekur apo preken nga përmbytjet, ose të paktën nuk preken në "nivelet" e krahasueshme me zonat e tjera të shpallura.

Harta 28. Shtrirja dhe niveli i përmbytjes për probabilitetin 1 herë në 200 vjet (zona Ishëm 2).



Nga sa më lart, është vlerësuar se **zonat Ishëm 1, Ishëm 2 dhe Ishëm 3 do të vijojnë të konsiderohen si zona rreziku edhe për 3 vitet në vijim** dhe për ato zona, organet e menaxhimit të burimeve ujore (AMBU dhe ZABU) në koordinim dhe bashkëpunim me institucionet qendrore dhe lokale, referuar hartave të rrezikut dhe të riskut, me asistencën e projektit, duhet të hartojnë planin e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet dhe të përcaktojnë masat konkrete të mëtejshme që do të duhet të ndërmerren për eleminimin apo uljen e rrezikut në të gjithë territorin e zonës.

Njëkohësisht, rezulton se **nuk ka zona/zonë të shpallur rishtaz** që duhet të përfshihet në zonat e rrezikut për 3 vitet e ardhshme.

Harta 29. Shtrirja e vendodhjes së zonave Ishëm 1, Ishëm 2 dhe Ishëm 3, në territorin e Basenit Ujor Ishëm.



Ndyshimet klimatike janë marë në konsideratë vetëm në zonat me rrezikshmëri të cilat shtrihen në zonat bregdetare, ku edhe këto ndikime janë vlerësuar si më të qenësishme. Këto të fundit korrespondojnë me zonat Ishëm 2 dhe Ishëm 3.

4. BASENI UJOR ERZEN

A. ZONAT ME RREZIK POTENCIAL NGA PËRMBYTJET ERZEN 5 dhe ERZEN 6

Në bashkëpunim me Prefekturën e Qarkut Tiranë dhe Prefekturën e Qarkut Durrës është disponuar informacioni për përmbytjet e ndodhura kohët e fundit (përmbytje të ndodhura pas atyre të referuara në Vlerësimin paraprak të rrezikut nga përmbytjet të miratuar në 2021), dhe mbështetur në ato informacione, si edhe hartat e rezikut nga përmbytjet të krijuara nga projekti Pronews dhe hartat e krijuara nga projekti WBIF, është vlerësuar nëse zonat aktuale të shpallura në Basenin Ujor Erzen do të mbeten si të tilla edhe për periudhën 3-vjeçare në vijim, si edhe nëse është e nevojshme të ketë zona të tjera me rrezik potencial që duhet të përfshihen rishtaz.

Është trajtuar informacioni në lidhje me përmbytjet e kohëve të fundit (2016 e deri më sot) në këto territore, nëse është e nevojshmë të kryhen vlerësime për zona të reja për tu shpallur si zona me rrezik potencial për 6 vitet e ardhshme. Konkretisht:

a) Përmbytjet e vitit 2017 në territorin e fshatrave Rrakull, Momël, Shtodhër dhe Tilaj (Kavajë).

Referuar hartave të rezikut nga përmbytjet, të krijuara ngë projekti WBIF, të cilat i kanë mbështetur modelimet e përmbytjeve në të dhënat historike, rezulton se territoret e fshatrave në fjalë nuk preken nga gjurma e përmbytjeve (përfshirë këtu përmbytjet me probabilitet të ulët, mesëm apo lartë por edhe nga ato të cilat marrin në konsideratë ndryshimet klimatike) (për referencë harta në vijim).

Harta 30. Harta e rrezikut nga përmbytjet për zonën Erzen 5 dhe Erzen 6, e shtrirjes dhe thellësisë së ujit - Q max, P 0.5% / 1 herë në 200 vjet (projekti WBIF).



Njëkohësisht në vlerësim janë marrë në konsideratë edhe faktet:

- këto përmbytje (në fshatrat Rrakull, Shtodhër dhe Tilaj) janë ngjarje lokale dhe ndodhur vetëm në një rast, dhe të pa regjistruara më parë në ngjarjet historike të konsideruara në Vlerësimin Paraprak të Rrezikut nga Përmbytjet të miratuar në vitin 2021, dhe të pa përsëritura më, pas vitit 2017;
- përmbytja në fshatin Momël është gjithashtu një ngjarje lokale dhe ndodhur me pasoja të regjistruara vetëm në 2023, dhe të pa regjistruara më parë në ngjarjet historike të konsideruara në Vlerësimin Paraprak të Rrezikut nga Përmbytjet të miratuar në vitin 2021;
- niveli i dëmëve të regjistruara në këto ngjarje nuk janë të tilla për tu konsideruar të krahasueshme/ngjashme me ngjarjet dhe dëmët mbi të cilat janë shpallur zonat e tjera në rang vendi.

Referuar nga sa më lart, territori në fjalë nuk mund të vlerësohet si zonë e re me rrezik potencial nga përmbytjet.

b) Zona e Golemit (zona turistike), rezulton të jetë e përshirë tashmë në territorin ndërmjet Zonës së shpallur me rrezik Erzeni 5 dhe Erzeni 6, për rrjedhim nuk vlerësohet të shpallet si zonë e re me rrezik (për referencë harta e mësipërme).

Harta 31. Shtrirja e vendodhjes së zonave Erzen 5 dhe Erzen 6, në territorin e Basenit Ujor Erzen.



B. ZONAT ME RREZIK POTENCIAL NGA PERMBYTJET ERZEN 1 dhe ERZEN 3


Nga të dhënat e disponuara nëpërmjet Prefekturës së Qarkut Durrës për bashkitë Durrës, Krujë dhe Shijak, në lidhje me përmbytjet që janë evidentuar nga këto bashki, në periudhën kohore pas përmbytjeve të marra në konsideratë në Vlerësimin paraprak të rrezikut nga përmbytjet aktual, rezulton se territoret e prekura nga këto përmbytje të viteve të fundit, janë:

a) Në bashkinë Shijak: Hardhishta, Shijaku, Sallmone, Maminasi, si edhe rruga në fshatin Eminas i Vogël, rruga në fshatin Cizmeli dhe rrugë në njësinë administrative Gjepalaj;

b) Në bashkinë Durrës: Sukthi, Katund Sukth, Këneta qyteti Durrës, qyteti Durrës, Lagja nr.4 – rruga A. Goga dhe lagja Stallat;

(a) Territoret e relatuara si të prekur nga përmbytjet e viteve të fundit në këtë bashki: Shijak, Gjepalaj dhe Sallmone, rezultojnë të jenë pjesë e zonës Erzeni 1 (përgjatë apo në afërsi të saj).

Harta 32. Pasqyrimi grafik i zonës së përmbytjeve Erzeni 1 dhe fshatrave që janë përgjatë apo në afërsi të saj.




Grafika e zonave të shpallura me rrezik nga përmbytjet është grafikë indikative dhe pasqyron përgjithësisht segmentin e lumit i cili është konsideruar me rrezik potencial nga përmbytjet, në Vlerësimin paraprak aktual.


Për rrjedhim, ajo nuk pasqyron një zonë të mirëfilltë me shtrirje sipërfaqësore në terren, por gjithsesi parashikon territoret e prekura duke shpjeguar në kartelën përkatëse bashkitë apo njësitë administrative të prekura (Zona Erzeni 1- janë prekur territore në Prefekturën Durrës).

Territoret e fshatrave të sipërpërmendur, janë pjesë e territorit të përmbytur, që rezulton nga modelimet hidraulike të kryera së fundi nga Projekti "Shqipëria, planet e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet për lumenjtë Erzen, Ishem, Shkumbin, Seman dhe Vjosë", financuar nga BE dhe zbatuar nëpërmjet Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor- WBIF.


Modelimi dhe hartëzimi janë mbështetur në të dhënat meteorologjike dhe hidraulike historike, si edhe të dhënave aktuale të terrenit dhe veprave publike, dhe ka hartëzuar shtrirjen e përmbytjes dhe nivelin e saj për probabilitetet kryesore të ndodhjes së një përmbytjeje për zonën Erzeni 1 (për referencë hartat në vijim).

Harta 33. Hartat e shtrirjes dhe nivelit të përmbytjes për probabilitetin 1 herë në 100 vjet (Erzen 1, Erzen 2 dhe Erzen 3).





Harta 34. Harta e riskut nga përmbytjet (ndikimi i përmbytjes) për probabilitetin 1 herë në 100 vjet (Erzen 1, Erzen 2 dhe Erzen 3).





Ndërkohë, fshati Hardhishtë (qendra), fshati Eminas i Vogël, rruga në fshatin Cizmeli dhe Maminasi rezultojnë në distancë nga grafika e zonës së shpallur në vitin 2021.

Por, duke marrë në konsideratë faktin se:

- nga modelimet hidraulike të kryera për ndërtimin e hartës së përmbytjes me probabilitet 1 herë në 200 vjet, e cila është ndërtuar mbi të dhënat historike, territoret e Maminasit preken nga përmbytjen; territoret e fshatit Hardhishtë, fshatit Eminas i Vogël dhe rrugët në fshatin Cizmeli nuk janë prekur apo preken nga përmbytjet, ose të paktën nuk preken në "nivelet" e krahasueshme me zonat e tjera të shpallura (për referencë harta nr.34);
- zona të reja do të duhet të konsiderohen nëse ato nuk bëjnë pjesë në zonat aktuale, si dhe kryesisht nëse në ato territore, gjatë periudhës 2016-2023 kanë ndodhur përmbytje të cilat kanë patur pasoja të qenësishme në jetën apo shëndetin e njerëzve, banesa, ekonomi, bujqësi apo trashëgimi kulturore, të tilla që të paraqesin rrezik të nivelit të ngjashëm me zonat e tjera në rang vendi;

vlerësojmë se nuk ka zona/zonë që duhet të përfshihet në zonat e rrezikut për 3 vitet e ardhshme (në territorin e bashkisë Shijak/territorin përkatës të Basenit Ujor Erzen).

Referuar sa më lart, vlerësohet gjithashtu se zona Erzen 1 duhet të vijojë të konsiderohet si zonë rreziku edhe për 3 vitet në vijim dhe për atë zonë organet e menaxhimit të burimeve ujore (AMBU dhe ZABU) në koordinim dhe bashkëpunim me institucionet qendrore dhe lokale, referuar hartave të rrezikut dhe të riskut, duhet të hartojnë planin e menaxhimit të rrezikut nga përmbytja dhe të përcaktojnë masat konkrete të mëtejshme që do të duhet të ndërmerren për eleminimin apo uljen e rrezikut në të gjithë territorin e zonës.

(b) Duke qenë se territoret e prekur nga përmbytjet e viteve të fundit në bashkinë Durrës (Sukthi, Katund Sukth, Këneta qyteti Durrës, qyteti Durrës, Lagja nr.4 – rruga A. Goga dhe lagja Stalla) ndodhen përgjatë apo në afërsi të zonave Erzen 1 dhe Erzen 3 (përgjatë apo në afërsi të saj), ato trajtohen kundrejt këtyre zonave.

Harta 35. Pasqyrim grafik i zonës së përmbytjeve Erzen 1 dhe Erzen 3 dhe fshatrave që janë përgjatë apo në afërsi të saj.



Përsëri sqarojmë, se grafika e zonave të shpallura me rrezik nga përmbytjet është indikative dhe pasqyron përgjithësisht segmentin e lumit i cili është konsideruar me rrezik potencial nga përmbytjet, në Vlerësimin paraprak aktual. Në rastin konkret ato kanë konsideruar si territore të prekura – Qytetin Durrës dhe Prefekturën Durrës (kartelat për zonën Erzen 1 dhe Erzen 3 sipas Vlerësimit paraprak të rrezikut nga përmbytjet të miratuar në 2021).

Territoret e Sukthit, fshatit Katund Sukth dhe lagjja Stalla në Erzen, rezultojnë të jenë pjesë (plotësisht) e zonës aktuale të shpallur Erzen 1, ndërsa territoret e Kënetës Durrës, qytetit Durrës janë pjesë (plotësisht) e zonës Erzen 3.

Ato gjithashtu, rezultojnë të jenë pjesë e territorit të përmbytur që rezulton nga modelimet hidraulike të kryera së fundi nga projekti i sipërcituar, për zonën Erzeni 1 dhe Erzeni 3 (referuar hartave 33 dhe 34).

Ndërkohë, në lidhje me përmbytjet në rrugën "Aleksandër Goga", të lagjes 4 të qytetit Durrës, vlerësojmë se territori në fjalë është ekskluzivisht urban dhe preket nga përmbytjet urbane, të

cilat janë përmbytje jo në fokus të legjislacionit për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet në kuptimin e menaxhimit të integruar të burimeve ujore. Kjo referuar edhe përcaktimeve të Direktivës së BE-së, ku *"Përmbytje" do të thotë: mbulimi i përkohshëm nga uji i një toke që normalisht nuk mbulohet nga uji. Kjo përfshin përmbytjet nga lumenjtë, përrenjtë malorë, nga shkarkimet e digave, rrjedhat ujore kalimtare Mesdhetare dhe përmbytjet nga deti në zonat bregdetare, me përjashtim të përmbytjeve nga sistemet e kanalizimit të ujërave të ndotur urbane*.

Ato gjithashtu konsiderohen përmbytje që shkaktohen kryesisht nga mosfunksionimi i plotë/i saktë i infrastrukturës urbane dhe masat që duhen marrë për shmangien/zvogëlimin e tyre janë të njohura.

Në vijim të sa më lart, është vlerësuar se zonat Erzen 1 dhe Erzen 3 duhet të vijojnë të konsiderohen si zona rreziku edhe për 3 vitet në vijim dhe për atë zonë organet e menaxhimit të burimeve ujore (AMBU dhe ZABU) në koordinim dhe bashkëpunim me institucionet qëndrore dhe lokale, referuar hartave të rrezikut dhe të riskut, duhet të hartojnë planin e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet dhe të përcaktojnë masat konkrete të mëtejshme që do të duhet të ndërmerren për eleminimin apo uljen e rrezikut në të gjithë territorin e zonës. Njëkohësisht, vlerësojmë se nuk ka zona/zonë për tu shpallur rishtaz e që duhet të përfshihet në zonat e rrezikut për 6 vitet e ardhshme (në territorin e bashkisë Durrës dhe Shijak të Basenit Ujor Erzen).


Harta 36. Shtrirja e vendodhjes së zonave Erzen 1 dhe Erzen 3, në territorin e Basenit Ujor. Erzen.




C. ZONAT ME RREZIK POTENCIAL NGA PERMBYTJET ERZEN 2, ERZEN 4

Në lidhje me zonat Erzen 2 dhe Erzeni 4, të shpallura në vitin 2021, vlerësimi është mbështetur në hartat e përmbytjeve të kryera nga modelimet e Projektit, të cilat i janë referuar të dhënave dhe informacioneve historike dhe që tregojnë se territoret e zonave në fjalë preken nga përmbytjet dhe kanë risk potencial nga këto përmbytje.


Harta 37. Harta e rrezikut nga përmbytjet për ZRrPP Erzen 2, e thellësisë së ujit - Q max, P 1% / 1 herë në 100 vjet (Pronews).




Harta 38. Shtrirja dhe niveli i përmbytjes për probabilitetin 1 herë ne 100 vjet (Erzen 2) (WBIF).




Harta 39. Harta e riskut nga përmbytjet (ndikimi) për probabilitetin 1 herë ne 100 vjet (Erzen 2) (WBIF).



Harta 40. Shtrirja dhe niveli i përmbytjes për probabilitetin 1 herë ne 100 vjet (Erzen 4).



Harta 41. Harta e riskut nga përmbytjet (ndikimi) për probabilitetin 1 herë ne 100 vjet (Erzen 4) (WBIF).



Për këto zona, është vlerësuar se duhet të vijojnë të konsiderohen zona me rrezik potencial nga përmbytjet, për 3 vitet e ardhshme dhe organet e menaxhimit të burimeve ujore (AMBU dhe ZABU) në koordinim dhe bashkëpunim me institucionet qendrore dhe lokale, referuar hartave të rrezikut dhe të riskut, duhet të hartojnë planin e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet dhe të përcaktojnë masat konkrete të mëtejshme që do të duhet të ndërmerren për eliminimin apo uljen e rrezikut në të gjithë territorin e zonave.

Gjithashtu, nuk evidentohen zona të reja për tu shpallur si zona me rrezik potencial për 3 vitet e ardhshme.

Harta 42. Shtrirja e vendodhjes së zonave Erzen 2 dhe Erzen 4, në territorin e Basenit Ujor Erzen.



Nga sa më lart, është vlerësuar se zonat **Erzen1, Erzen 2, Erzen 3, Erzen 4, Erzen 5 dhe Erzen 6 duhet të vijojnë të konsiderohen zona me rrezik potencial nga përmbytjet**, për 3 vitet e ardhshme dhe organet e menaxhimit të burimeve ujore (AMBU dhe ZABU) në

koordinim dhe bashkëpunim me institucionet qendrore dhe lokale, referuar hartave të rrezikut dhe të riskut, duhet të hartojnë planin e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet dhe të përcaktojnë masat konkrete të mëtejshme që do të duhet të ndërmerren për eleminimin apo uljen e rrezikut në të gjithë territorin e zonave. Gjithashtu, në Basenin Erzen, **nuk evidentohen zona të reja për tu shpallur** si zona me rrezik potencial për 3 vitet e ardhshme.

Ndyshimet klimatike janë marë në konsideratë vetëm në zonat me rrezikshmëri të cilat shtrihen në zonat bregdetare, ku edhe këto ndikime janë vlerësuar si më të qenësishme. Konkretisht për zonat Erzen 1, Erzen 5 dhe Erzen 6.


5. BASENI UJOR SHKUMBIN

A. ZONAT ME RREZIK POTENCIAL NGA PERMBYTJET SHKUMBIN 1, SHKUMBIN 2 DHE SHKUMBIN 3

Në bashkëpunim me Prefekturën e Qarkut Fier si edhe Prefekturën e Qarkut Tiranë janë disponuar informacionet për përmbytjet e ndodhura kohët e fundit (përmbytje të ndodhura pas atyre të referuara në Vlerësimin paraprak të rrezikut nga përmbytjet të miratuar në 2021), dhe mbështetur në ato informacione, hartat e rrezikut nga përmbytjet të krijuara nga projekti Pronews, hartat e krijuara nga projekti WBIF si dhe dokumenti i Vlerësimit të Riskut nga Fatkeqësitë në Qarkun Fier, është vlerësuar nëse zonat aktuale të shpallura në Basenin Ujor Shkumbin (Shkumbin 1, Shkumbin 2, Shkumbin 3) do të mbeten si të tilla edhe për periudhën 3-vjeçare në vijim, si edhe nëse është e nevojshme të ketë zona të tjera me rrezik potencial që duhet të përfshihen rishtaz.


Vlerësimi i referohet kryesisht faktit që edhe pas modelimeve hidraulike të fundit të përmbytjeve të kryera nga projekti, territoret e këtyre zonave vijojnë të rezultojnë të prekura në shkallë të konsiderueshme (për referencë hartat në vijim).

Harta 43. Harta e rrezikut nga përmbytjet për ZRrPP Shkumbin 2 dhe ZRrPP Shkumbin 3, e shtrirjes dhe thellësisë së ujit - Q max, P 1% / 1 herë në 100 vjet (projekti Pronews).




Harta 44. Hartat e rrezikut nga përmbytjet për Zonën Shkumbin 1, Shkumbin 2 dhe Shkumbin 3, e shtrirjes dhe thellësisë së ujit - 1 herë në 100 vjet (WBIF).






Project and Assignment / Projekti dhe detyrat
Western Balkans Investment Framework Infrastructure Project Facility Technical Assistance 10 (IPF 10)
WB20-ALB-ENV-02 Albania, Flood Risk Management Plans for Erzen, Ishem, Shkumbin, Seman and Vjosa Rivers.
Report title / Titulli i raportit
Existing situation on flood hazard and risk
ANNEX / ANEKSI
FLOOD HAZARD MAPS
DRAWING NAME AND NUMBER / EMRI DHE NUMRI I VIZATIMIT
Shkumbini, APSFR 1 2 3
FLOOD EXTENT AND FLOOD DEPTHS MAP
SCALE / SHKALLA
1:10 000
LEGEND / LEGJENDA
Residential Building
River channel / Lake
Municipality
Road
Bridge
High risk APSFR
Embankment
Inundation depth
0 - 0.5 m
0.5 - 1 m
1 - 2 m
2 - 5 m
>5 m
N
Scale / Shkalla 1:25,000 printed on A1
0 500 1,000 2,000 Meters
PROJECTION PROJEKSIONI: ETRS 1989 UTM Zone 34N
Local Projection / Projeksioni lokal: ETRS 1989 Albania 2018
SHEET / FAQE 3 of 3
A1
B1
C1
MAP BACKGROUND / HARTA BAZE
Orthophoto Albania and Topographic Map Sources Data
Shkumbini, Erzeni, Ishmi, Semani dhe Vjosa
Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG)
Western Balkans Investment Framework
CONSULTANT / KONSULENTI
BENEFICIARY / PËRFITUESI
IPF 10 PLANET
AMBU
Prepared by / përgatitur
Checked by / Rishikuar nga
Approved by / aprovuar nga
Besnik Islamaj
Alban Doko
Kristian Zotaj
Rosa Muraki
David Kelly
DATE / DATA: 07/09/2023
ISSUE / ZGJIDHJA: 01

Harta 45. Harta e rrezikut nga përmbytjet për Qarkun Fier sipas Dokumentit të Paraprak të Vlerësimit të Riskut të Prefekturës së Qarkut Fier.



Ndërkohë janë trajtuar edhe informacionet në lidhje me përmbytjet nga Sinaballaj deri në Vilë Bashtovë, në fshatin Kalush të njësisë administrative Gosë, si edhe përmbytjet në fshatin Lekaj (Rogozhinë) me qëllim për të shqyrtuar nëse indentifikohen zona të reja me rrezikshmëri, përpos atyre të shpallura aktualisht.

Territori nga Sinaballaj deri ne Vilë Bashtovë (rreth 15 km), në fshatin Kalush të njësisë administrative Gosë, është i përfshirë në zonën Shkumbin 2, të shpallur tashmë. Shtojmë këtu edhe faktin se nga modelimi hidraulik i përmbytjeve në këto zona (zonat Shkumbin 2 dhe Shkumbin 3 të njëpasnjëshme), ka rezultuar Harta e rezikut nga përmbytjet, ku përfshihet edhe territori i fshatrave Sinaballaj, Kalush, Vilë-Ballaj dhe fshatrat e tjerë në afërsi të lumit Shkumbin (për referencë hartat e mësipërme);

Ndërkohë, nga modelimet hidraulike të projektit, edhe në rastin e ngjarjeve ekstreme, nuk rezulton qe territoret e fshatit Lekaj të përfshihen në gjurmën e përmbytjeve. Gjithashtu ngjarja e përmbytjeve të vitit 2021 nuk është një ngjarje e regjistruar më parë në përmbytjet historike dhe niveli i dëmëve është vetëm në sipërfaqe toke të mbuluar me ujë (pra jo në nivelin e dëmeve mbi të cilat një zonë konsiderohet me rrezik potencial).

Referuar sa më lart, është vlerësuar se zonat **Shkumbi 1, Shkumbin 2 dhe Shkumbin 3,** do të vijojnë të konsiderohen zona me rrezik potencial nga përmbytjet edhe për periudhën 6 vjeçare në vijim, si edhe nuk është e nevojshme të ketë zona të tjera me rrezik potencial që duhet të përfshihen rishtaz.

Harta 46. Shtrirja e vendodhjes së Shkumbin 1, Shkumbin 2 dhe Shkumbin 3, në territorin e Basenit Ujor Shkumbin.



B. ZONA ME RREZIK POTENCIAL NGA PERMBYTJET SHKUMBIN 4


Vlerësimi i referohet kryesisht faktit që edhe pas modelimeve hidraulike të fundit të përmbytjeve të kryera nga projekti WBIF, territoret e kësaj zone vijojnë të rezultojnë të prekura në shkallë të konsiderueshme (për referencë harta në vijim).

Harta 47. Harta e rrezikut nga përmbytjet për Zonën Shkumbin 4, e shtrirjes dhe thellësisë së ujit - 1 herë në 100 vjet (WBIF).



Gjithashtu, në këtë rast vlerësimi i referohet edhe faktit që hartat e riskut të krijuara nga projekti WBIF, evidentojnë dëme në këto territore (për referencë harta në vijim).

Harta 48. Harta e riskut nga përmbytjet për Zonën Shkumbin 4, e shtrirjes dhe thellësisë së ujit - 1 herë në 100 vjet (WBIF).



Nga sa më lart, vlerësohet se zona Shkumbin 4 do të vijojë të konsiderohet si zonë rreziku edhe për 3 vitet në vijim dhe për atë zonë organet e menaxhimit të burimeve ujore (AMBU dhe ZABU) në koordinim dhe bashkëpunim me institucionet qëndrore dhe lokale, referuar hartave të rrezikut dhe të riskut, duhet të hartojnë planin e menaxhimit të rrezikut nga përmbytja dhe të përcaktojnë masat konkrete të mëtejshme që do të duhet të ndërmerren për eleminimin apo uljen e rrezikut në të gjithë territorin e zonës.

Harta 49. Shtrirja e vendodhjes zona Shkumbin 4, në territorin e Basenit Ujor Shkumbin dhe Basenin Ujor Erzen.




C. ZONA ME RREZIK POTENCIAL NGA PERMBYTJET SHKUMBIN 8

Në bashkëpunim me Prefekturën e Qarkut Elbasan është disponuar informacioni për përmbytjet e ndodhura kohët e fundit (përmbytje të ndodhura pas atyre të referuara në Vlerësimin paraprak të rrezikut nga përmbytjet të miratuar në 2021) dhe veprat mbrojtëse të ndërtuara kohët e fundit, dhe mbështetur në ato informacione, në hartat e rezikut nga përmbytjet të krijuara nga projekti Pronews, në hartat e krijuara nga projekti WBIF është vlerësuar nëse zona Shkumbi 8 aktuale do të mbeten si e tillë edhe për periudhën 3 vjeçare në vijim, si edhe nëse është e nevojshme të ketë zona të tjera me rrezik potencial që duhet të përfshihen rishtaz.

Për sa më lart i referohemi kryesisht faktit që edhe pas modelimeve hidraulike të fundit të përmbytjeve të kryera nga projekti, ajo vijon të rezultojë e prekur në shkallë të konsiderueshme (për referencë hartat në vijim).

Harta 50. Harta e rrezikut nga përmbytjet për Zonat Shkumbin 7 dhe ZRrPP Shkumbin 8, e thellësisë së ujit - Q max, P 1% / 1 herë në 100 vjet (projekti Pronews).




Është vlerësuar zona në fshatin Muriqan (bashkia Elbasan) dhe lagjja nr.3 Cërrik, në të cilën relatohet se është realizuar mbrojtje nga lumi Shkumbin, e cila ul rezikun e përmbytjeve në këtë territor, nëse duhet të të konsiderohet në të ardhmen si zonë me rrezik. Kjo zonë përkon me një pjesë të zonës së shpallur Shkumbin 8.

Referuar, modelimeve hidraulike të kryera së fundi nga Projekti "Shqipëria, planet e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet për lumenjtë Erzen, Ishëm, Shkumbin, Seman dhe Vjosë", financuar nga BE dhe zbatuar nëpërmjet Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor- WBIF, i cili mbështetur në të dhënat meteorologjike dhe hidraulike historike, si edhe të dhënave aktuale të terrenit dhe veprave publike, është hartëzuar shtrirja e përmbytjes për zonën Shkumbin 8 duke marrë në konsideratë edhe argjinaturën.


Konkretisht edhe po t'i referohemi modelimit rezulton se territori i fshatit Muriqan nuk preket nga përmbytjet për arsye të argjinaturës (e cilësuar në hartën në vijim me ngjyrë vjollcë).


Gjithsesi, kjo mbrojtje, e cila ka karakter lokal/pjesor kundrejt të gjithë zonës Shkumbini 8, nuk ndikon në masë të tillë për të eleminuar këtë zonë nga zonat e shpallura me rrezikshmëri nga përmbytjet (për referencë harta në vijim);

Harta 51. Pjesë e hartës së rrezikut nga përmbytjet për Zonën Shkumbin 8, e shtrirjes dhe thellësisë së ujit - 1 herë në 100 vjet (WBIF) (vijat me ngjyrë vjollcë janë argjinaturat e marra në konsideratë në modelim).



Harta 52. Hartat e rrezikut nga përmbytjet për Zonën Shkumbin 7 dhe Shkumbin 8, e shtrirjes dhe thellësisë së ujit - 1 herë në 100 vjet (WBIF).






Zona e shpallur Shkumbin 8 e cila grafikisht dhe skematikisht pasqyrohet në hartë me vijë të kuqe, rezulton të shtrihet përtej zonave të fshatit Muriqan apo lagjes nr.3 Cërrik. Këtë shtrirje e vertetojnë edhe hartat e rrezikut nga përmbytjet të modeluara (referuar po hartës së mësipërme).

Nga sa më lart, vlerësohet se zona **Shkumbin 8** do të vijojë të konsiderohet si zonë rreziku edhe për 3 vitet në vijim dhe për atë zonë organet e menaxhimit të burimeve ujore (AMBU dhe ZABU) në koordinim dhe bashkëpunim me institucionet qëndrore dhe lokale, referuar hartave të rrezikut dhe të riskut, duhet të hartojnë planin e menaxhimit të rrezikut nga përmbytja dhe të përcaktojnë masat konkrete të mëtejshme që do të duhet të ndërmerren për eleminimin apo uljen e rrezikut në të gjithë territorin e zonës.

Harta 53. Shtrirja e vendodhjes zona Shkumbin 8, në territorin e Basenit Ujor Shkumbin.



D. ZONAT ME RREZIK POTENCIAL NGA PERMBYTJET SHKUMBIN 5, SHKUMBIN 6 DHE SHKUMBIN 7


Në bashkëpunim me Prefekturën e Qarkut Elbasan është disponuar informacioni për përmbytjet e ndodhura kohët e fundit (përmbytje të ndodhura pas atyre të referuara në Vlerësimin paraprak të rrezikut nga përmbytjet të miratuar në 2021) dhe veprat mbrojtëse të ndërtuara kohët e fundit, dhe mbështetur në ato informacione, në hartat e rezikut nga përmbytjet të krijuara nga projekti Pronews, në hartat e krijuara nga projekti WBIF është vlerësuar nëse zonat aktuale të shpallura në Basenin Ujor Shkumbin (që përkojnë me territoret e Qarkut Fier (Shkumbin 5, Shkumbin 6, Shkumbin 7) do të mbeten si të tilla edhe për periudhën 3 vjeçare në vijim, si edhe nëse është e nevojshme të ketë zona të tjera me rrezik potencial që duhet të përfshihen rishtaz.

Për sa më lart i referohemi kryesisht faktit që edhe pas modelimeve hidraulike të fundit të përmbytjeve të kryera nga projekti, në territoret e këtyre zonave, ato vijojnë të rezultojnë të prekura në shkallë të konsiderueshme (për referencë hartat në vijim).


Harta 54. Harta e rrezikut nga përmbytjet për Zonën Shkumbin 5, e shtrirjes dhe thellësisë së ujit - 1 herë në 100 vjet (WBIF).



Harta 55. - Harta e rrezikut nga përmbytjet për Zonën Shkumbin 6, e shtrirjes dhe thellësisë së ujit - 1 herë në 100 vjet (WBIF).



Harta 56. Hartat e rrezikut nga përmbytjet për Zonën Shkumbin 7 (përfrhirë edhe Shkumbin 5 dhe Shkumbin 8), e shtrirjes dhe thellësisë së ujit - 1 herë në 100 vjet (WBIF).







Harta 57. Harta e riksut nga përmbytjet për Zonën Shkumbin 5 (ndikimi) - 1 herë në 100 vjet (WBIF).



Harta 58. Harta e riksut nga përmbytjet për Zonën Shkumbin 6 (ndikimi) - 1 herë në 100 vjet (WBIF).



Harta 59. Harta e riksut nga përmbytjet për Zonën Shkumbin 7 (ndikimi) - 1 herë në 100 vjet (WBIF) (përfshin edhe zonën Shkumbin 8).



Në bashkërendim me Prefekturën e Qarkut Elbasan është konsideruar edhe informacioni për mundësinë e zonave të reja për tu shpallur me rrezik potencial nga përmbytjet.

Konkretisht 2 zonat e trajtuara:

a) Zona e njësive administrative Klos dhe Mollas (fshatrat Luma-Klos, Lumas, Qyrkan, Selvias, Klos, Dasar, Mollas, Kamunah, Linas dhe Selitë), që përkon me lumin Devoll dhe përrenjt që derdhen në të, me një gjatësi rreth 11 km;
b) Përroin e Zarranikës nga prita e përroit të Zarranikës deri në grykderdhjen në lumin Shkumbin, me një gjatësi rreth 5.2 km.

(a), zona e **njësive administrative Klos dhe Mollas** është vleresuar nëse duhet të përfshihet rishtaz në zonat me rrezikshmëri (Harta në vijim).

Harta 60. Vendodhja e fshatrave Luma-Klos, Lumas, Qyrkan, Selvias, Klos, Dasar, Mollas, Kamunah, Linas dhe Selitë.




Nga të dhënat në lidhje me përmbytjet e viteve të fundit, rezulton se përmbytjet në këto zona kanë ndikim vetëm në sipërfaqe toke e cila është me përdorim bujqësor, pra krahasimisht jo në "nivelin" dhe shkallën e kombinimit të dëmeve mbi të cilat janë vlerësuar dhe shpallur 46 zonat


me rrezik potencial në rang vendi (përfshirë edhe zonat e Basenit Ujor Shkumbin), në të cilat janë konstatuar dhe konsideruar dëmet në shëndetin e njerëzve, në humbje të gjësë së gjallë, banesave, aktiviteteve ekonomike, bujqësisë, infrastrukturë, trashëgimisë kulturore, etj.


Gjithashtu, në këtë vlerësim është konsideruar edhe fakti që rrjedha ujore në këtë segment të lumit Devoll është e ndikuar/rregulluar drejtpërdrejtë nga administrimi i digës së rezervuarit të Banjës dhe regjimi i shkarkimeve të saj.

Prefektura Elbasan, ka referuar harta sipas modelimeve hidraulike, të cilat pasqyrojnë sipërfaqet e përmbytura për prurjet me probabiliteti 1 herë në 1000 vjet, që vijnë si rezultat i ngjarjes së prishjes/shkatërrimit të digës në fjalë (harta në vijim).

Harta 61. Gjurma e përmbytjes në zonën e fshatrave Luma-Klos, Lumas, Qyrkan, Selvias, Klos, Dasar, Mollas, Kamunah, Linas dhe Selitë, nga përmbytja si rezultat i prishjes së digës së Banjës (probabilitet 1 herë në 1000 vjet).







Në kuptimin e përmbytjeve sipas legjislacionit mbi të cilin realizohet vlerësimi i rrezikut të përmbytjeve, krijimi i hartave dhe hartimi i planeve të menaxhimit të këtij rreziku, merren në konsideratë përgjithësisht përmbytjet nga burimet:

- Lumore (përmbytja e tokës nga ujëra që burojnë nga pjesë të sistemit natyror të kullimit, duke përfshirë kanalet natyrore ose të modifikuara të kullimit. Ky burim mund të përfshijë përmbytjet nga lumenjtë, përrenjtë, kanalet e kullimit, rrëketë malore dhe rrjedhat kalimtare ujore, liqenet dhe përmbytjet që shkaktohen nga shkrirja e dëborës);
- Shirat (përmbytja e tokës drejtpërdrejtë nga reshjet e dendura të shiut që bien, ose rrjedhin në tokë. Ky burim përfshin stuhitë urbane, rrjedhat në rrugë tokësore rurale ose ujin e tepërt, si dhe përmbytjet tokësore që shkaktohen nga shkrirja e dëborës);

- Ujërat nëntokësorë (përmbytja e tokës nga ujërat nëntokësorë që dalin mbi sipërfaqen e tokës. Ky burim mund të përfshijë daljen e ujërave nëntokësorë dhe rrjedhat nëntokësore nga ujërat e ngritur sipërfaqësorë);
- Uji i detit (përmbytja e tokës nga uji i detit, grykëderdhjet dhe liqenet bregdetare. Ky burim përfshin përmbytjet nga deti. P.sh. niveli ekstrem i baticës dhe/ose valët e mëdha të stuhive ose që shkaktohen nga dallgët ose tsunamet bregdetare);
- Infrastruktura artificiale me ujë (përmbytja e tokës nga uji që del nga infrastruktura artificiale me ujë ose nga mosfunksionimi i kësaj infrastrukture. Ky burim mund të përfshijë përmbytjet që shkaktohen nga sistemet e kanalizimeve duke përfshirë ujërat e stuhive, kanalizimet e kombinuara dhe të dëmtuara, sistemet e furnizimit me ujë dhe trajtimit të ujërave të ndotur urbane, kanalet artificiale të lundrimit dhe strukturat e mbyllura, p.sh. digat dhe rezervuarët).

Probabiliteti i prishjes së digës konsiderohet si rrezik jo i madh (si në rastin konkret që është parashikuar/vlerësuar/modeluar për probabilitet 1 herë në 1000 vjet), krahasuar me mundësitë e përmbytjeve lumore (që konsiderohet 1 herë në 200 vjet apo 300 vjet).

Për më tepër që, në rastin konkret, kemi të bëjmë me një digë/infrastrukturë aktualisht funksionale dhe për të cilën vlerësimi konsiderohet se realizohet rregullisht dhe merren parasysh në planet e mirëmbajtjes edhe skenarët e menaxhimit të rrezikut nga vetë administruesit e kësaj infrastrukture.

Për më tepër, që referuar edhe përcaktimeve të Direktivës së BE-së, ku *"Përmbytje" do të thotë: mbulimi i përkohshëm nga uji i një toke që normalisht nuk mbulohet nga uji. Kjo përfshin përmbytjet nga lumenjtë, përrenjtë malorë, nga shkarkimet e digave, rrjedhat ujore kalimtare Mesdhetare dhe përmbytjet nga deti në zonat bregdetare, me përjashtim të përmbytjeve nga sistemet e kanalizimit të ujërave të ndotur urbane*.

Për sa më lart, vlerësohet se zona e fshatrave të **njësive administrative Klos dhe Mollas**, nuk do të ishte e nevojshme të konsiderohej dhe të shpallej si një zonë e re me rrezik përmbytjeje.

Ndërkohë, është përdorur i njëjti arsyetim dhe argumentim, si më sipër, edhe për përmbytjet të cilat shkaktohen nga prishjet/shkatërrimet e digave të rezervuarëve Moglicë, Kodovjat dhe Cërrik.

(b) zona e **Përroit të Zarranikës** është vlerësuar nëse duhet të përfshihet rishtaz në zonat me rrezikshmëri (harta në vijim).

Përroi i Zarranikës është një trup ujor i modifikuar/sistemuar plotësisht, i cili ndikohet kryesisht edhe nga "diga" në veri dhe nga skarpatet në të dy krahët e tij.

Indetifikohet se shkaktarët kryesorë të përmbytjeve apo dëmeve që mund të shkaktojë ky segment i tij janë mosfunksionimi i "digës" dhe/ose prishjet e argjinaturave.


Harta 62. Vendndodhja se zonës së përroit të Zarranikës.



Mbështetur në legjislacionet sektoriale, bashkia Elbasan administron këtë infrastrukturë të mbrotjes lumore dhe ka përgjegjësinë për të planifikuar dhe realizuar mirëmbajtjen e saj apo përmirësimin me qëllim mbrojtjen e zonave të banuara nga dëmet që mund të shkaktohen nga mosfunksionimi.

Referuar sa më lart, si dhe faktit që mungojnë të dhëna konkrete mbi dëmet e shkaktuara në këto territore, të dhëna këto të cilat do të mundësonin vlerësimin e "nivelit" dhe shkallës së dëmeve mbi të cilat janë vlerësuar dhe shpallur 46 zonat me rrezik potencial në rang vendi (në të cilat janë konstatuar dhe konsideruar dëmet në shëndetin e njerëzve, në humbje të gjësë së gjallë, banesave, aktiviteteve ekonomike, bujqësisë, infrastrukturës, trashëgimisë kulturore, etj.), si edhe faktit që një pjesë e kësaj zone (pjesa jugore në derdhjen e tij në lumin Shkumbin) është zgjatim i zonës tashmë të shpallur Shkumbini 7 dhe pjesë e modelimeve hidraulike për zonën Shkumbin 7, Shkumbin 8 dhe zonën ndërmjet tyre, është vlerësuar që zona e përroit të Zarranikës, nuk do të ishte e nevojshme të konsiderohej dhe të shpallej si një zonë e re me rrezik përmbytjeje.

Harta 63. Hartat e riskut nga përmbytjet për Zonën Shkumbin 7, Shkumbin 8 dhe zona ndërmjet tyre (ndikimi) - 1 herë në 100 vjet (WBIF).




Gjithashtu, duke u bazuar në të dhënat kombëtare dhe lokale, në Bashkinë Elbasan janë evidentuar disa projekte për të parandaluar rrezikun nga përmbytjet, në zonat aktualisht të shpallura më rrezik nga përmbytjet. Konkretisht:

- Mbrojtje lumore në bregun e majtë të lumit Shkumbin nga Ura e Shkumbinit deri në veprën e marrjes së KU N.Panxhi, me gjatësi L = 2km;
  Kjo mbrotje lumore nuk është konsideruar nga projektimi në modelimin hidraulik të përmbytjeve me probabilitetet përkatëse.
  Gjithsesi, kjo mbrojtje e cila ka karakter lokal/pjesor kundrejt të gjithë zonës Shkumbin 7, nuk ndikon në masë të tillë për të eleminuar këtë zonë nga zonat e shpallura me rrezikshmëri nga përmbytjet (për referencë harta në vijim);

- Mbrojtje lumore në bregun e djathtë të lumit Shkumbin nga ish-Pularia deri në Krastë me gjatësi L = 3 km;
  Kjo mbrotje si dhe efektet që ajo jep në uljen e rrezikut nga përmbytja, është konsideruar nga modelimi hidraulik, por pavarësisht kësaj mbrotje përsëri zona Shkumbin 7 ndikohet nga përmbytja referuar hartës në vijim.

Harta 64. Pjesë e hartës së rrezikut nga përmbytjet për Zonën Shkumbin 7, e shtrirjes dhe thellësisë së ujit - 1 herë në 100 vjet (WBIF) (vijat me ngjyrë jollcëe janë argjinaturat e marra në konsideratë në modelim).



– Mbrojtje lumore në bregun e majtë të lumit Shkumbin në fshatin Bujqës me gjatësi L = 700 m;
  Kjo mbrotje si dhe efektet që ajo jep në uljen e rrezikut nga përmbytja, është konsideruar nga modelimi hidraulik, pavarësisht se ky territor nuk ndodhet në zonat e shpallura Shkumbin 7 dhe Shkumbin 8.

– Mbrojtje lumore në bregun e djathtë të lumit Shkumbin, në Papër, me gjatësi L = 700 m;
  Kjo mbrotje (muri mbrojtës i rrugës) si dhe efektet që ajo jep në uljen e rrezikut nga përmbytja, është konsideruar nga modelimi hidraulik. Gjithsesi, kjo mbrojtje e cila ka karakter lokal/pjesor kundrejt të gjithë zonës Shkumbin 8, nuk ndikon në masë të tillë për të eleminuar këtë zonë nga zonat e shpallura me rrezikshmëri nga përmbytjet (për referencë harta në vijim).

Harta 65. Pjesë e hartës së rrezikut nga përmbytjet për Zonën Shkumbin 8, e shtrirjes dhe thellësisë së ujit - 1 herë në 100 vjet (WBIF) (vijat me ngjyrë vjollcë janë argjinaturat e marra në konsideratë në modelim).




- Mbrojtje lumore në bregun e djathtë të lumit Shkumbin, në Shushicë, me gjatësi L = 1.5 km;
  Kjo mbrotje nuk është konsideruar në modelim, por gjithsesi nëse e mbron realisht territorin nga përmbytja, ajo është në kufijtë e zonës Shkumbin 7, në rrjedhën e poshtme e për rrjedhim nuk mund të konsiderohet e tillë për të eleminuar këtë zonë nga zonat e shpallura me rrezik.

- Mbrojtje lumore në bregun e djathtë të lumit Shkumbin, në Polis Valë me gjatësi L = 1.5km;
  Kjo zonë nuk është pjesë e zonave me rrezikshmëri, por ndodhet reth 3 km nga kufiri i sipërm i zonës së shpallur tashmë Shkumbin 5. Duke konsideruar se ndodhet në rrjedhën e sipërme të përmbytjes dhe ka karakter lokal/pjesor, nuk vlerësohet se ndikon në nivel të tillë për të shmangur rrezikshmërinë në zonën Shkumbin 5 (dhe për rrjedhim eleminimin e saj nga zonat e shpallura me rezik) (për referencë harta në vijim).

Nga sa më lart, vlerësohet se zonat **Shkumbin 5, Shkumbin 6 dhe Shkumbin 7** do të vijojnë të konsiderohet si zona rreziku edhe për 3 vitet në vijim.

Harta 66. Pjesë e hartës së rrezikut nga përmbytjet për Zonën Shkumbin 5, e shtrirjes dhe thellësisë së ujit - 1 herë në 100 vjet (WBIF).



Harta 67. Shtrirja e vendodhjes zonat Shkumbin 5, Shkumbin 6 dhe Shkumbin 7, në territorin e Basenit Ujor Shkumbin.



Nga informacioni i bashkërenduar me Prefekturën e Qarkut, kanë rezultuar ngjarje përmbytjesh në periudhën 2016 e deri më tani edhe në fshatrat Shalës të bashkisë Cërrik; Balëz dhe Malasej të bashkisë Elbasan; qytetin Gramsh (qytet lagjja Holtas); Drangaj të bashkisë Peqin dhe fshatrat në njësinë Orenjë të bashkisë Librazhd.

Duke konsideruar nivelin e dëmëve të shkaktuara nga këto përmbytje, që është kryesisht në sipërfaqe të kufizuara të tokave bujqësore, numër të kufizuar të dëmëve në banesa apo vetëm në disa vepra infrastrukturore, është vlerësuar se niveli nuk është i tillë (i ngjashëm) me atë të konsideruar në rastin e shpalljes së zonave me rrezik nga përmbytjet aktuale apo në vijim.

Nga sa më lart, është vlerësuar se zonat **Shkumbin 1, Shkumbin 2, Shkumbin 3, Shkumbin 4, Shkumbin 5, Shkumbin 6, Shkumbin 7 dhe Shkumbin 8 duhet të vijojnë të konsiderohen zona me rrezik potencial nga përmbytjet**, për 3 vitet e ardhshme dhe organet e menaxhimit të burimeve ujore (AMBU dhe ZABU) në koordinim dhe bashkëpunim me institucionet qendrore dhe lokale, referuar hartave të rrezikut dhe të riskut, duhet të hartojnë planin e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet dhe të përcaktojnë masat konkrete të mëtejshme që do të duhet të ndërmerren për eleminimin apo uljen e rrezikut në të gjithë territorin e zonave.

Gjithashtu, në Basenin Shkumbin, **nuk evidentohen zona të reja për tu shpallur** si zona me rrezik potencial për 3 vitet e ardhshme.

Ndyshimet klimatike janë marë në konsideratë vetëm në zonat me rrezikshmëri të cilat shtrihen në zonat bregdetare, ku edhe këto ndikime janë vlerësuar si më të qenësishme. Konkretisht për zonat Shkumbin 2 dhe Shkumbin 4.

6. BASENI UJOR SEMAN

A. ZONA ME RREZIK POTENCIAL NGA PERMBYTJET SEMAN 9

Në bashkëpunim me Prefekturën e Qarkut Berat është disponuar informacioni për përmbytjet e ndodhura kohët e fundit (përmbytje të ndodhura pas atyre të referuara në Vlerësimin paraprak të rrezikut nga përmbytjet të miratuar në 2021), si edhe për ndërhyrjet infrastrukturore mbrojtëse në terren të cilat mund të ndikojnë në eleminimin apo uljen e rrezikut nga përmbytjet në territore të caktuara.

Mbështetur në këtë informacion janë vlerësuar 2 zona, në të cilat ndërhyrjet mund të ndikojnë në eleminimin apo uljen e rrezikut nga përmbytjet:

a) Zona Skrapar (Zona ekzistuese me rrezikshmëri të lartë përmbytjeje Seman 9);

b) Zona Poliçan.

(a) Në **zonën në Skrapar**, është realizuar nga bashkia Skrapar një investim, me financim të buxhetit të shtetit, nëpërmjet AKMC-së për mbrotjen civile, që konsiston në ndërhyrje për mbrojtje nga gërryerjet e lumit, e cila vlerësohet se ul ndjeshëm rrezikun nga përmbytjet.

Harta 68. Vendndodhja e punimeve të mbrojtjes lumore.



Referuar vendndodhjes së punimeve mbrojtëse në Çorovodë, sipas pozicionimit të tyre në terren dhe pasqyruar në hartën e ASIG, rezulton se seksionet e mbrotjes në fjalë janë në lumin Osum, në jug-perëndim të zonës së shpallur (Seman 9) dhe përtej kufirit jugor të kësaj zone.

Harta 69. Vendndodhja e punimeve të mbrojtjes lumore (ngjyrë portokalli) kundrejt zonës së shpallur me rrezikshmëri Seman 9 (me të kuqe).



Mbrojtja lumore në fjalë, në thelb nuk ndikon në uljen e rrezikut të përmbytjeve në rrjedhën e sipërme të lumit (lumi Çorovodës degë e lumit Osum) e cila është konsideruar si zonë rreziku Seman 9.

Njëkohësisht, për këtë zonë dhe territoret përreth saj janë kryer aktualisht modelimet hidraulike nga Projekti "Shqipëria, planet e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet për lumenjtë Erzen, Ishem, Shkumbin, Seman dhe Vjosë", financuar nga BE dhe zbatuar nëpërmjet Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor- WBIF, i cili mbështetur në të dhënat meteorologjike dhe hidraulike historike, si edhe të dhënave aktuale të terrenit dhe veprave publike, ka hartëzuar/rihartëzuar shtrirjen e përmbytjes dhe nivelin e saj për probabilitetet kryesore të ndodhjes së një përmbytjeje (1 herë në 33 vjet, 50 vjet, 100 dhe 200 vjet) për zonën Seman 9.

Referuar hartëzimit për shtrirjen e përmbytjes (sipas hartës në vijim), rezulton se territori i zonës Seman 9, si edhe segmenti i lumit Osum që kryqëzohet me lumin e Çorovodës vijojnë të jenë territore që mbulohen nga përmbytjet dhe që paraqesin rrezik.

Për rrjedhim vlerësojmë se zona **Seman 9** duhet të vijojë të konsiderohet si zonë rreziku edhe për ciklin 3-vjeçar në vijim dhe për atë zonë organet e menaxhimit të burimeve ujore (AMBU dhe ZABU) në koordinim dhe bashkëpunim me institucionet qëndrore dhe lokale, referuar hartave të rrezikut dhe të riskut, duhet të hartojnë planin e menaxhimit të rrezikut nga përmbytja dhe të përcaktojnë masat konkrete që do të duhet të ndërmerren për eleminimin apo uljen e rrezikut.

Harta 70. Shtrirja dhe nivelit të përmbytjes për probabilitetin 1 herë ne 200 vjet (Seman 9).



Harta 80. Shtrirja e vendodhjes së Zonës Seman 9 në territorin e basniet Ujor Seman.




(b) Në **Zonën Poliçan**, në fshatin Mbrakull, të njësisë administrative Vërtop, është duke u realizuar investim nga bashkia Poliçan, me financim të buxhetit të shtetit, nëpërmjet AKMC-së për mbrojtjen civile, që konsiston në ndërhyrje për mbrojtje nga gërryerjet e lumit. Investimi referohet se ul ndjeshëm rrezikun nga përmbytjet të tokave të këtij fshati.

Aktualisht, ky territor nuk bën pjesë në zonat e shpallura me rrezikshmëri nga përmbytjet Seman 7, Seman 8 apo Seman 9.

Referuar edhe hartës në vijim mbrojtja lumore në fjalë, ndodhet në distanca relativisht të largëta nga skajet e zonave Seman 8 (~10 km) dhe Seman 9 (~18 km), dhe nuk përkon me zonat e shpallura në VPRP-në e miratuar në 2021.

Për rrjedhim është vlerësuar se kjo zonë nuk mund të konsiderohet si zonë që duhet të hiqet nga zonat e shpallura ekzistuese, për faktin se nuk ka qënë e tillë më parë.

Harta 81. Vendndodhja e zonës Mbrakull (rethimi me ngjyrë të kuqe) kundrejt zonave të shpallura me rrezikshmëri (vijat e kuqe).



B. ZONAT ME RREZIK POTENCIAL NGA PERMBYTJET SEMAN 7 (SEMAN 6&7) DHE SEMAN 8

Në bashkëpunim me Prefekturën e Qarkut Berat është disponuar informacioni për përmbytjet e ndodhura kohët e fundit (përmbytje të ndodhura pas atyre të referuara në Vlerësimin paraprak të rrezikut nga përmbytjet të miratuar në 2021), dhe mbështetur në ato informacione është vlerësuar në lidhje me zona të tjera me rrezik potencial që duhet të përfshihen rishtaz.

Konkretisht nga informacionet janë trajtuar 2 zona të cilat duhet të vlerësohen:

a) Zona Dimal, njësia administrative Poshnjë dhe Kutalli, fshatrat Kuç, Samaticë, Goriçan, Hinkë dhe Sheq-Gajdë (zona e pjesës fundore për Qarkun Berat, që përkon

me fillimin e lumit Seman, e cila nuk ka një studim të mirëfilltë për rrezikun, që përfshin një seksion rreth 25.7 km dhe përfshin rreth 8 pika rreziku);

b) Zona Berat, njësia administrative Velabisht, fshatrat Bilçë, Remanicë, Veterik, Orizaj dhe Moravë (zona e cila në pjesë të caktuara ka përmirësim të argjinaturës, por që në kushtet e rënies së sasive të konsiderueshmë të reshjeve konsiderohet si joplotësisht e sigurtë, që përfshin 5 pika rreziku në bashkinë Berat);

(a) Në lidhje me Zonën Dimal rezulton, se një pjesë e kësaj zone përgjatë lumit Seman, e cila përfshin fshatrat Sheq, Gajde, Kuç dhe një pjesë e territorit të fshatit Hinkë (Hingë) është pjesë e zonës tashmë të shpallur **Seman 7** (si edhe pasqyrohet në hartën në vijim).

Ndërkohë, territori i fshatrave Samaticë dhe Goriçan ndodhet ndërmjet dy zonave tashmë të shpallura Seman 6 dhe Seman 7, por sipas grafikës referuese, shumë afër këtyre zonave.

Harta 82. Vendndodhja e zonës Dimal të propozuar (fshatrat Kuç, Samaticë, Goriçan, Hinkë dhe Sheq-Gajdë kundrejt zonave të shpallura me rrezikshmëri Seman 6 dhe Seman 7 (vijat e kuqe).




Duhet mbajtur parasysh se:

- grafika e zonave me rrezikshmëri (vija e kuqe përgajtë shtratit të lumit) është kryesisht referuese për të identifikuar segmentin lumor me më shumë rrezik në terren dhe kjo zonë/vijë nuk ka rrjedhur nga modelime hidraulike të mirëfillta të përmbytjeve e si e tillë, kufijtë e saj në segmentin lumor nuk janë plotësisht kufizuese;


- Vlerësimi paraprak të cilin po shqyrtojnë, në Shtojcën 1, të Aneksit II të Raportit të Vlerësimit Paraprak të miratuar, ka marrë në konsideratë edhe përmbytjet historike në njësinë administrative (atëherë komuna) Poshnjë, pra edhe fshatrat përkatës;
- Dëmet e përmbytjeve të pas vitit 2016 të evidentuara, të cilat do të konsiderohen bashkë me dëmet e mëparshme mbi të cilat është hartuar Vlerësimi Paraprak ekzisutes, janë veçanërisht dëme nga përmbytjet në kultura bujqësore e sera, në këto fshatra, pra krahasimisht jo në "nivelin" dhe shkallën e kombinimit të dëmeve mbi të cilat janë vlerësuar dhe shpallur 46 zonat me rrezik potencial në rang vendi, në të cilat janë konstatuar dhe konsideruar dëmet në shëndetin e njerëzve, në humbje të gjësë së gjallë, banesave, aktiviteteve ekonomike, bujqësisë, infrastrukturë, trashëgimisë kulturore, etj;
- Për zonat Seman 6 dhe Seman 7, ndërmjet të cilave ndodhen edhe fshatrat Stamaticë dhe Goriçan dhe territoret përreth tyre, janë kryer aktualisht modelimet hidraulike nga Projekti "Shqipëria, planet e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet për lumenjtë Erzen, Ishëm, Shkumbin, Seman dhe Vjosë", financuar nga BE dhe zbatuar nëpërmjet Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor- WBIF, i cili mbështetur në të dhënat meteorologjike dhe hidraulike historike, si edhe të dhënat aktuale të terrenit dhe veprave publike, ka hartëzuar shtrirjen e përmbytjes dhe nivelin e saj për probabilitetet kryesore të ndodhjes së një përmbytjeje (1 herë në 33 vjet, 50 vjet, 100 dhe 200 vjet). Modelimi tregon se fshatrat në fjalë përfshihen në gjurmën e përmbytjes (referohemi hartës në vijim);

Harta 83. Gjurma e përmbytjet për probabilitetin 1 herë në 200 vjet për Zonat Seman 6 dhe Seman 7, kundrejt vendndodhjes së zonës Dimal (fshatrat Kuç, Samaticë, Goriçan, Hinkë dhe Sheq-Gajdë (WBIF).



Nga sa më lart, është vlerësuar se zona në Dimal, nuk do të ishte e nevojshme të konsiderohej si një zonë e re me rrezik përmbytjeje e veçantë, por ajo në planifikimin për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet, do të jetë pjesë e zonave ekzituese **Seman 6** dhe **Seman 7**.

Harta 84. Shtrirja e vendodhjes së Zonës Seman 6 dhe Seman 7 në territorin e basenit Ujor Seman.



(b) Në lidhje me **zonën Berat** rezulton, se një pjesë e kësaj zone përgjatë lumit Osum, që përfshin fshatrat Bilçë dhe Remanicë është pjesë e zonës tashmë të shpallur Seman 8 (si edhe pasqyrohet në hartën në vijim).

Ndërkohë, territori i fshatrave Veterik, Orizaj dhe Moravë ndodhet në pjesën veriore të zonës së shpallur Seman 8, por sipas grafikës referuese, shumë afër kësaj zone (zona Veterik rreth 3 km nga kufiri verior i grafikës referuese të zonës Seman 8).

Harta 85. Vendndodhja e zonës Berat (fshatrat Bilçë, Remanicë, Veterik, Orizaj dhe Moravë kundrejt zonës së shpallur me rrezikshmëri Seman 8 (vija e kuqe).




Edhe në këtë rast, duke mbajtur parasysh vlerësimet për zonën Dimal më lart, është vlerësuar se zona Berat (si shtrirje në veri e zonës ekzistuese), nuk do të ishte e nevojshme të konsiderohej si një zonë e re me rrezik përmbytjeje, por ajo, në planifikim do të jetë pjesë e zonës ekzituese Seman 8.

Në këtë rast, argumenti që "*harta e rrezikut/shtrirja e përmbytjes shtrihet përtej grafikës referuese të zonës me rrezik*", të pasqyruar me vijë të kuqe në hartën e mësipërme, është i mbështetur nga hartat në vijim të cilat korespondojnë me gjurmën e shtrirjes së përmbytjes zonën Seman 8.

Konkretisht, përmbytja shtrihet në veri deri në zonën e fshatit Moravë, e për rrjedhim procesi do të vijojë me identifikimin e dëmeve të mundshme në të gjithë sipërfaqen e përmbytjes, si dhe hartimin e planit të menaxhimit dhe identifikimin e masave për eleminimin apo uljen e dëmeve të mundshme edhe në këto zona.

Harta 86. Shtrirja e përmbytjes sipas modelimit për zonën Seman 8, probabiliteti i ndodhjes 1 herë në 100 vjet (segmenti verior deri në Moravë) (projekti WBIF).



Harta 87. Shtrirja e përmbytjes sipas modelimit për zonën Seman 8, probabiliteti i ndodhjes 1 herë në 100 vjet (segmenti qendror qyteti Berat) (projekti WBIF).



Harta 88. Shtrirja e përmbytjes sipas modelimit për zonën Seman 8, probabiliteti i ndodhjes 1 herë në 100 vjet (segmenti jugor deri në Fushë-Peshtan) (projekti WBIF).



Në territoret përgjatë lumit Seman, që korrespondojnë me zonën Seman 8, janë realizuar disa vepra mbrojtëse lumore lokale me qëllim uljen e rrezikut nga përmbytjet, të cilat duhet të trajtohen në lidhje me ndikim që mund të kenë në uljen e rrezikut në zonat e shpallura (ndikimi mbrojtjës i cili mund të bëjë që këto zona të mos përfshihen në zonat e shpallura për periudhën në vijim).

Nga verifikimi i secilës prej tyre, ka rezultuar se disa nga këto mbrojtje, pavarësisht se mund të jenë objekte të ndërtuara apo në plan për tu ndërtuar, ato nuk ndikojnë në stadin e zonave të shpallura (për shkak të distancës nga zonat e shpallura apo referuar gjurmës së përmbytjeve sipas hartave të rrezikut të krijuara).

Ndërkohë, për pjesën tjetër të objekteve mbrojtëse, është kryer vlerësimi rast pas rasti, si më poshtë vijon:

- Mbrojtjet e territorit të fshatrave Bliçë, Starovë, Velabisht dhe Uznovë (sipas vendndodhjes së përcaktuar në hartat në vijim), janë objekte mbrojtëse të njohura tashmë nga projekti i cili ka kryer modelimet hidraulike dhe ka krijuar hartat e rrezikut të cilat përcaktojnë gjurmën e përmbytjes për zonën e shpallur me rrezik Seman 8. Për rrjedhim efekti i tyre është i njohur dhe i konsideruar tashmë. (për referencë harta e rrezikut nga përmbytjet në vijim)

Harta 89. Mbrojtja në Bliçë, Starovë, Velabisht dhe Uznovë.







Harta 90. Shtrirja e përmbytjes sipas modelimit për zonën Seman 8 ku janë marrë në konsideratë edhe punimet mbrojtëse - argjinaturat – vijat me ngjyrë vjollcë (segmenti qendror qyteti Berat) (probabiliteti i ndodhjes 1 herë në 100 vjet).



- Mbrojtjet e territorit në Orizaj dhe në Vodicë (sipas vendodhjes së përcaktuar në hartat në vijim), janë objekte mbrojtëse me një shtrirje dhe ndikim veçanërisht lokal.


  Pavarësisht, se për këto zona, si pjesë e zonës së shpallur me rrezik Seman 8, projekti ka kryer modelimet hidraulike dhe ka krijuar hartat e rrezikut të cilat përcaktojnë gjurmën e përmbytjes, pa i patur në konsideratë, efekti i tyre vlerësohet se nuk ka ndikim në shtrirjen e përmbytjeve me probabilitet mesatar apo të lartë, për më tepër që mbrojtja Vodicë ndodhet në ekstremin jugorë të hartës së përmbytjes që korrespondon me rrjedhën e sipërme të lumit Osum, dhe si e tillë, shtuar faktin që është mbrotje lokale, nuk ndikon shtrirjen dhe nivelin e përmbytjes në rrjedhën e poshtme. (për referencë harta e rrezikut nga përmbytjet në vijim)

Harta 91. Vendodhja e mbrotjes Orizaj dhe Vodicë.






Harta 92. Shtrirja e përmbytjes sipas modelimit për zonën Seman 8, probabiliteti i ndodhjes 1 herë në 100 vjet (segmenti verior). Në lidhje me mbrotjet në Orizaj. (projekti WBIF).



Referuar sa më lart, është vlerësuar se veprat mbrojtëse të sipërcituara, nuk ndikojnë në masë të tillë që të vlerësohet se ndonjë nga zonat aktualisht të shpallura me rrezikshmëri (konkretisht Seman 8), duhet të mos përfshihen në listën e zonave me rrezikshmëri për periudhën në vijim. Për rrjedhim është vlerësuar se Zona Seman 8 duhet të vijojë të konsiderohet si zonë me rrezik potencial edhe për ciklin e ardhshëm 3-vjeçar.

Harta 93. Shtrirja e vendodhjes së Zonës Seman 8 në territorin e basenit Ujor Seman.




C. ZONAT ME RREZIK POTENCIAL NGA PERMBYTJET SEMAN 1, SEMAN 2, SEMAN 3, SEMAN 4, SEMAN 5, SEMAN 6, SEMAN 7

Në bashkëpunim me Prefekturën e Qarkut Fier është disponuar informacioni për përmbytjet e ndodhura kohët e fundit (përmbytje të ndodhura pas atyre të referuara në Vlerësimin paraprak të rrezikut nga përmbytjet të miratuar në 2021), dhe mbështetur në ato informacione dhe hartat e rrezikut nga përmbytjet të krijuara nga projekti Pronews, hartat e krijuara nga projekti WBIF, si edhe dokumenti i Vlerësimit të Riskut nga Fatkeqësitë në Qarkun Fier, është vlerësuar nëse zonat aktuale të shpallura në Basenin Ujor Seman ***(Seman 1, Seman 2, Seman 3, Seman 4, Seman 5 dhe Seman 6*** që përkojnë me territoret e Qarkut Fier) do të mbeten si të tilla edhe për periudhën 6-vjeçare në vijim, si edhe nëse është e nevojshme të ketë zona të tjera me rrezik potencial që duhet të përfshihen rishtaz.

Hartat në vijim i referohen tekstit më sipër.


Harta 94. Harta e rrezikut nga përmbytjet për Zonën Seman 3, Seman 4 dhe Seman 5, e shtrirjes dhe thellësisë së ujit - Q max, P 1% / 1 herë në 100 vjet (Pronews me të dhëna deri në 2015-2016).



Harta 95. Hartat e rrezikut nga përmbytjet për Zonën Seman 1, Seman 2, Seman 3, Seman 4, Seman 5 dhe Seman 6, të shtrirjes dhe thellësisë së ujit - 1 herë në 100 vjet (WBIF me të dhëna deri në 2021-2022)




Harta 96. Harta e rrezikut nga përmbytjet për Qarkun Fier sipas Dokumentit të Paraprak të Vlerësimit të Riskut të Prefekturës së Qarkut Fier.



Konkretisht, referuar hartave të mësipërme, zonat **Seman 1, Seman 2, Seman 3, Seman 4, Seman 5, Seman 6, Seman 7,** do të vijojnë të konsiderohen zona me rrezik potencial nga përmbytjet edhe për periudhën 6 vjeçare në vijim, si edhe nuk është e nevojshme të ketë zona të tjera me rrezik potencial që duhet të përfshihen rishtaz.

Harta 97. Shtrirja e vendodhjes së Zonave Seman 1, Seman 2, Seman 3, Seman 4, Seman 5, Seman 6, Seman 7, në territorin e basniet Ujor Seman.





D. ZONAT ME RREZIK POTENCIAL NGA PERMBYTJET SEMAN 10 DHE SEMAN 11

Në bashkëpunim me Prefekturën e Qarkut Korçë është disponuar informacioni për përmbytjet e ndodhura kohët e fundit (përmbytje të ndodhura pas atyre të referuara në Vlerësimin paraprak të rrezikut nga përmbytjet të miratuar në 2021), dhe mbështetur në ato informacione është vlerësuar në lidhje me zona aktuale me rrezik potencial Seman 10 dhe Seman 11, si edhe nëse zona të tjera me rrezik potencial duhet të përfshihen rishtaz.

Mbështetur në informacionet si edhe hartat e rrezikut të krijuara nga projekti WBIF (për referencë hartat në vijim), është vlerësuar se zonat Seman 10 dhe Seman 11, të vijojnë të konsiderohen si zona me rrezik potencial edhe në periudhën në vijim prej 6 vitesh.

Harta 98. Hartat e rrezikut nga përmbytjet për Zonën Seman 10, të shtrirjes dhe thellësisë së ujit - 1 herë në 100 vjet (projekti WBIF).





Harta 99. Harta e rrezikut nga përmbytjet për Zonën Seman 11, të shtrirjes dhe thellësisë së ujit - 1 herë në 100 vjet (projekti WBIF).



Ngjarjet e përmbytjeve të kohëve të fundit (2015 dhe 2017) kanë identifikuar se fshatrat Drithas, Vloçisht, Shëngjergj, Orman, Vreshtas, Podgorie, Bregas, Sheqeras, Pirg, Zvirinë, Sovjan, Veliternë, Leminot dhe Gurishtë të Qarkut Korcë (pjesë e Basenit Ujor Seman), janë prekur nga përmbytjet. Fshatrat Orman, Sheqeras dhe Sovjan janë në zonën e shpallur Seman 10 (në afërsi të grafikës së zonës së shpallur), referuar hartës në vijim.

Ndërkohë territoret e fshatit Drithas, pavarësisht se janë në distancë rreth 3 km nga grafika e zonës (qendra e fshatit), sipas hartave të mësipërme të përmbyjtes rezulton se janë të prekura nga përmbytja dhe për rrjedhim janë konsideruar si territore të prekura nga modelimi hidrografik i zonës Seman 10.


Harta 100. Harta që paraqet vendodhjen e fshatrave kundrejt grafikës së zonës Seman 10



Fshatrat Vloçisht, Shëngjergj, Vreshtas, Podgorie, Bregas, Pirg, Zvirinë, Veliternë, Leminot dhe Gurishtë, janë relativisht larg grafikës së zonës Seman 10, por megjithatë nga modelimet e kryera nga projekti, rezultojnë të jenë pjesë e zonës së që preket nga shtrirja e përmbytjes. Nga modelimi ka rezultuar se territoret e tyre nuk preken në masë të konsiderueshmë nga përmbytjet, dhe si të tilla "niveli" i dëmeve në ato territore nuk është i tillë që të konsiderohen si zona/zonë e re me rrezik potencial përmbytjeje (krahasuar kjo me nivelin e dëmeve më zonat e tjera të shpallura deri më tani). Gjithsesi ato si territore për të cilat është kryer modelimi do të konsiderohen si pjesë e zonës Seman 10 dhe do të vlerësohen në planifikimin e menaxhimit të rrezikut në vijim për këtë zonë apo të gjithë Basenin Ujor Seman.

Referuar sa më lart, zonat **Seman 10 dhe Seman 11,** do të vijojnë të konsiderohen zona me rrezik potencial nga përmbytjet edhe për periudhën 3-vjeçare në vijim, si edhe nuk është e nevojshme të ketë zona të tjera me rrezik potencial që duhet të përfshihen rishtaz.

Harta 101. Shtrirja e vendodhjes së Zonave Seman 10, Seman 11, në territorin e Basenit Ujor Seman.



Nga sa më lart, është vlerësuar se zonat **Seman 1, Seman 2, Seman 3, Seman 4, Seman 5, Seman 6, Seman 7, Seman 8, Seman 9, Seman 10 dhe Seman 11 duhet të vijojnë të konsiderohen zona me rrezik potencial nga përmbytjet**, për 3 vitet e ardhshme dhe organet e menaxhimit të burimeve ujore (AMBU dhe ZABU) në koordinim dhe bashkëpunim me institucionet qendrore dhe lokale, referuar hartave të rrezikut dhe të riskut, duhet të hartojnë planin e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet dhe të përcaktojnë masat konkrete të mëtejshme që do të duhet të ndërmerren për eleminimin apo uljen e rrezikut në të gjithë territorin e zonave.


Gjithashtu, në Basenin Seman, **nuk evidentohen zona të reja për tu shpallur** si zona me rrezik potencial për 3 vitet e ardhshme.

7. BASENI UJOR VJOSË


A. ZONAT ME RREZIK POTENCIAL NGA PERMBYTJET VJOSA 3, VJOSA 5 DHE VJOSA 7

Në bashkëpunim me Prefekturën e Qarkut Vlorë, Prefekturën e Qarkut Fier dhe Prefekturën e Qarkut Gjirokastër është disponuar informacioni për përmbytjet e ndodhura kohët e fundit (përmbytje të ndodhura pas atyre të referuara në Vlerësimin paraprak të rrezikut nga përmbytjet të miratuar në 2021), dhe mbështetur në ato informacione, si edhe hartat e rezikut nga përmbytjet të krijuara nga projekti Pronews, hartat e krijuara nga projekti WBIF si dhe dokumentin e Vlerësimit të Riskut nga Fatkeqësitë në Qarkun Fier, është vlerësuar nëse zonat aktuale të shpallura në Basenin Ujor Vjosë (Vjosa 3, Vjosa 5 dhe Vjosa 7) do të mbeten si të tilla edhe për periudhën 3-vjeçare në vijim, si edhe nëse është e nevojshme të ketë zona të tjera me rrezik potencial që duhet të përfshihen rishtaz në listën e zonave të shpallura.


Harta 102. Harta e rrezikut nga përmbytjet për Zona Vjosa 3, e shtrirjes dhe thellësisë së ujit - Q max, P 1% / 1 herë në 100 vjet (projekti Pronews).




Harta 103. Hartat e rrezikut nga përmbytjet për zonën Vjosa 3, e shtrirjes dhe thellësisë së ujit - Q max, P 1% / 1 herë në 100 vjet (projekti WBIF).









Harta 104. Hartat e rrezikut nga përmbytjet për zonën Vjosa 5 dhe Vjosa 7, e shtrirjes dhe thellësisë së ujit - Q max, P 1% / 1 herë në 100 vjet (projekti WBIF).




Project and Assignment / Projekti dhe detyrat
Western Balkans Investment Framework Infrastructure Project Facility Technical Assistance 10 (IPF10).
WB10 ALB ENV 02 Albania, Flood Risk Management Plans for Erzen, Ishem, Shkumbin, Seman and Vjosa Rivers.
Report title / Titulli i raportit
Existing situation on flood hazard and risk
Situacioni aktual mbi rrezikun dhe rrezikun nga përmbytjet
ANNEX 2.7
ANEKSI 2.7
FLOOD HAZARD MAPS
HARTAT E RREZIKUT NGA PËRMBYTJET
DRAWING NAME / Titulli i vizatimit
Vjosa, APSFR's 1, 7
NUMBER / NUMRI
FLOOD EXTENT AND FLOOD DEPTHS
SHTRIRJA DHE THELLËSIA E PËRMBYTJES
DOC NUMBER / NUMRI I DOKUMENTIT
2.00.03
LEGEND / LEGJENDA
Residential Building
Ndërtesat banimi
River channel / Lake
Shtrati i lumit / Liqeni
Road
Rrugë
Bridge
Urë
High risk APSFR
APSFR me rrezik të lartë
Embankment / Dignitaret
Inundation depth
Thellësia e përmbytjes
0 - 0.5 m
0.5 - 1 m
1 - 2 m
2 - 5 m
>5 m
N
Scale / Shkalla 1: 25,000 printed on / shtypur në A1
0
500
1,000
2,000
meters
PROJECTION / PROJEKSIONI: ETRS 1989 UTM Zone 34N
Local Projection / Projeksioni lokal: ETRS 1989 Albania 2010
SHEET / FAQJA 2 of / nga 2
Adriatic Sea
MAP BACKGROUND / HARTA SAT
Orthophotos Albania and Topographic Map Sources: State Authority for geospatial information of Albania (ASIG)
Ortofoto e Shqipërisë dhe burimet e hartave topografike: Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG)
Western Balkans Investment Framework
WBIF
BUILDING THE EUROPEAN ENERGY TRENTHS
CONSULTANT (KONSULENTI) BENEFICIARY / PËRFITUES
IPF 10 PLANET
Prepared by / përgatitur
Checked by / Kontrolluar nga
Approved by / aprovuar nga
Rachel Ickeringill
Alban Doko
Kristian Zotmi
Rovie Morosi
David Kelly
DATE / DATA: 22/NOV/2021
ISSUE / ZGJIDHJA: 01
Kaleman (Levan)
Levan
Kuta
Zhepanat (Kuta)
Anëbreg
Bregas (Corush)
Fratar
Bregu Memos (Krahës i Sipërm)
Llukaj (Krahës i Sipërm)
Ramuçaj
Shytaj (Krahës i Sipërm)
Zhulaj
Shamaj (Krahës i Sipërm)
Leskaj (Zhulaj)
Lukaj (Krahës i Sipërm)
Xhaxhaj
Bucka (Zhulaj)
Beginj (Xhaxhaj)
Krahës i Sipërm
Kamçishi
Bregas (Krahës)
Corush
Domaj (Krahës i Sipërm)
Brega Dove (Krahës)
Rrëzë (Krahës)
Krahës
APSFR 2 (Vjosa)
Lukzezi
Mazaj (Kalivaç)
Toç
Dokaj (Koshtan)
Përparim
Bozahë (Kalivaç)
Kalivaç
Koshtan
Shkozë
Shehaj (Koshtan)
Golembas
Leshnjeë (Kalivaç)
Hasanbegaj (Kalivaç)
Sevaster
Celaj (Mazhar-Sevaster)
Mazhar-Sevaster
Anëngjoll
Hysaj (Qesarat)
Caushaj (Kalivaç)
Zotaj (Qesarat)
Qesarat
Sinaj (Qesarat)
Asllanaj (Amanikaj)
Dorëz
Përjas (Qesarat)
Iliras
Mamogjinaj (Sinanaj)
Sinanaj
Dëshaj (Sinanaj)
Lap-Martalloz
Memetaj (Dhëmblan)

Harta 105. Harta e rrezikut nga përmbytjet për Qarkun Fier sipas Dokumentit të Paraprak të Vlerësimit të Riskut te Prefektit të Qarkut Fier.



Ndër të tjera, edhe informacionet për përmbytjet e evidentuara dhe analizuara në dokumentin "Vlerësimi i riskut nga fatkeqësitë në Shqipëri" (Raport i konsoliduar i gushtit 2022), i Agjencisë Kombëtare të Emergjencave Civile, konfirmojnë rrezikun nga përmbytjet me të cilat përballet zona Vjosa 3. Konkretisht:

a) Përmbytja e shkurtit 2015.

Reshjet e dendura, që variuan nga 160 deri në 200 mm në tre ditë (ekuivalente me një raport normal mujor), shkaktuan përmbytje në pjesën jugore dhe juglindore të Shqipërisë. Më 31 janar niveli i ujit të lumenjve Vjosa, Drinos, Osum, Gjanica filloi të rritet, ndërsa niveli i lumit Devoll u rrit më 4 shkurt. Më 1 shkurt 2015 niveli i ujit në lumin Osum u rrit me mbi 4.2 metra në Urën e Vajgurores dhe Urën në Goricë me mbi 3.5 metra. Niveli i lumit Vjosë u rrit më shumë se 2.5 metra në urën e Mifolit. Kulmi i emergjencës ndodhi më 2 shkurt - data me treguesit më të lartë të popullsisë si dhe tokës bujqësore të prekur nga përmbytjet. Nga 3 shkurti, niveli i ujit në lumenj filloi të ulet. Ngritja e lumenjve kërcënoi komunat dhe fshatrat përreth, veçanërisht në Levan, Darzezë, Fitore, Poro, Delisuf, Akërni, Novoselë, Docove, Frakull, Bishan, Mifol, Ferras dhe UraVajgurore.
Gjithsej janë prekur 9 qarqe dhe 53 komuna. Popullsia totale e prekur në zonat e përmbytura është 397316 persona. Rreth 12,225 ha tokë e punueshme dhe e mbjellë u zhyt në ujë, duke prekur të korrat në faza të ndryshme të zhvillimit. Përafërsisht 15,000 familje bujqësore u prekën. U dëmtua 9992.6 ha tokë bujqësore dhe rreth 2000 njerëz u evakuuan.


Harta 106. Përmbytja nga lumi Vjosë shkurt 2015.



b) Përmbytja e nëntorit 2017.

Pothuajse 5,000 familje kanë pësuar dëme nga përmbytjet në Shqipëri që nga reshjet e rrëmbyeshme më 01 dhjetor 2017. Më shumë se 15,000 hektarë janë përmbytur dhe janë dëmtuar: 4,715 ndërtesa, 41 biznese, 127 seksione rrugore, 177 shkolla, 71 stacione furnizimi me ujë, 26 stacione elektrike, 29 diga dhe një stacion pompimi uji. Përmbytjet kanë ndodhur nga Droja, Ishmi, Erzeni dhe lumi Vjosë. Qarqet më të prekura ishin Vlora dhe Fieri.

Harta 107. Përmbytja nga lumi Droja, Ishmi, Erzeni dhe lumi Vjosë në nëntor 2017.



c) Përmbytja e dhjetorit 2021.

Shirat e dendur në Greqi dhe pjesërisht në Shqipëri më 11 dhjetor 2021 shkaktuan përmbytjen e lumit Vjosa.

Gjithashtu, mbështetur në informacionin e prefekturave të qarqeve, në lidhje me përmbytjet e ndodhura 2017-2022, përmbytje këto mbas periudhës së konsideruar në VPRP-në e miratuar në 2021, ka rezuluar se territoret e prekura nga përmbytjet janë të njëjtat territore me ato që bëjnë pjesë në zonat aktuale me rrezikshmëri potenciale nga përmbytjet.

- Konkretisht territoret e fshatrave Novoselë, Bishan, Fitore dhe Aliban janë pjesë e zonës tashmë të shpallur Vjosa 3; fshati Shkozë pjesë e zonës Vjosa 7 dhe Selenica pjesë e Zonës Vjosa 5.

- Ndërkohë, përmbytjet e identifikuara në Peshkëpi në vitin 2017, Drashovicë, Mesaplik dhe Kallarat (të cilat nuk bëjnë pjesë në zonat aktuale) sipas të dhënave për dëmet, vlerësohet se nuk kanë "nivel" të tillë ndikimi dhe dëmtimesh, krahasuar me nivelin e dëmtimeve mbi të cilat janë shpallur zonat e tjera në rang vendi.

- Argjinaturat e ndërtuara në Novoselë (argjinaturë 627 m nga ura e Vjetër drejt fshatit Fitore; argjinaturë ndërmjet dy urave tek ish-tregu) konsiderohen se kanë ulur rrezikshmërinë e lartë në këto fshatra. Por duke marrë shkas nga fakti, se këto argjinatura janë marrë në konsideratë gjatë modelimit hidraulik të përmbytjeve (pjesë e Zonës Vjosa 3), pavarësisht se është evidente mbrojtja e territoreve të fshatrave Novoselë, Aliban, Fitore dhe Akerni, territoret e Zonës Vjosa 3 mbeten përsëri të ndikuara nga përmbytjet.

- Njëkohësisht, janë vlerësuar edhe informacionet e relatuara nga Prefektura e Qarkut Gjirokastër për përmbytjet në territoret e qytetit Memaliaj dhe fshatit Qesarakë (përmbytjet në nëntor-dhjetor 2017 dhe shkurt 2018) si edhe ajo e ndodhur në lagjen Lumi të bashkisë Tepelenë (nëntor-dhjetor 2017).

Harta 108. Harta e vendndodhjes së territorit Memaliaj dhe Qesarakë kundrejt zonës Vjosa 7, në territorin e Basenit Ujor Vjosë.




Grafika e zonave të shpallura me rrezik nga përmbytjet është grafikë indikative dhe pasqyron përgjithësisht segmentin e lumit i cili është konsideruar me rrezik potencial nga përmbytjet, në Vlerësimin paraprak aktual. Për rrjedhim, ajo grafikisht nuk pasqyron një zonë të mirëfilltë me shtrirje sipërfaqësore në terren, por gjithsesi parashikon territoret e prekura duke shpjeguar në kartelën përkatëse bashkitë apo njësitë administrative të prekura.

Territori ku janë evidentuar përmbytje e mësipërme ndodhet në rrjedhën e sipërme të zonës Vjosa 7 dhe njëkohësisht në krijimin e hartave të rrezikut dhe riskut nga përmbytjet nga Projekti, nga modelimi ka rezultuar se përgjithësisht këto territore (Qesarakë) preken nga përmbytjet dhe për rrjedhim ato do të jenë pjesë e planifikimit të rrezikut nga përmbytjet si pjesë e zonës Vjosa 7.

Ndërkohë, qyteti Memaliaj, nuk rezulton të preket nga përmbytjet sipas modelimit hidraulik, dhe duke konsideruar edhe nivelin e dëmeve të evidentuara, vlerësohet se vetëm territori i bashkisë nuk mund të konsiderohet si zonë e re me rrezik nga përmbytjet për përiudhën në vijim.

Nga sa më lart, zonat **Vjosa 3, Vjosa 5 dhe Vjosa 7,** do të vijojnë të konsiderohen zona me rrezik potencial nga përmbytjet edhe për periudhën 3-vjeçare në vijim. Gjithashtu, nuk është e nevojshme të ketë zona të tjera me rrezik potencial që duhet të përfshihen rishtaz.

Harta 109. Hartat e rrezikut nga përmbytjet për zonën Vjosa 7, e shtrirjes dhe thellësisë së ujit - Q max, P 1% / 1 herë në 100 vjet (projekti WBIF).



Harta 110. Shtrirja e vendodhjes Vjosa 3, Vjosa 5 dhe Vjosa 7, në territorin e Basenit Ujor Vjosë.



B. ZONAT ME RREZIK POTENCIAL NGA PERMBYTJET VJOSA 1, VJOSA 2, VJOSA 4, VJOSA 6 DHE VJOSA 8

Në bashkëpunim me Prefekturën e Qarkut Vlorë si edhe Prefekturën e Qarkut Gjirokastër është disponuar informacioni për përmbytjet e ndodhura kohët e fundit (përmbytje të ndodhura pas atyre të referuara në Vlerësimin paraprak të rrezikut nga përmbytjet të miratuar në 2021), dhe mbështetur në ato informacione, si edhe hartat e rrezikut nga përmbytjet të krijuara nga projekti WBIF, është vlerësuar nëse zonat aktuale të shpallura në Basenin Ujor Vjosë (Vjosa 1, Vjosa 2, Vjosa 4, Vjosa 6 dhe Vjosa 8) do të mbeten si të tilla edhe për periudhën 3-vjeçare në vijim, si edhe nëse është e nevojshme të ketë zona të tjera me rrezik potencial që duhet të përfshihen rishtaz.

Harta 111. Hartat e rrezikut nga përmbytjet për zonën Vjosa 1, e shtrirjes dhe thellësisë së ujit - Q max, P 1% / 1 herë në 100 vjet (projekti WBIF).





Harta 112. Harta e rrezikut nga përmbytjet për zonën Vjosa 8, e shtrirjes dhe thellësisë së ujit - Q max, P 1% / 1 herë në 100 vjet (projekti WBIF).




Nga informacioni për përmbytjet e identifikuara në Xarrë dhe në Vanë në vitin 2021 (të cilat nuk bëjnë pjesë në zonat aktuale) sipas të dhënave për dëmet, vlerësohet se nuk ka "nivel" të tillë ndikimi dhe dëmtimesh, krahasuar me nivelin e dëmtimeve mbi të cilat janë shpallur zonat e tjera në rang vendi.

Konkretisht zonat **Vjosa 1 dhe Vjosa 8,** do të vijojnë të konsiderohen zona me rrezik potencial nga përmbytjet edhe për periudhën 3-vjeçare në vijim, si edhe nuk është e nevojshme të ketë zona të tjera me rrezik potencial që duhet të përfshihen rishtaz.

Ndërkohë në lidhje me zonat Vjosa 2, Vjosa 4 dhe Vjosa 6 të cilat shtrihen në territorin e Qarkut Gjirokastër, ky dokument i referohet informacionit dhe konkluzioneve të institucionit të Prefektit si edhe hartave në vijim.

Harta 113. Hartat e rrezikut nga përmbytjet për zonën Vjosa 2 dhe Vjosa 4 të shtrirjes dhe thellësisë së ujit - Q max, P 1% / 1 herë në 100 vjet (projekti WBIF).





Është trajtuar informacioni në lidhje me përmbytjet e evidentuara në këtë territor dhe është konkluduar se territoret e fshatrave Lazarat, Dervican, qendër Libohovë, Dropull i Poshtëm, Sofratikë, Kordhocë dhe qytetit Gjirokastër janë tashmë pjesë e zonës me rrezikshmëri Vjosa 2 dhe Vjosa 4.


Gjithashtu, territoret e fshatrave Mashkullorë, Karjan dhe Palokastër, janë tashmë pjesë e zonës me rrezikshmëri Vjosa 6.

Mbështetur në këtë informacion si edhe konkluzionet e Prefekturës, vlerësojmë se zonat me rrezikshmëri Vjosa 2, Vjosa 4 dhe Vjosa 6, të vijojnë të konsiderohen si zona me rezikshmëri edhe për përiudhën 3-vjecare në vijim.

Njëkohësisht është trajtuar edhe informacioni për përmbytjet e identifikuara në territore të tjera të cilat nuk bëjnë pjesë në zonat e mësipërme, me qëllim vlerësimin nëse ka zona të tjera me rrezikshmëri që duhet të përfshihën rishtaz në zonat me rrrezik për periudhën 3-vjecare në vijim. Konkretisht:

a) Për përmbytjet në Kardhiq, Zhulat dhe Picar të ndodhura në nëntor-dhjetor 2017 dhe në shkurt 2018, janë konsideruar modelimet hidraulike, nga të cilat rezulton se këto territore nuk preken nga gjurma e përmbytjes (për referencë hartat në vijim).

Harta 114. Harta e rrezikut nga përmbytjet për zonën Vjosa 6 të shtrirjes dhe thellësisë së ujit - Q max, P 1% / 1 herë në 100 vjet (projekti WBIF).



b) Për përmbytjet në Vrisera, Llongo, Koshovicë dhe Likomil të ndodhura në nëntor-dhjetor 2017 dhe në shkurt 2018, rezulton se këto territore nuk janë konsideruar në modelim nga projekti dhe për rrjedhim nuk janë krijuar hartat e rrezikut dhe riskut përkatës.
Gjithsesi, duke vlerësuar "nivelin" e dëmeve të evidentuara për këto territore (kryesisht në sipërfaqe të tokave bujqësore të mbuluara nga uji – 3 ha në 2017 dhe 30 ha në 2018, dëme në rrugë apo dëme të shkaktuara nga errozioni), është konsideruar që këto territore nuk përmbushin kushtet e ngjashme me nivelin e dëmeve të konsideruar për zonat e tjera të shpallura në rang vendi.


c) Për përmbytjet në Çarshovë, Zhepe, Bual dhe Kutal të ndodhura në nëntor-dhjetor 2017, rezulton se nuk janë konsideruar në modelim nga projekti dhe për rrjedhim nuk janë krijuar hartat e rrezikut dhe riskut përkatës.
Gjithsesi, duke vlerësuar se në këtë territor është evidentuar vetëm një ngjarje përmbytjeje dhe gjithashtu "niveli" i dëmeve të evidentuara për këto territore (veçanërisht në objekte infrastrukturore), është konsideruar që këto territore nuk përmbushin kushtet e ngjashme me nivelin e dëmeve të konsideruar për zonat e tjera të shpallura në rang vendi.

d) Për përmbytjet në Këlcyrë, Bedyqas, Katundishtë, Sukë, Podgoran dhe Ujë Mirë të ndodhura në nëntor-dhjetor 2017, shkurt 2018 dhe dhjetor 2021 (vetëm në Ujë Mirë)

rezulton se nuk janë konsideruar në modelim nga projekti dhe për rrjedhim nuk janë krijuar hartat e rrezikut dhe riskut përkatës.
Gjithsesi, duke vlerësuar "nivelin" e dëmeve të evidentuara për këto territore, është konsideruar që këto territore nuk përmbushin kushtet e ngjashme me nivelin e dëmeve të konsideruar për zonat e tjera të shapllura në rang vendi.

e) Më të njëjtin argumentim është vlerësuar që edhe ngjarjet e përmbytjeve në Përmet, Petran dhe Kosinë të ndodhura në shkurt 2018; lagjen Lumi në qytetin Tepelenë apo Dragot të Njësisë administrative Qendër Tepelenë, nuk kanë një "nivel" dëmtimesh të tillë për tu konsideruar në vijim si një zonë me rrezik potencial.

Harta 115. Shtrirja e vendodhjes Vjosa 1, Vjosa 2, Vjosa 4, Vjosa 6 dhe Vjosa 8, në territorin e Basenit Ujor Vjosë.



Nga sa më lart, është vlerësuar se zonat **Vjosa 1, Vjosa 2, Vjosa 3, Vjosa 4, Vjosa 5, Vjosa 6, Vjosa 7 dhe Vjosa 8 duhet të vijojnë të konsiderohen zona me rrezik potencial nga përmbytjet**, për 3 vitet e ardhshme dhe organet e menaxhimit të burimeve ujore (AMBU dhe ZABU) në koordinim dhe bashkëpunim me institucionet qendrore dhe lokale, referuar hartave të rrezikut dhe të riskut, duhet të hartojnë planin e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet dhe të përcaktojnë masat konkrete të mëtejshme që do të duhet të ndërmerren për eleminimin apo uljen e rrezikut në të gjithë territorin e zonave.

Gjithashtu, në Basenin Vjosë, **nuk evidentohen zona të reja për tu shpallur** si zona me rrezik potencial për 3 vitet e ardhshme.

Ndyshimet klimatike janë marë në konsideratë vetëm në zonat me rrezikshmëri të cilat shtrihen në zonat bregdetare, ku edhe këto ndikime janë vlerësuar si më të qenësishme. Konkretisht për zonat Vjosa 1 dhe Vjosa 3.

IX. REZULTATET E RISHIKIMIT DHE KONKLUZIONET

Nga rishikimi i VPRP, të miratruar në vitin 2021 nga KKU, rezulton se, 46 zonat e shpallura me rrezik potencial nga përmbytjet apo ku ka gjasa të ndodhin ato, referuar informacionit dhe njohurive të deritanishme, pasqyrojnë drejtë situatën e territoreve me rrezik në vend, dhe për rrjedhim do të vijojnë të konsiderohen të tilla edhe për periudhën 3-vjeçare në vijim (2024-2026).

Hartat e rrezikut dhe ato të riskut të krijuara apo në proces krijimi për 46 zonat, do të vijojnë të shërbejnë si dokumente referuese për hartimin e Planeve të Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet për 7 basenet ujore.

Procesi i radhës për rishikimin e VPRP do të fillojë në vitin 2026 dhe duhet të përfundojë brenda datës 31.12.2026, përjashtuar rastet kur ngjarjet e përmbytjeve, që mund të ndodhin ndërkohë, do të ndryshojnë njohuritë e organeve të menaxhimit të burimeve ujore në lidhje me rreziqet e përmbytjeve në zona/territore të caktuara, apo ndërtimi i veprave infrastrukturore do të ndikojë ndjeshëm në uljen e rrezikut nga përmbytjet në zonat e konfirmuara me rrezik.

Në raste të tilla, për zonat e ndikuara, do të kryhet rishikim i vlerësimit paraprak të rrezikut me qëllim identifikimin e nevojës për përditësimin të zonës/zonave me rrezik potencial dhe rikrijimin e hartave të rrezikut dhe riskut, mbështetur në informacionet e përditësuara.

Një rishikim i zonave me rrezik potencial, do të duhet të kryhet edhe nëse, nga modelimet dhe hartat e rrezikut dhe të riskut, që do të krijohen ndërkohë, do të rezultojë nevoja për përfshirjen e zonave të reja apo “eleminimin” e zonave aktualisht të shpallura dhe të rikonfirmuara në këtë rishikim.

Në lidhje me nivelin e rrezikut dhe riskut, për territoret ku shtrihet gjurma e përmbytjeve, në zonat me rrezik potencial nga përmbytjet, organet menaxhimi të burimeve ujore dhe entet publike që kontribuojnë në këto procese menaxhuese, duhet t’i referohen hartave të rrezikut dhe riskut të specifikuar në Tabëlën 2 në vijim, apo hartave që do të krijohen nga proceset në vazhdim.

Hartat e rrezikut të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Ujit në vitin 2021, të krijuara me mbështetjen e projektit “Programi për Përmirësimin e Sistemit Kombëtar të Paralajmërimit të Hershëm dhe Parandalimit të Përmbytjeve në Shqipëri", PRONEWS, do të shërbejnë për të kuptuar ndryshimet dhe trendin në shtrirjen e gjurmës së përmbytjes ndërmjet periudhave përkatëse.

Në lidhje me konsiderimin e ndryshimeve klimatike për përmbytjet, zonat me rrezik potencial nga përmbytjet dhe territoret do duhet t’i referohen në planifikim, sipas rastit dhe qëllimit, hartave të rrezikut të krijuara e që kanë marrë në konsideratë këto ndikime (hartat për zonat Erzen 1, Erzen 5 dhe Erzen 6, Ishëm 2 dhe Ishëm 3, Shkumbin 2, Shkumbin 5 dhe Shkumbin 6, Vjosa 1 dhe Vjosa 3 të krijuara nga projekti i mbështetur nga WBIF, si edhe hartat për probabilitetin 1 herë në 500 vjet për zonat Drin-Bunë 5 dhe Drin-Bunë 6 të krijuara nga projekti i mbështetur nga GIZ), ose hartave që do të krijohen në vijimësi.

Gjithashtu, nisur nga fakti që për territoret e baseneve ujore Drin-Bunë (5 zonat), Ishëm, Erzen, Shkumbin, Seman dhe Vjosë, gjatë periudhës 2024-2025, do të hartohen dhe miratohen Planet e Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet, ndikimet e ndryshimeve klimatike në territorin e zonave me rrezik potencial, do të rivlerësohen referuar përcaktimeve që këto plane do të kenë në lidhje me këtë çështje.

Në lidhje me koordinimin me autoritetet përkatëse në shtetet e tjera, na rastin e baseneve ndërkufitare, për shpalljen e zonave në rrezik nga përmbytjet, duke ju referuar fakteve që:

- Zonat me rrezik potencial nga përmbytjet, pas këtij rishikimi, janë të njëjtat me ato të evidentuara dhe të miratuara/shpallura në vitin 2021;
- Zonat me rrezik potencial nga përmbytjet të Basenit Ujor Drin-Bunë, si edhe hartat janë identifikuar dhe krijuar nga një proces i realizuar në bashkëpunim ndërmjet shteteve ndërkufitare ku ky basen shtrihet: Maqedonia e Veriut, Kosova, Mali i Zi (procese të realizuara me asistencën e projekteve të GIZ dhe UNDP);
- Për basenin ndërkufitar Vjosë, koordinimi dhe bashkërendimi do të realizohet në fazën e hartimit të Planit të Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet për këtë basen,

Vlerësohet si përgjithësisht i përmbushur koordinimi me autoritetet përkatëse në shtetet e tjera.


X. ZONAT ME RREZIK POTENCIAL NGA PËRMBYTJET OSE KU KA GJASA TË NDODHIN ATO (2024-2026)

Në tabelën më poshtë paraqitet lista e zonave me rrezik potencial nga përmbytjet apo ku ka gjasa të ndodhin përmbytje, e konfirmuar për periudhën në vijim dhe hartat e rrezikut dhe të riskut mbi të cilat mbështetet informacioni për rreziqet dhe risqet për këto zona, si edhe projektet që kanë kontribuar në hartimin e tyre:

Tabela 2. Zonat me rrezik potencial nga përmbytjet apo ku ka gjasa të ndodhin përmbytje.

ZONAT ME RREZIK POTENCIAL NGA PERMBYTJET	HARTA E RREZIKUT TE KRIJUARA PER ZONEN		HARTA E RISKUT TE KRIJUARA PER ZONEN		PLAN MENAXHIMI PER RREZIKUN NGA PERMBYTJET	
BRIN BUNE 1	Asistenca e UNDP	✓	Ne proces Asistenca e UNDP		Ne proces Asistenca e UNDP	
BRIN BUNE 2	Asistenca e UNDP	✓	Ne proces Asistenca e UNDP		Ne proces Asistenca e UNDP	
BRIN BUNE 3	Asistenca e UNDP	✓	Ne proces Asistenca e UNDP		Ne proces Asistenca e UNDP	
BRIN BUNE 4	Assitenca e GIZ dhe UNDP	✓	Assitenca e GIZ	✓	Assitenca e GIZ	✓
BRIN BUNE 5	Assitenca e GIZ	✓	Assitenca e GIZ	✓	Assitenca e GIZ	✓
BRIN BUNE 6	Assitenca e GIZ	✓	Assitenca e GIZ	✓	Assitenca e GIZ	✓
BRIN BUNE 7	Asistenca e UNDP	✓	Ne proces Asistenca e UNDP		Ne proces Asistenca e UNDP	
BRIN BUNE 8	Asistenca e UNDP	✓	Ne proces Asistenca e UNDP		Ne proces Asistenca e UNDP	
MAT 1	Asistenca e Infrastructure Project Facility, Technical Assistance Window (IPF - TA), Western Balkan	✓	Asistenca e Infrastructure Project Facility, Technical Assistance Window (IPF - TA), Western Balkan	✓		
MAT 2						
ISHEM 1	Assitenca WBIF	✓	Assitenca WBIF	✓	Ne proces Assitenca WBIF	
ISHEM 2	Assitenca e Pronews dhe WBIF	✓	Assitenca WBIF	✓	Ne proces Assitenca WBIF	
ISHEM 3	Assitenca WBIF	✓	Assitenca WBIF	✓	Ne proces Assitenca WBIF	
ERZEN 1	Assitenca e Pronews dhe WBIF	✓	Assitenca WBIF	✓	Ne proces Assitenca WBIF	
ERZEN 2	Assitenca e Pronews dhe WBIF	✓	Assitenca WBIF	✓	Ne proces Assitenca WBIF	
ERZEN 3	Assitenca WBIF	✓	Assitenca WBIF	✓	Ne proces Assitenca WBIF	
ERZEN 4	Assitenca WBIF	✓	Assitenca WBIF	✓	Ne proces Assitenca WBIF	
ERZEN 5	Assitenca e Pronews dhe WBIF	✓	Assitenca WBIF	✓	Ne proces Assitenca WBIF	
ERZEN 6	Assitenca WBIF	✓	Assitenca WBIF	✓	Ne proces Assitenca WBIF	
SHKUMBIN 1	Assitenca WBIF	✓	Assitenca WBIF	✓	Ne proces Assitenca WBIF	
SHKUMBIN 2	Assitenca e Pronews dhe WBIF	✓	Assitenca WBIF	✓	Ne proces Assitenca WBIF	
SHKUMBIN 3	Assitenca e Pronews dhe WBIF	✓	Assitenca WBIF	✓	Ne proces Assitenca WBIF	
SHKUMBIN 4	Assitenca WBIF	✓	Assitenca WBIF	✓	Ne proces Assitenca WBIF	
SHKUMBIN 5	Assitenca WBIF	✓	Assitenca WBIF	✓	Ne proces Assitenca WBIF	
SHKUMBIN 6	Assitenca WBIF	✓	Assitenca WBIF	✓	Ne proces Assitenca WBIF	
